



100 Vjet Pavarësi



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË
DEPARTAMENTI I GJUHËSISË**

**RAPORTET KUSHTORE
DHE SISTEMI HIPOTETIK
NË GJUHËN SHQIPE**

Doktorant

**Ma. Matilda PARLLAKU
(ÇOLLAKU)**

Udhëheqës shkencor

Prof. Dr. Seit MANSAKU

Tiranë 2012

DISERTACION

Përgatitur nga: **Matilda PARLLAKU (ÇOLLAKU)**

Për marrjen e gradës shkencore: **“DOKTOR”**

Specialiteti: **Sintaksë e gjuhës shqipe**

RAPORTET KUSHTORE DHE SISTEMI HIPOTETIK NË GJUHËN SHQIPE

Udhëheqës shkencor: **Prof. Dr. Seit MANSAKU**

Mbrohet në dt. ____ . ____ . 2012 përpara jurisë së përbërë nga:

- | | | | |
|----|-------|-------|-------------------------|
| 1. | _____ | _____ | Kryetar |
| 2. | _____ | _____ | Anëtar |
| 3. | _____ | _____ | Anëtar (oponent) |
| 4. | _____ | _____ | Anëtar (oponent) |
| 5. | _____ | _____ | Anëtar |

RAPORTET KUSHTORE DHE SISTEMI HIPOTETIK NË GJUHËN SHQIPE

PËRMBAJTJA

PARATHËNIE	7
FALENDERIME DHE MIRËNJOHJE	15
HYRJE	16

KREU I

TRAJTIMI I DERISOTËM I RAPORTEVE KUSHTORE NË GJUHËN SHQIPE

1.1 Raportet sintaksore.....	17
1.2 Raportet kushtore, trajtimi i derisotëm.....	22
1.3 Çështje të terminologjisë së raporteve kushtore	38

KREU II

ÇËSHTJE TË KLASIFIKIMIT TË PERIUDHAVE ME FJALI TË NËNRENDITUR KUSHTORE DHE VENDI I SAJ NË KËTO KLASIFIKIME

2.1 Klasifikimet e ndjekura nga autorë të ndryshëm	42
2.1.1 Trajtimi dhe zbatimi i kriterëve për klasifikimin e periudhës me fjali të nënrenditur	42
2.1.2 Fjali, periudhë, frazë, fjali e përbërë-njësia sintaksore që është marrë për bazë në klasifikime të ndryshme.....	48
2.1.3 Klasifikimi nga gramatikanët sipas modalitetit (reale, joreale, potenciale).....	51
2.1.4 Disa të meta të klasifikimeve të mëparshme	58
2.1.4.1 Të meta të klasifikimit sipas kriterit strukturor	58
2.1.4.2 Të meta të klasifikimit sipas kriterit funksional	60
2.1.4.3 Të meta të klasifikimit sipas kriterit semantik strukturor	61
2.1.5 Cilit kriter i përmbahemi në këtë punim	63
2.2 Vendi i fjalisë së nënrenditur kushtore në këto klasifikime	65

KREU III**SISTEMI HIPOTETIK I SHQIPES SI TËRËSI E MJETEVE DHE FORMAVE TË SHPREHJES SË RAPORTEVE KUSHTORE**

3.1 Ç`kuptohet me sistem hipotetik	73
3.2 Zhvillimi i sistemit hipotetik të shqipes	75
3.2.1 Evolucioni i lidhëzave dhe lokucioneve lidhëzore kushtore	75
3.2.2 Evolucioni i trajtave dhe formave të foljes kallëzues në fjalinë kushtore dhe e bashkëlidhjes së tyre me ato të fjalisë drejtuese	86
3.3 Standardi dhe veçori dialektore në sistemin hipotetik të shqipes	89
3.3.1 Mjetet e shprehjes së raporteve kushtore të prekura më tepër nga dallimet dialektore	90

KREU IV**SHPREHJA E RAPORTEVE KUSHTORE**

4.1 Shprehja e raporteve kushtore në periudhë	96
4.1.1 Shprehja e raporteve kushtore në periudhë me lidhëza dhe lokucione nënrenditëse kushtore	96
4.1.1.1 Shprehja e raporteve kushtore me fjali të bashkuara me lidhëzë nënrenditëse kushtore në dhe variantet e saj n` , për në, ndë	96
4.1.1.2 Shprehja e raporteve kushtore me fjali të bashkuara me lidhëzën nënrenditëse kushtore nëse	114
4.1.1.3 Shprehja e raporteve kushtore me fjali të bashkuara me lokucionin lidhëzor nënrenditës kushtor në qoftë se dhe variantet dialektore të saj në qe/kje se	117
4.1.1.4 Shprehja e raporteve kushtore me fjali të bashkuara me lokucionin lidhëzor nënrenditës kushtor në rast se	126
4.1.1.5 Shprehja e raporteve kushtore me fjali të bashkuara me lidhëzën nënrenditëse kushtore po	129
4.1.1.6 Shprehja e raporteve kushtore me fjali të bashkuara me lidhëzën nënrenditëse kushtore po që	142
4.1.1.7 Shprehja e raporteve kushtore me fjali të bashkuara me lokucionin lidhëzor nënrenditës kushtor po qe/kje se/po qe/kje që	143
4.1.1.8 Shprehja e raporteve kushtore me fjali të bashkuara lokucionin lidhëzor nënrenditës kushtor po të jetë se/që	146
4.1.1.9 Shprehja e raporteve kushtore me fjali të bashkuara me lokucionin lidhëzor nënrenditës kushtor me kush/konditë që	147
4.1.1.10 Shprehja e raporteve kushtore me fjali të bashkuara me lidhëzën nënrenditëse kushtore sikur	149

4.1.1.11 Shprehja e raporteve kushtore me lokucionin lidhëzor nënrenditës kushtor mjaft që	153
4.1.2 Shprehja e raporteve kushtore me fjali të bashkuara me lidhëza të tjera nënrenditëse	155
4.1.2.1 Shprehja e raporteve kushtore me fjali të bashkuara me lidhëzën nënrenditëse kohore si	155
4.1.2.2 Shprehja e raporteve kushtore me fjali të bashkuara me lidhëzën nënrenditëse kohore kur	157
4.1.3. Shprehja e raporteve kushtore me fjali të bashkuara me përemra lidhorë	164
4.1.3.1 Shprehja e raporteve kushtore me fjali të bashkuara me përemrin lidhor kush	164
4.1.4 Shprehja e raporteve kushtore me fjali të bashkuara me lidhëza bashkërenditëse	165
4.1.5 Shprehja e raporteve kushtore në fjali të bashkuara pa lidhëza	166
4.1.5.1 Shprehja e raporteve kushtore me fjali që fillojnë me foljen kallëzues në mënyrën lidhore	166
4.1.5.2 Pranëvënia e fjalive në periudhën me fjali të nënrenditur kushtore (shprehja e raporteve me fjali të bashkuara asindetikisht)	174
4.1.6 Shprehja e raporteve kushtore me mjete të tjera	178
4.1.6.1 Shprehja e raporteve kushtore me forma të pashtjelluara	178
4.1.6.1.1 Shprehja e raporteve kushtore me formën e pashtjelluar paskajore gege.....	178
4.1.6.1.2 Shprehja e raporteve kushtore me formën e pashtjelluar mohore	181
4.1.6.1.3 Shprehja e raporteve kushtore me formën e pashtjelluar përcjellore	184
4.2. Shprehja e raporteve kushtore në fjali	185
4.2.1 Shprehja e raporteve kushtore me rrethanorin e kushtit	185
4.2.1.1 Shprehja e raporteve kushtore me ndajfolje	187
4.2.1.2 Shprehja e raporteve kushtore me rrethanor kushti të shprehur nga emra të prirë nga lokucioni parafjalor në rast.....	193
4.2.1.3 Shprehja e raporteve kushtore me rrethanor kushtit të shprehur me emrat me parafjalët me, pa	194
4.2.1.4 Shprehja e raporteve kushtore me mbiemra prejpjesorë.....	199
4.2.1.5 Grafik për shpërndarjen e mjeteve të shprehjes së raporteve kushtore....	199

KREU V

RENDI I FJALËVE DHE I GJYMTYRËVE NË FJALINË KUSHTORE DHE RENDI I FJALIVE NË PERIUDHËN ME FJALI TË NËNRENDITUR KUSHTORE

5.1 Rendi i fjalëve dhe i gjymtyrëve në fjalinë kushtore	202
5.2 Rendi i fjalive në periudhën me fjali të nënrenditur kushtore dhe aktualizimi i thënies	216
PËRFUNDIME	226
LISTA E VEPRAVE TË VJELA	235
BIBLIOGRAFI	239
GRAMATIKA	239
STUDIME SINTAKSORE	241
FJALORË	244
MATERIALE NGA INTERNETI	244
REPERTOR BIBLIOGRAFIK	246
TË TJERA	246
ABSTRAKTI	247

PARATHËNIE

“Sistemi i mjeteve të shprehjes së raporteve sintaksore është rezultat i zhvillimit historik të një gjuhe dhe i natyrës së saj. Ai ndryshon dhe me kohë rindërtohet; mjete të caktuara e humbin fuqinë e tyre e zëvendësohen nga të tjera; krijohen vijimisht mjete të reja më të përpikta, p.sh. lokucione parafjalore dhe lidhëzore, që vijnë gjithnjë duke u shtuar.”¹

Mëse i gjetur, ky konstatim i shprehur nga gramatika e gjuhës së sotme shqipe shërbeu për t'i shtuar synimit të mëparshëm për studimin e mjeteve dhe formave të shprehjes së raporteve kushtore në gjuhën shqipe, edhe hedhjen e hipotezës për mundësinë e grupimit të tyre në të ashtuquajturin sistem hipotetik të shqipes.

Gjatë punimit janë shtruar natyrshëm para nesh pyetje të tilla si:

A vihen re gjatë vjeljes, por edhe gjatë përzgjedhjes, dallime në shprehjen e raporteve kushtore duke vënë përballë gjuhën letrare të disa shkrimtarëve me dialektin, gjurmë të të cilit ata ruajnë ende në stilin e tyre të të shkruarit?

Ku qëndron e veçanta e fjalëve të urta popullore në raport me stilet që përmendëm më sipër, për sa i përket mundësisë së shprehjes së raporteve kushtore?

Çfarë bie më shumë në sy, nëse përqendrohesh te lidhëzat apo lokucionet lidhëzore që ndeshen gjatë vjeljes së materialit praktik në krahasim me ato që numërohen gjatë përpunimit të materialit teorik?

Si paraqitet bashkëlidhja kohore? A zbatohen gjithmonë rregullat e njohura teorikisht apo ka shmangie nga rregullat për shkaqe të ndryshme?

Dëshira për t'u dhënë përgjigje këtyre pyetjeve, por edhe mjaft të tjerave që kanë dalë në etapa të ndryshme të rrugës që ka ndjekur ky punim për të mbërritur sa më i plotë, por edhe kureshtja për të parë se si kanë evoluar këto mjete e forma në vite na shtyu t'i trajtojmë raportet kushtore dhe mjetet e format e shprehjes së tyre sa më gjerësisht që të jetë e mundur.

Objekt i punimit tonë janë bërë ndërtimet sintaksore kushtore në periudhë dhe në fjali. Në nivelin e periudhës janë analizuar: a) ndërtimet që bashkohen me lidhëzat e lokucionet lidhëzore kushtore që njihen në traditën e sotme, duke u shtuar atyre edhe të reja, më tepër si rezultat i ndikimit të gjuhës së folur, b) ndërtime që bashkohen me lidhëza të tjera nënrenditëse, konkretisht kohore, **si** dhe **kur**, c) ndërtime në të cilat fjalitë bashkohen me përemrin lidhor **kush**, që, në fakt shërben për të bashkuar fjalitë në periudhën me fjali të nënrenditur kryefjalore, d) ndërtime që bashkohen pa lidhëza dhe në këtë rubrikë janë trajtuar ndërtimet që fillojnë me foljen kallëzues në mënyrën lidhore dhe ato që bashkohen nëpërmjet pranëvënies e) ndërtimet me forma të pashtjelluara, kryesisht paskajoren geqe. Në nivelin e fjalisë, objekt i këtij punimi ka qenë konstatimi dhe analizimi i rasteve të shprehjes së këtyre raporteve me rrethanorin e kushtit të përfaqësuar nga ndajfolje mënyre (**ndryshe**, **përndryshe**) a kohe (**pastaj**, **atëherë**) dhe me emra me parafjalët **me**, **pa** ose emrin me parafjalë **në rast**, të pasuar nga një emër në rasën rrjedhore a gjinore.

¹ Gramatika e gjuhës shqipe II, Sintaksa, ASHRSH, IGJL, Tiranë 1997, f. 75

Nuk janë konsideruar periudha me fjali të nënrenditura kushtore dhe nuk kanë qenë objekt i këtij studimi ndërtimet: “**Nëse** e humbëm konkursin, kjo ndodhi për shkakun tënd.” *Fjalë e nënrenditur e kësaj periudhe, edhe pse fillon me lidhëzën nënrenditëse kushtore, sepse nuk shprehin kusht të mirëfilltë.*

Nuk janë kushtore për nga përmbajtja dhe kuptimi as ndërtime të tilla si: “Të ishte miku im më i mirë dhe prapë nuk do t`ia jepja makinën për një udhëtim aq të gjatë.” Këto ndërtime, edhe pse për nga struktura janë të njëjta me ato të trajtuara gjatë këtij punimi ku fjalitë në periudhë bashkohen pa mjetin lidhës, sepse modaliteti i foljes kallëzues në mënyrën lidhore është i mjaftueshëm për të shprehur kushtin, janë të barazvlefshme me periudhat me fjali të nënrenditura lejore që bashkohen me lidhëzat lejore, edhe pse ose edhe sikur, krahaso: “**Edhe sikur** të ishte miku im më i mirë, prapë nuk do t`ia jepja makinën për një udhëtim aq të gjatë.” Në raste të tilla fjalët ndihmëse a shërbyese luajnë një rol shumë të rëndësishëm.

Nuk janë përfshirë në këtë punim në grupin e periudhave me fjali të nënrenditura kushtore raste të periudhave me fjali të nënrenditura të bashkuara me drejtueset me lidhëza kushtore ku vihet re humbja e raporteve kushtore:

Marrëdhënie kushtore të një lloji të veçantë shprehin edhe ndërtimet në të cilat, në fjalinë e nënrenditur kemi një kallëzues të përbërë, të mundësisë së kryerjes së veprimit me foljen gjysmëndihmëse **mund** dhe foljen në të pakryerën e mënyrës lidhore. Në fjalinë drejtuese që varet nga një fjali kryesore kemi një kallëzues emëror, gjymtyra emërore e të cilit është një mbiemër. Përdorimi i tij vë në dyshim të ndodhurit e ngjarjes në fjalinë e nënrenditur dhe nuk mund të konsiderohet si i mirëfilltë kushtor:

E kishte ndjerë qysh atëherë se ajo histori ishte e veçantë, e vdekjejetshme, **në** mund të përdorej një fjalë e tillë. I. Kadare, “SPIRITUS”, f. 236

Të tjera periudha ku fjalitë janë të bashkuara nga lidhëza nënrenditëse kushtore ose lokucione lidhëzore kushtore në të cilat kanë humbur raportet kushtore, sepse kushti nuk e shpjegon pasojën, janë edhe ato ku raportet ndërmjet fjalive janë kundërshtore: **Në qoftë se** njerëzit kuptohen nga përgjigjet sa të zgjuar janë, xha Gori gëzonte dhuntinë e rrallë të kuptohej edhe nga pyetjet që bënte. N. Prifti, erë mali, erë fushe, f. 141

Nëpërmjet përqasjes së dy ngjarjeve të ndryshme, të krahasueshme midis tyre, me këta tipa fjalish theksohet njëra prej tyre. Këto periudha vetëm nga struktura janë me fjali të nënrenditur dhe bashkohen me lokucionin lidhëzor **në qoftë se**, kurse nga përmbajtja ato janë periudha me fjali të bashkërenditura të bashkuara me lidhëzën **ndërsa** që mund të fitojë nuanca kushtore gjatë përdorimit në fjali:

Njerëzit kuptohen nga përgjigjet sa të zgjuar janë (në përgjithësi), **ndërsa** xha Gori gëzonte dhuntinë e rrallë...

Në kjoftë se këto shfaqje janë braktisë me kohë ndër shtetet moderne europiane, këtu në Shqipëri ishin dhe janë gjithnjë në fuqi. A. Z. Pllumi, Rrno vetëm për me tregue, f. 18

Në fjalinë e nënrenditur të ndërtimeve të tilla veprimi i foljes jepet si një fakt real dhe nuk ka supozim nëpërmjet të cilit të kërkohet të mësohet, nëse veprimi i fjalisë

kryesore do të realizohet apo jo si rezultat i realizimit ose jo të kushtit. Këto lloj periudhash shprehin marrëdhënie opozicionale.

Kështu në qoftë se në Shqipëri bukuria është e përbuzur dhe e shkelmuar, s'ka dyshim se fisnikëria është edhe e gjallë dhe merr një fuqi të re. F. Konica, Vepra, f. 227

Qëllimi i punimit është të trajtohen dy çështje nga fusha e sintaksës së gjuhës shqipe. Çështja e parë, që zë pjesën më të madhe të punimit, trajton raportet kushtore duke i parë fillimisht në vështrimin historik e më tej duke analizuar shprehjen e tyre konkrete në gjuhën e shkruar dhe atë të folur. Çështja e dytë synon t'i shikojë mjetet dhe format e shprehjes së tyre në vështrimin tërësor të funksionimit në kuadër të sistemit hipotetik të gjuhës shqipe. Kjo çështje përbën një nga risitë e punimit, jo vetëm në aspektin terminologjik por edhe në atë funksional.

Për arritjen e këtij qëllimi kemi shfrytëzuar një bibliografi të pasur ku përfshihen vepra të gramatikanëve të shquar, të cilat, edhe pse u përkasin dekadave përpara, mbeten aktuale për vlerat gjuhësore që përfaqësojnë dhe përcjellin.

Objekt i konsultimit për një seri çështjesh të lidhura ngushtë me punimin kanë qenë sintaksat dhe punimet tradicionale, si tekstet gramatikore të hershme A. M. Xanoni², G. Mikeli³, A. Xhuvani⁴, I. D. Sheperi⁵, A. J. Rrota⁶, K. Cipo⁷, M. Domi⁸, E. Guinard⁹, S. Prifti¹⁰, “Fonetika dhe gramatika”¹¹, “Gramatika e gjuhës shqipe”¹², M. Totoni¹³, Th. Dhima¹⁴ qoftë edhe si punime të veçanta nga albanologu austriak M. Lambertz¹⁵ dhe shqiptarë S. Mansaku¹⁶, T. Topalli¹⁷ dhe të ribotuara si ai i A. J. Rrotës¹⁸, M.

² A.M.Xanoni, Gramatika shqyp qi përdoret n`seminarë e n`mbësoitore t`sh` Françesk Saverit n` Shkodër, Shtypshkronja e Zojës Papërlyeme N` Shkodër 1909, f.160

³ G.Mikeli, Gramatika e giuhës shqype shtypshkronja “Nikaj” Shkodër 1916, 131f

⁴ A. Xhuvani, Njohunit e para të sintaksës shqipe, pjesë e parë për klasët e nalta të filllores, Vlorë 1922, dhe Njohunit e para të sintaksës shqipe, pjesë e parë për klasët e nalta të filllores, Shpallje e dytë e përmirësuese, Tiranë Shtypshkronja Nikaj, 1925, më pas Njohunit e para të sintaksës shqipe për klasët e nalta të Filllores e për t`ultat e Shkollavet të Mesme, Tiranë 1938 dhe Libri i gjuhës shqipe pj. II për klasat e nalta të Filllores dhe të parat e Qytetses, Tiranë 1942

⁵ I. D. Sheperi, Gramatika dhe Sintaksa e gjuhës shqipe, Vlorë 1927,

⁶ A. J. Rrota, Syntaksa e gjuhës shqipe (ose Sintaksi i shqipes 1942) për klasën II, III, IV të shkollave të mesme, Shkodër, shtypshkronja A. Gj. Fishta, 1943 dhe “Gjuha e shkrueme ase vërejtje gramatikore” ASHSH IGJL Botimi I, Botime Françeskane Shkodër, 2006, 614 fq

⁷ K. Cipo, Gramatika e gjuhës shqipe për klasat e V-ta, VI-ta, VII-ta të shkollave 7-vjeçare, f.186 Tiranë 1949; Sintaksa tekst për Institutin pedagogjik, Tiranë 1951 botim i Ministrisë së Arsimit f. 44 dhe Sintaksa Tiranë, 1952 f. 125 Instituti i Shkencave

⁸ M. Domi, Gramatika e gjuhës shqipe, pjesa II, Sintaksa, tekst për shkollën 7-vjeçare, Tiranë, 1955 dhe “Gramatika e gjuhës shqipe” Sintaksa për shkollat e mesme Prishtinë, 1969 dhe 1971

⁹ Emile, Guinard, Les propositions subordonnées dans l`albanais moderne, Thèse de Doctorat de 3-ème cycle, Directeur de recherche Monsieur le Professeur Henri Boissin, Faculté des Lettres de l`Université de Paris, Ecole Nationale des Langues Orientales Vivantes, Paris, 1967, f. 57-68

¹⁰ S. Prifti, Sintaksa e gjuhës shqipe, pj I Tiranë 1959 f. 190; 1962 pj II 1. f. 181; 2. f. 182-322 USHT Fakulteti Histori-Filologji; Sintaksa e gjuhës shqipe I, II mars 1971, “Rilindja” Prishtinë

¹¹ Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe, “Sintaksa e periudhës”, Tiranë 1976

¹² Gramatika e gjuhës shqipe II ASHRSH IGJL Tiranë 1997, f. 581-593

¹³ M. Totoni, Frazat me nënrenditje, SHBLU, Tiranë, 2000, f. 98-107

¹⁴ Th. Dhima, Gjuha shqipe, Sintaksa, SHBLU, Tiranë 2005, f. 196-200

¹⁵ M. Lambertz, Die hypotetische Periode im Albanischen, në “Indogermanische Forschungen”, 1914-15, vëll. 34 përkthimi në gjuhën shqipe nga V. Dashi, material i siguruar pranë IGJL 163 f

¹⁶ S. Mansaku, Rreth formave të shprehjes së raporteve kushtore në shqipen e sotme letrare, në SF 1969/3 f. 153-167

Lambertz¹⁹ disa gramatika në gjuhë të huaj (anglisht, frëngjisht dhe italisht), fjalorë të këtyre gjuhëve dhe fjalorin terminologjik të termave të gjuhësisë si edhe disa materiale të konsultuara nga Interneti.

Një pjesë e këtyre autorëve, në kuadër të trajtimit të çështjeve të tjera, kanë trajtuar edhe çështje që kanë të bëjnë me periudhën me fjali të nënrenditur kushtore, por nuk janë prekur të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me raportet kushtore e nuk është bërë ende një përpjekje për t'i grupuar mjetet dhe format e shprehjes së raporteve kushtore në një sistem.

Për të nxjerrë lëndën gjuhësore të nevojshme për arritjen e qëllimit të këtij punimi kemi vjelë e skeduar një korpus prej mbi 75 veprash artistike të mirëfillta, të autorëve shqiptarë të mirënjohur brenda dhe jashtë kufjeve të Shqipërisë (pjesa më e madhe romane), por edhe tregime e vëllime me poezi, vëllime me fjalë të urta, vepra të Folklorit dhe një numër gazetash dhe librash të stilit tekniko-shkencor e juridiko-administrativ.

Krahasimi përmes shembujsh të nxjerrë nga thujtë të gjitha stilet e gjuhës së shkruar letrare apo në variantin dialektor, por edhe duke konsultuar edhe këngë e fjalë të urta të popullit, gjuha e të cilave qëndron më afër asaj të folur, pasqyron shtrirjen e gjerë të punimit, por edhe synon të vërë në dukje gamën e gjerë të mundësive të shumta të shprehjes së këtyre raporteve.

Metodologjia e ndjekur për arritjen e qëllimit:

Siç dihet, sintaksa përbëhet nga dy pjesë, sintaksa e fjalisë dhe ajo e periudhës. Edhe raportet kushtore shprehen kryesisht në nivelin e periudhës, por edhe në atë të fjalisë. Prandaj ne i kemi vështruar këto raporte në të dyja nivelet.

Klasifikimi e sistemimi i këtij materiali është bërë fillimisht duke u nisur nga mjeti lidhës dhe natyra strukturore-semantike e tyre (lidhëza apo lokucione lidhëzore).

Pas **grumbullimit** të materialit skedat **janë përpunuar** së pari nga pikëpamja e llojeve të mjeteve lidhëse që janë identifikuar gjatë vjeljes dhe **janë klasifikuar** nëpërmjet nënvizimit.

Më tej janë marrë për bazë trajtat kohore dhe mënyrore dhe bashkëlidhja e tyre në fjalitë përbërëse të periudhës me nënrenditje për të përcaktuar tipin e fjalisë kushtore sipas modalitetit që bartin foljet përkatëse.

Më pas secili prej grupeve të skedave është **analizuar** në mbështetje të çështjeve të parashtruara në përmbledhjen e punimit, duke mbajtur parasysh rolin e secilit prej mjeteve të ndryshme në shprehjen e raporteve kushtore ose bashkëveprimin e tyre.

Grumbullimi i materialit, përpunimi i skedave, klasifikimi dhe analizimi i tyre ka çuar në **përgjithësimin** e fakteve teorike dhe të gjitha metodat e ndjekura kanë ndihmuar në nxjerrjen e përfundimeve.

¹⁷T. Topalli, Sintaksa e fjalisë, Gramatikë e gjuhës shqipe, Universiteti i Shkodrës Luigj Gurakuqi, Instituti i Studimeve Albanologjike, sprovë monografike, Tiranë 2011

¹⁸ A. J. Rrota “Gjuha e shkrueme ase vërejtje gramatikore” ASHSH IGJL Botimi I, Botime Françeskane Shkodër, 2006

¹⁹ M. Lambert, Periudha hipotetike në gjuhën shqipe, përkthyer nga V. Dashi dhe përgatitur për botim nga T. Topalli dhe E. Malaj, Botimet Albanologjike, Tiranë 2011

Në një farë mase është përdorur edhe metoda **statistikore** kur është gjykuar se denduria e përdorimit ka qenë e domosdoshme për të nxjerrë dhe argumentuar përfundimet e duhura edhe përmes krahasimit të ndërtimeve të ndryshme.

Terminologjia

Gjatë punimit është vënë në dukje terminologjia e përdorur në gramatikat e konsultuara dhe përballja e termave si: frazë, periudhë, fjali e përbërë; hipotezë apo kusht; hipotetike apo kushtore; protazë dhe fjali kryesore, apodozë dhe fjali e nënrenditur; adverbial apo ndajfoljor dhe rrethor; korrelacion dhe bashkëlidhje kohore, etj.

Përdorimi i njërit apo tjetrit term ka qenë çështje zgjedhjeje nga ana e autorëve, në varësi të ndikimit të gjuhës së huaj të përdorur (sidomos i latinishtes) në fushën studimore të autorit përkatës.

Në këtë punim janë parapëlqyer termat: fjali drejtuese (kryesore ose jo), fjali e nënrenditur, periudhë me fjali të nënrenditur, kusht (i mundshëm, i pamundshëm) kushtore, rrethor kushti, bashkëlidhje kohore e mënyrore, hipotezë, hipotetik (për sistemin), etj.

Struktura

Punimi është ndërtuar nga 5 krahë.

Në fillim, në parathënie argumentohet nevoja e studimit të kësaj teme, përcaktohet objekti, qëllimi, metodologjia e ndjekur për arritjen e qëllimit, flitet shkurt për terminologjinë e punimeve të mëparshme dhe të këtij punimi dhe pastaj parashtrahet shkurt lënda.

Në **Kreun I**, flitet për raportet sintaksore që janë marrëdhënie që vendosen mes njësisive të ndryshme sintaksore. Meqenëse për shprehjen e tyre përdoren mjete të ndryshme, në fokusin e këtij punimi kanë qenë kryesisht **mjetet sintaksore** që shërbejnë për shprehjen e këtyre raporteve si - **mjetet lidhëse**: lidhëzat dhe lokucionet lidhëzore dhe **fjalët lidhëse**: ndajfoljet lidhore dhe përemrat lidhorë; - pranëvënia/asindetizmi, - rendi (si mjet ndihmës) dhe **mjetet morfologjike**-trajtat e fjalëve që këtu janë vëzhguar në aspektin e formave që marrin në kohë e mënyra të ndryshme gjatë eptimit, për të shërbyer nëpërmjet bashkëlidhjes së tyre si mjet shprehës shoqërues për mjetin lidhës në periudhat me fjali të nënrenditura.

Megjithëse të përmendura në fund, **mjetet fonetike** luajnë gjithashtu një rol me jo pak rëndësi, sidomos në ndërtimet asindetike, ku fjalitë nëpërmjet pranëvënies, fitojnë kuptimin përkatës nëpërmjet intonacionit. Bazuar pikërisht në këtë parashtrim të shkurtër njohës për mjetet dhe mënyrat e shprehjes së raporteve kushtore punimi vijon me përqendrimin në shprehjen e njërit prej llojeve të këtyre raporteve sintaksore, atyre kushtore. Trajtimi i tyre fillon me vërshtimin për trajtimin e derisotëm të këtyre raporteve në punime të gramatikanëve në vite për të vënë në dukje se cilat nga këto mjete janë trajtuar dhe në ç` masë është trajtuar secili prej tyre. Në këtë kre, vështrimi për trajtimin e derisotëm të raporteve kushtore vazhdon me ballafaqimin e terminologjisë së përdorur në vite nga gramatikanët në lidhje me raportet kushtore dhe

mjetet e shprehjes së tyre. Në fund të tij shpjegohet terminologjia që do të përdoret gjatë punimit në lidhje me këtë çështje.


Në **Kreun II** trajtohen çështje të klasifikimit të periudhave me fjali të nënrenditur duke i renditur kronologjikisht autorët dhe parimet sipas të cilave ata i kanë klasifikuar këto periudha. Pas paraqitjes së kriterëve të klasifikimit që njihen e zbatohen nga gramatikanët janë vënë në dukje disa të meta të secilit prej klasifikimeve.

Pasi është sqaruar se cila është njësia sintaksore që është marrë për bazë në klasifikime të ndryshme; fjali, periudhë, frazë, fjali e përbërë. Është vënë re përdorimi në vend të njëri-tjetrit i termave fjali, periudhë, frazë.

Klasifikimi sipas modalitetit është paraqitur nëpërmjet disa skemave të thjeshta me ngjyra të ndryshme për të vënë në dukje dallimin nga një autor te tjetri.

Klasifikimi i periudhave me fjali të nënrenditur është paraqitur në formën e skemave të ndryshme për t'i dalluar llojet e fjalive të nënrenditura që numëron secili prej autorëve dhe për të bërë më të qartë pozicionin që zë fjalia e nënrenditur kushtore në këto klasifikime.

Në **Kreun III** të punimit është trajtuar çështja e grupimit të tërësisë së mjeteve dhe formave të shprehjes së raporteve kushtore në sistemin hipotetik të gjuhës shqipe.



Të gjitha këto forma dhe mjete, duke bashkëvepruar me njëra-tjetrën apo duke marrë përparësi sipas rastit, veprojnë të gjitha në emër të sistemit për të shprehur raportet kushtore. Në kuadër të mbështetjes së këtij këndvështrimi të ri, janë trajtuar si nënçështje ato të evolucionit të këtij sistemi duke filluar me evolucionin e mjeteve lidhëse, më pas të bashkëlidhjes së trajtave kohore e mënyrore të foljeve kallëzues dhe

nënçështjen e mjeteve të shprehjes së raporteve kushtore si pjesë përbërëse të nënçështjes që trajton veçoritë dialektore të sistemit hipotetik në raport me gjuhën standarde. Për të pranuar mundësinë e vështrimit tërësor të këtyre raporteve në kuadër të sistemit hipotetik, ka qenë e nevojshme njohja dhe studimi i një literature teorike në gjuhë të huaj, për të parë se si vështrohet e trajtohet kjo çështje në to.

Kreu IV zë pjesën më të madhe të punimit. Në këtë kre trajtohen raportet kushtore për nga mënyra e shprehjes së tyre në nivelin e periudhës dhe në nivelin e fjalisë.


Pjesa e parë e këtij kreu ku pasqyrohet shprehja e raporteve kushtore në periudhë është e organizuar në mënyrë të tillë që fillimisht analizohen periudhat në të cilat fjalitë bashkohen me mjete lidhëse (lidhëza e lokucione lidhëzore kushtore) dhe po në këtë pjesë edhe me lidhëza të tjera nënrenditëse (kohore: **si**, **kur**) dhe bashkërenditëse. Në po këtë pjesë, janë trajtuar edhe periudhat në të cilat fjalitë bashkohen me përemrin lidhor **kush**, i cili zakonisht shërben për të bashkuar fjalitë në periudhën me fjali të nënrenditur kryefjalore. Për secilën prej mjeteve lidhëse (lidhëza e lokucione lidhëzore kushtore) është mbajtur parasysh dhe është trajtuar: formimi, shtrirja dhe përdorimi i fjalive me këto mjete, lloji i kushtit që shprehin duke mbajtur parasysh rolin e mjetit lidhës në përcaktimin e kuptimit modal të kushtit, mënyrat me të cilat shkon ky mjet lidhës.

Pjesën e dytë të këtij kreu e zë trajtimi i periudhave me fjali të nënrenditur kushtore, në të cilat fjalitë bashkohen pa mjete lidhëse. Në përbërje të kësaj nënçështjeje janë trajtuar periudhat në të cilat fjalitë fillojnë me foljen kallëzues të mënyrës lidhore dhe ato që bashkohen me anë të pranëvënies.

Si mjete të tjera të shprehjes së raporteve kushtore në nivelin e periudhës në punim janë trajtuar format e pashtjelluara: forma paskajore geqe, forma mohore dhe në një masë më të vogël forma përcjellore. Si raste më të rralla të shprehjes së raporteve kushtore në nivelin e periudhës janë përmendur ato me mbiemra prejpjesorë. Pjesa e dytë e këtij kreu përfshin trajtimin e raporteve kushtore në nivelin e fjalisë që realizohet nëpërmjet rrethanorit të kushtit, i cili përfaqësohet nga shprehja me ndajfolje mënyre (**ndryshe**, **përndryshe**) a kohe (**pastaj**, **atëherë**) dhe me emra me parafjalët **me**, **pa** ose emrin me parafjalë **në rast**, të pasuar nga një emër në rasën rrjedhore a gjinore dhe me mbiemra prejpjesorë.

Pasqyrimi në tabelë i mjeteve lidhëse të numëruara nga gjuhëtarë të ndryshëm gjatë shtjellimit, ndër të tjera edhe të periudhës me fjali të nënrenditur kushtore, është bërë për të dalluar përdorimin apo jo të secilës prej mjeteve lidhëse dhe për të bërë krahasimin në periudha të ndryshme gjatë të cilave kanë jetuar e punuar këta gjuhëtarë se cilat mjete lidhëse ishin karakteristike për shprehjen e raporteve kushtore.

Brenda po këtij kreu, por me tjetër synim është ndërtuar grafiku i paraqitur edhe më poshtë mbi bazën e të dhënave të nxjerra drejtpërdrejt nga vjelja e kryer në funksion të hartimit të këtij disertacioni, për të pasqyruar frekuencën e përdorimit të mjeteve lidhëse lidhëza/lokucione lidhëzore, apo edhe të mjeteve të tjera të shprehjes së raporteve kushtore.



Kreu V i punimit i kushtohet rendit/topikës, që numërohet në radhën e mjeteve sintaksore të shprehjes së raporteve kushtore, si mjet ndihmës. Rendi i gjymtyrëve trajtohet në nivelin e fjalisë dhe rendi i fjalive trajtohet në nivelin e periudhës.

Përfundimet paraqesin në mënyrë të përmbledhur problematikën e trajtuar gjatë punimit dhe pasqyrojnë rezultatet e arritura.

Lista e veprave të vjela dhe **bibliografia** e ndarë në rubrikat: gramatika, studime sintaksore, fjalorë, materiale nga interneti apo repertor bibliografik, edhe pse janë vendosur në fund të punimit, përbëjnë, për nga rëndësia që kanë, burimin kryesor të tij.

FALËNDERIME DHE MIRËNJOHJE

Falenderimin kryesor dhe mirënjohjen më të thellë ia dedikoj prof. Seit Mansakut, i cili pranoi të më udhëheqë dhe të më drejtojë në përgatitjen e këtij disertacioni. Ai pati dashamirësinë të më orientojë drejt materialeve ndihmëse që m'u desh të konsultoja dhe t'i lexojë me vëmendje e me sy kritik pjesët e njëpasnjëshme të punimit, derisa ai arriti në formën përfundimtare që paraqitet sot. Mbështetja e tij e pakursyer edhe këshillat mjaft të vlefshme më ndihmuan ta përmirësoj punimin, i cili është vazhdim dhe thellim i një pune të nisur për marrjen e diplomës Master. Materiali i mbledhur për përgatitjen e tezës së Masterit, ishte mjaft i pasur dhe disa çështje që lidhen me raportet kushtore, të cilat nuk u arritën të trajtoheshin të plota ose fare, janë bërë objekt i këtij punimi disertacioni.

Shpreh këtu mirënjohjen time edhe për departamentin e Gjuhësisë të Fakultetit të Historisë e Filologjisë, që më mundësoi ndjekjen e këtij programi studimi, miratimin e temës së propozuar të disertacionit, e sidomos pranimin e modifikimit thjesht formal të saj, mbështetur në kërkesën time të arsyetuar e të argumentuar.

Falenderoj drejtuesit e fakultetit Histori-Filologji dhe një falenderim të veçantë shpreh për përgjegjësen e këtij departamenti, znj. Aljula Jubani, që në çdo rast ka patur mirësinë të më ndihmojë.

Falenderoj profesorët e nderuar prof. Tefë Topalli, prof. Thoma Dhima, të cilët nuk ma kursyen ndihmën e tyre, nëpërmjet orientimit për përgjigje në lidhje me pyetje të ndryshme që lidheshin me çështjet e trajtuara në punim. Me nderim e respekt kujtoj të ndjerin prof. Menella Totoni, i cili më ka rrënjosur që studente disa koncepte mjaft të rëndësishme të sintaksës.

Thellësisht nga zemra falenderoj familjen time për durimin, mirëkuptimin dhe mbështetjen e vazhdueshme.

HYRJE

Me ndërtimet kushtore kemi mundësi të shprehim:

Justifikim: Po të më kishe paralajmëruar, për ardhjen tënde, do të të kisha pritur në stacion. (Nuk të kam pritur, sepse ti nuk më parajmërove.)

Keqardhje: Nëse do të kisha luajtur 5, 7 dhe 16, do ta kisha fituar unë gjithë atë shumë. (Luajta numrat 5, 7 dhe 15, prandaj nuk fitova.)

Shfajësim: Po ta kisha ditur që po flije, nuk do të të kisha telefonuar. (Më fal që të zgjova, por nuk e dija që po flije.)

Hipotezë: Të kishe qëndruar në shtëpi, s`do të ishe përfshirë edhe ti në aksident. (Ti nuk qëndrove në shtëpi, prandaj u dëmtove edhe ti nga aksidenti.)

Falenderim: Sikur të mos më kishe ndihmuar ti, s`do ta kisha mbaruar kaq shpejt këtë punë. (E mbarova falë ndihmës sate.)

Arsyetim a përfundim: Po të ishte kthyer, do të kishte dritë në shtëpinë e tij. (Ai e mban dritën ndezur, kur ndodhet në shtëpi. Nuk është kthyer, sepse në shtëpi nuk ka dritë.)

Përpjekje për të gjetur shkaktarin: Sikur të mos më kishe folur pa pushim, do ta kisha përfunduar së lexuari librin. (Ti u bëre shkak që s`e përfundova.)

Shpjegim të shoqëruar me qortim: Sikur të mos bëje gjithë kohës gabime, do të të kisha marrë me vete. (Nuk të mora me vete, sepse e di që ti bën gjatë gjithë kohës gabime.)

Kërcënim: Në qoftë se vazhdoni të bëni zhurmë, do t`i telefonoj policisë. (Bëni mirë të mbani qetësi.)

Vendim: Në qoftë se nuk vjen deri në mesditë, do të iki. (Do ta pres deri në mesditë.)

Detyrim: Po qe se do të shkojmë të banojmë në periferi, do të na duhet të blejmë një makinë. (Do të shkojmë të banojmë në periferi.)

Projekt për të ardhmen: Në qoftë se do të marr kredi, do të kompletoj shtëpinë me gjithçka që mungon. (Kam dëshirë ta kem shtëpinë sa më të mirë.)

Parashikim: Në qoftë se qeveria nuk i kufizojmë shpenzimet, në fund të muajit do të jemi pa para (Jemi në gjendje të vështirë financiare.)

Dëshirë: Në qoftë se fitoj në llotari, nuk do të punoj më, jam lodhur vërtet. (Këtë herë jam më afër se kurrë.)

Për të kërkuar një favor: Në qoftë se do të më ndihmosh të arrij në kohë, do të të jem mirënjohës. (Më duhet ndihma jote.)

Bazuar pikërisht mbi këto mundësi të shprehjes së marrëdhënieve kaq të larmishme ndërmjet fjalive në periudhën me fjali të nënrenditur kushtore, apo edhe në alternimin e mjeteve të tjera të shprehjes së raporteve kushtore, e sigurisht edhe në faktin që, në njëfarë mase, çdo ngjarje e jetës sonë është kusht për ndodhjen e një tjetre apo rezultat i një kushtëzimi të mëparshëm, çështjet që lidhen me kushtin, pasojën dhe ndërtimet me to në përbërje, menduam t`i studiojmë më gjerësisht nga pikëpamja teorike dhe ajo e realizimit në të shprehur në formën e folur apo të shkruar.


KREU I

TRAJTIMI I DERISOTËM I RAPORTEVE KUSHTORE NË GJUHËN SHQIPE

1.1 Raportet sintaksore

Raportet kushtore janë pjesë e raporteve sintaksore që vendosen mes njësive të ndryshme sintaksore, prandaj po e fillojmë këtë krye me një vështrim të përgjithshëm për raportet sintaksore. Kuptimi i fjalës raport është: “*Lidhje e ndërsjellë ndërmjet sendeve, dukurive ose veprimeve të ndryshme; raport.*”²⁰ Këto raporte sintaksore i gjejmë në fjali dhe në periudhë. Në secilën prej tyre raportet sintaksore janë të barazisë dhe të varësisë. Në të dyja rastet si në fjali ashtu edhe në periudhë, ne interesohemi për raportet e varësisë. Në fjali këto raporte varësie studiohen ndërmjet gjymtyrëve kryesore dhe të dyta, kurse në periudhë raportet e varësisë studiohen ndërmjet fjalive kryesore dhe të nënrenditura që bashkohen ndërmjet tyre me ose pa lidhëza.

Skema 1



²⁰ Fjalor i shqipes së sotme, ASHRSH, IGJL, Tiranë 1984, f. 670

Me anë të këtyre rrathëve bashkëqendrorë jemi përpjekur të paraqitim skematikisht pikërisht faktin që raportet kushtore të cilave u është përkushtuar punimi janë pjesë përbërëse e raporteve të varësisë në periudhë dhe e raporteve sintaksore të llojeve të ndryshme në tërësi.

Tabelat e numërtuara më poshtë paraqitin skematikisht mënyrën e klasifikimit të mjeteve dhe mënyrave me të cilat shprehen raportet sintaksore sipas gramatikës së Akademisë dhe sipas disa prej autorëve që i kanë trajtuar këto raporte.

Tabela nr. 1

Mënyrat dhe mjetet e shprehjes së raporteve sintaksore Sintaksa e Akademisë

1. Forma e fjalës (eptimi)	
2. Fjalët ndihmëse a shërbyese	<ul style="list-style-type: none"> • a) parafjalët • b) lidhëzat • c) përemrat e ndajfoljet lidhore e pyetëse • ç) pjesëzat • d) pa mjete lidhëse (pranëvënia, bashkimi i thjeshtë) • e) rendi i fjalëve, i gjymtyrëve dhe i fjalive
3. Intonacioni	<ul style="list-style-type: none"> • a) melodika • b) pauzat • c) theksi, theksi logjik • ç) bashkeveprimi i mjeteve intonacionore

Tabela nr. 2

Mjetet e shprehjes së raporteve kushtore sipas sintaksës së Akademisë të grupuara në tri grupe sipas pjesëve të gramatikës

Morfologjike	<ul style="list-style-type: none"> - trajta e fjalëve (eptimi/fleksion i)
Sintaksore	<ul style="list-style-type: none"> - fjalët ndihmëse a shërbyese (lidhëza/fjalë lidhëse e parafjalë) - pranëvënia (parataksa), asindetizmi - rendi (topika)
Fonetike	<ul style="list-style-type: none"> - intonacioni

Siç mund të shihet nga të dyja tabelat që paraqesin llojet e mjeteve me të cilat shprehen raportet kushtore, kuptohet që, të grupuara ose jo, këto mjete tregojnë rëndësinë më të madhe të mjeteve sintaksore kundrejt atyre morfologjike e fonetike, si për nga numri që vetë pjesa përkatëse e gramatikës ka mundësi të ofrojë, ashtu edhe nga lidhja e tyre me formën e shkruar dhe praktikitetin. Madje edhe brenda vetë mjeteve sintaksore, ndonjëri prej tyre, si p. sh. rendi i gjymtyrëve a i fjalive luan rol ndihmës në raport me mjetet e tjera.


Këto mjete janë trajtuar edhe nga S.Prifti²¹, i cili në vend të termit raporte ka përdorur termin “*Mjetet e shprehjes së lidhjeve sintaktike*” dhe mjetet që numërohen prej tij janë të njëta me ato që jepen edhe në gramatikën aktuale të gjuhës së sotme shqipe, megjithëse nuk klasifikohen në grupet e mëdha sipas pjesëve të gramatikës (fonetike, morfologjike dhe sintaksore).

²¹ “*Mjetet gjuhësore me të cilat shprehen lidhjet sintaktike janë: a) fleksioni, d.m.th. format e ndryshme që marrin fjalët, të cilat hyjnë në lidhje sintaktike; b) fjalët ndihmëse (parafjalët lidhësat); c) renditja ose rendi i fjalëve; ç) Intonacioni*”, Sintaksa e gjuhës shqipe, pjesa e I-rë, Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë, Katedra e gjuhës shqipe, Tiranë 1959, f. 26

Për S. Mansakun raportet kushtore [pikërisht në këtë terminologji është mbështetur ky punim] shprehen me mënyra e forma të ndryshme, sipas tipeve strukturore dhe sipas shkallës së qartësisë së semantikës së kushtit.²²

Tabela nr. 3

Format e shprehjes se raporteve kushtore sipas S. Mansakut



1. Periudha me fjali te varur kushtore	<ul style="list-style-type: none"> • lidhezore-kushtore • jolidhezore-kushtore (m. lidhore) • me f. te pashtjelluara (percjellore, mohore)
2. Periudha me fjali asindete	
3. Periudha me fjali te bashkerenditura edhe me marredhenie kushtore	<ul style="list-style-type: none"> • vecuese • kepujore • kundershore
4. Periudha me fjali te tjera te varura	<ul style="list-style-type: none"> • kohore • shkakore • peremerore (p. lidhor te pacaktuar) • krahasore te rritjes perpjestimore
5. Plotesoret e kushtit	

Sikurse është e dukshme edhe ky autor e mbështet punimin e tij mbi ndarjen filimisht të periudhave sipas pranisë ose mungesës së mjetit lidhës dhe periudhën e konsideron si formën kryesore të shprehjes së raporteve kushtore. Edhe për të raportet kushtore shprehen edhe me forma të tjera, përveçse me mjete lidhëse (lidhëza/lokucione lidhëzore e përemra a ndajfolje lidhore), të cilat janë paraqitur në tabelën nr. 3 më sipër.

M. Totoni gjithashtu flet për raportet kushtore, por nuk i emërton mjete të shprehjes së raporteve sintaksore, por mjete të formësimit të frazës me nënrenditje. “*Si të tillë do të ishin: fjala mbështetëse, mjeti i lidhjes, karakteri i lidhjes, rendi i fjalive dhe aktualizimi i frazës, rendi i gjymtyrëve të fjalive, bashkëlidhja kohore e mënyrore e*

²² S. Mansaku, “Rreth formave të shprehjes së raporteve kushtore në shqipen e sotme letrare”, SF 1969/3, f. 153

foljeve kallëzues, etj. këta janë edhe faktorë që përcaktojnë edhe marrëdhënien kuptimore që vendoset ndërmjet fjalive.”²³

Tabela nr. 4

Mjete të formësimit të frazës me nënrenditje sipas M. Totonit



Siç duket nga tabela nr. 4, M. Totoni njih dhe numëron një mjet më tepër të formësimit të frazave, pikërisht korelatin ose fjalën mbështetëse të cilat ai i ka marrë për bazë gjatë klasifikimit të frazave me nënrenditje, kurse mjetet e tjera janë po ato të numëruara nga sintaksa e Akademisë.

Fjalët e bashkëlidhura, si mjet shprehës i raporteve sintaksore janë marrë parasysh nga S. Floqi, M. Totoni dhe nga Sintaksa e Akademisë së Shkencave.

Pavarësisht renditjes së ndryshme të tyre nga M. Totoni, përveç korrelatit, mjetet më të rëndësishme që mbahen parasysh gjatë analizës së secilës prej frazave me nënrenditje janë mjeti lidhës, dhe, në fraza të caktuara bashkëlidhja kohore e trajtave

²³ M. Totoni, Frazë me nënrenditje, SHBLU, Tiranë 2000, f. 15

kohore e mënyrore të foljeve kallëzues të fjalive në përbërje të frazës. Mjetet e tjera luajnë rol ndihmës në formësimin e frazave.

1.2 Raportet kushtore, trajtimi i derisotëm

Siç u theksua edhe më sipër raportet kushtore janë pjesë e raporteve sintaksore, ashtu si ato kohore, vendore, etj.

Punimi është përqendruar në konstatimin, marrjen parasysh dhe interpretimin e mjeteve sintaksore të shprehjes së raporteve kushtore. Për këtë arsye në kreun e shprehjes së raporteve kushtore renditja e çështjeve që janë trajtuar është bërë pikërisht duke u nisur fillimisht nga mjetet lidhëse me të cilat bashkohen fjalitë brenda periudhës dhe më pas janë renditur mjetet dhe format e tjera të shprehjes së këtyre raporteve.

Çështjen që po trajtojmë e kemi parë edhe në një vështrim morfosintaksor, sidomos për sa i përket mënyrës së ndërtimit të lidhëzave dhe lokucioneve lidhëzore që përdoren për të bashkuar fjalitë në periudhën me fjali të nënrenditur kushtore. (koha dhe mënyrat në të cilat gjendet folja **jam** p.sh.: në lokucionet lidhëzore që e kanë në përbërje atë: **është, qe, qoftë, të jetë, qenka (në është se, në qoftë se, në qe se, në qenka se, po të jetë se, po qe se, po qenka që)**, por edhe shtrirjes në përdorim të kohëve dhe mënyrave të foljeve kallëzues që shërbejnë si bërthama kallëzuesore për fjalitë e nënrenditura kushtore.

Duke i vlerësuar si ndihmesa të çmuara për gjuhën shqipe tekstet në të cilat janë trajtuar çështje gramatikore, ato të Françesko M. da Leçes²⁴, William Martin-Lake²⁵, Johan Georg von Hahn²⁶, Francesco Rossi²⁷, Auguste Dozon²⁸, Kostandin Kristoforidhi²⁹, Sami Frashëri³⁰, Gustav Meyeri³¹, Holger Pedersen³², Gjergj Pekmezi³³, theksojmë se arsyeja për të cilën nuk e kemi filluar vështrimin historik prej tyre është se në to nuk janë trajtuar çështje që kanë të bëjnë me raportet kushtore dhe mjetet e format për shprehjen e tyre. Për këtë arsye trajtimin e kemi filluar duke u

²⁴ F. M. da Leçe, Osservazioni grammaticali nella lingua Albanese (Vërejtje gramatikore në gjuhën shqipe), Romë, 1716

²⁵ William Martin-Lake, Researches in greece, sketch of the grammar (Kërkime në Greqi, skicë e gramtikës), Londër 1814

²⁶ Johan Georg von Hahn, Albanesische studien, beitraege zu einer grammatik der toskischen dialektes (Studime mbi shqiptarët, konstruktet për një gramatikë të toskërishtes), 1854

²⁷ Francesco Rossi, Regole grammaticali della lingua albanese (Rregulla gramatikore të gjuhës shqipe), 1866

²⁸ Auguste Dozon, Manuel de la langue chqipe ou albanaise, Paris 1879

²⁹ Kostandin Kristoforidhi, Grammatiki tis albanikis glossis 1882

³⁰ Sami Frashëri, Shkronjëtoje e gjuhës shqip, 1886

³¹ Gustav Meyeri, Kurzgefasste albanesische grammatik 1888

³² Holger Pedersen, Albaneisische texte mit glossar 1895

³³ Gjergj Pekmezi, Grammatik der albanesischen sprache 1908

mbështetur te ato gramatika në të cilat kemi gjetur (në ndonjë prej tyre qoftë edhe “ndërmjet rreshtave”) të përmendur [ndoshta jo të trajtuar] ndonjë nga mjetet e shprehjes së raporteve kushtore.

Raportet kushtore janë trajtuar nga disa autorë. Duke i parë në rend kronologjik, sipas viteve të botimit të teksteve të gramatikave, do të rendisim këtu më poshtë çështjet që kanë të bëjnë me mjetet e shprehjes së raporteve kushtore, që secili prej autorëve ka trajtuar në gramatikën përkatëse.

A. M. Xanoni: “Gramatika shqyp qi përdoret n`seminarë e n`mbësoitore t`sh` Françesk Saverit n Shkodër”, *Shtypshkronja e Zojës Papërlyeme N` Shkodër 1909*

Në gramatikën e A. M. Xanonit, te pjesa për lidhëzat, numërohen, ndër të tjera, lidhëzat **n` n, me kënë se dhe kuer** të tipit me qyshke, siç i quan ai dhe për funksionin e tyre “*qi bashkojnë propozicione, ndër të cilat, njeni sosh ndërthen qyshken ku a pshtetë t`dalunit e ndoi sendit qi diftohet prej propozicionit tjetër.*”³⁴. Një nga shembujt që ai jep për të konkretizuar këtë që thotë është një periudhë: “*Na kaa dhanë Zoti fialën me na i ndigiu lutat: ne ja bâishim si duhet*”. Në këtë shembull fjalia e nënrenditur, e ndarë nga kryesorja me dy pika (:), duket se është kushtore prej lidhëzës që bashkon dy fjalitë, por gjithashtu edhe nga bashkëlidhja e trajtave kohore të foljeve në të dyja fjalitë që ndërtojnë periudhën e përbërë; përkatësisht në atë që duket të jetë e nënrenditura kushtore që fillon me lidhëzën **ne**, kemi kohën e tashme të mënyrës dëshirore (formë dialektore) bajshim dhe në fjalinë tjetër kemi një paskajore (gjithashtu formë dialektore) me ndigiu e cila, nga njëra anë, shërben si fjali drejtuese për të nënrenditurën kushtore dhe, nga ana tjetër, shërben si e nënrenditur filluese kundrinore e cila do të ishte në gjuhën letrare e barazvlerëshme me fjalinë lidhëzore: se do të na i dëgjonte lutjet ose me ndërtimin që fillon me mënyrën lidhore të foljes të na i dëgjonte lutjet. Një bashkëlidhje e tillë trajtash kohore është e zakonshme për fjalitë kushtore që bashkohen me kryesoren me lidhëzën në.

Në gramatikën e tij, kur ka kategorizuar mënyrat e foljeve dhe funksionet e kohëve përkatëse të tyre, ai përmend disa shembuj me lidhëzën kushtore **n`**, por gabimet e tij, që me të drejtë i ka kritikuar S. Riza³⁵, qëndrojnë pikërisht në emërtimin e gabuar të mënyrës lidhore dhe të së ashtuquajturës lidhore-habitore si mënyrë kushtore: përkatësisht “*t`ishe un, t`kishe ken un, t`kishe pas un*”³⁶; “*t`kenkshem un, t`paskshem un*”³⁷. Njëllor i gabuar paraqitet kategorizimi i trajtave kohore të së tashmes dhe të së

³⁴ A. M. Xanoni, Gramatika shqyp qi përdoret n`seminarë e n`mbësoitore t`sh` Françesk Saverit n Shkodër, Shtypshkronja e Zojës Papërlyeme N` Shkodër 1909, f. 160

³⁵ S. Riza, Vepra të zgjedhura, ASHRSH, QSA, Tiranë, 2009, f. 425-426

³⁶ A. M. Xanoni, Gramatika shqyp qi përdoret n`seminarë e n`mbësoitore t`sh` Françesk Saverit n Shkodër, Shtypshkronja e Zojës Papërlyeme N` Shkodër 1909, f. 98

³⁷ Po ai, f. 99

kryerës së dëshirores: “n`kiosha un, n`paça kên un, n`paça pas un”³⁸ si kohë të mënyrës kushtore.

Siç del nga shembujt shumë të pakët në lidhje me çështjen që po trajtojmë, marrja në shqyrtim e ndonjëres prej çështjeve që kanë të bëjnë me raportet kushtore apo me ndonjë nga mjetet e shprehjes së tyre, nuk ka qenë objekt i gramatikës së Xanonit, madje, me këto kategorizime të pasakta të mënyrave të foljeve kallëzues, nëse do të trajtonte, bie fjala ndarjen e periudhave kushtore sipas modalitetit, do të kishin rezultuar edhe pasaktësi të tjera që lidhen me modalitetin dhe përdorimin e këtyre trajtave.

G. Mikeli: “Gramatika e giuhës shqype” shtypshkronja “Nikaj” Shkodër 1916

Megjithëse është një gramatikë që më tepër është marrë me fonetikën dhe morfologjinë, në kapitullin për sintaksën³⁹ përmenden: folja (fjalja) e thjeshtë që ka një subjekt e një predikat ose vetëm predikatin, folja (propozicioni), folja e smadhueme ku përfshihen, sipas tij edhe “*atributi, objekti, caktimet e rasavet dhe kryesimet parafjalse*”; “*kryesimet adverbiale*” ndër të cilët ai numëron të vendit, të kohës, të mënyrës, të shkakut a të psehrit, por jo të kushtit; folja përmbledhçë⁴⁰, folja e ujnusun⁴¹ dhe jepen shembuj të analizuar nga ana gramatikore dhe logjike⁴², por asnjë prej këtyre llojeve të foljeve (fjalive) nuk mban emrin a cilësitë e së nënrenditurës kushtore. Ndër lidhëzat që ai numëron gjejmë të përmendura edhe disa kushtore: n`, ne, ndryshej (që e quan lidhëz) dhe no⁴³. Pra edhe ky autor nuk flet për mjete të tjera të shprehjes së raporteve kushtore, përveçse për një prej lidhëzave [lidhëza **në** në dy variante fonetike **n`** dhe **no**, sepse **ndryshej**, në fakt, është ndajfolje mënyre dhe jo lidhëz.]

A. Xhuvani: Njohunit e para të syntaksës shqipe, pjesë parë për Klasët e nalta të Fillores, Shpallje dytë e përmirësuar, Botim i Ministris` s`Arsimit, Nr. 8, Tiranë, Shtypshkronja Nikaj, 1925

Njohunit e para të syntaksës shqipe për klasët e nalta të Fillores e për t`ultat e Shkollavet të Mesme, Tiranë 1938

“*Libri i gjuhës shqipe, pj. II*”, Tiranë 1942

1. Nga lidhëzat kushtore Xhuvani përmend vetëm lokucionin lidhëzor në qoftë se kur e numëron së bashku me llojet e tjera të lidhëzave që bashkojnë një fjali të parë me një fjali të varur. Pasi jep përkufizimin e periudhës si: “*Bashkim i dy*

³⁸ Po ai, po aty.

³⁹ G.Mikeli, Gramatika e giuhës shqype shtypshkronja “Nikaj” Shkodër 1916, f.123

⁴⁰ Po ai, f. 128

⁴¹ Po ai, f. 129

⁴² Po ai, f. 130-131

⁴³ Po ai, f. 123

a mâ shumë fjalivet, të lidhuna me një mënyrë që të rrëfejnë një mendim të *plotë*.”, jep shembuj, ndër të cilët, edhe me lokucionin lidhëzor në qoftë se. Megjithëse autori nuk numëron lidhëza të tjera kushtore në pjesën e parë të tekstit të sintaksës të vitit 1925, ai jep rregullën gramatikore që duhet ndjekur dhe shembullin sipas të cilit dy fjali, njëra pyetëse dhe tjetra urdhërore të kthehen në një periudhë me fjali të lidhuna bashkë: “Çdo fjali pyetëse le të kthehet në fjali të varme me lidhëzën **në qoftë se** ase me lidhoren **po qe**; fjali urdhënuese të kthehet në fjali të parë. Shembull: **Në qoftë se** është grisun pak rrobja e jote, qepe ase duhet ta qepish; **Po qe** grisun pak rrobja e jote, qepe.”⁴⁴ Në pjesën e dytë të po këtij teksti, pikërisht në ndarjen për farët e fjalive, te nënçështja e fjalive të lidhuna bashkë, kur flet për fjalitë kushtore si një nga farët e fjalive të varme, nga mjetet lidhëse ai numëron edhe lokucionin lidhëzor **po qe se**, pjesën e parë të të cilit, e kishte emërtuar lidhore (**po qe**); si edhe lidhëzat kushtore: **në**, lidhëzën kushtore **po**, me të cilën sjell ndërtimin **po të** dhe lidhëzën mënyrore **sikur**, me të cilën përsëri sjell ndërtimin **sikur të**.

Në botimin e vitit 1942 A. Xhuvani i ndan lidhëzat në të thjeshta dhe të përngjitura dhe jep si shembuj lidhëzat **po**, në qoftë se, në (nga lidhëzat kushtore).

2. Llojet e fjalive të nënrenditura te ky autor i gjejmë me termin fjali të lidhuna bashkë: “Fjalit e lidhuna bashkë janë fjali të varme qi lidhen me fjalin e parë me anë të lidhëzave: ... **të**, ... **në qoftë se** ...”⁴⁵ (që mund të jenë kryefjalë, kundrinë ose të tregojnë kohë) që, ai rendit edhe fjalinë që tregon kusht.

E reja qëndron në barazimin që i bëhet ndërtimit **po qe**: “lidhëza **po** me vetën e tretë të së kryerës së thjeshtë të foljes jam (qe)”, me mënyrën lidhore e cila bëhet e qartë në shembullin që jep vetë autori për të treguar mënyrën e se si duhet të ndërtohen fjalitë e tjera të ushtrimit, ndërkohë që një ndërtim i tillë s’është gjë tjetër veçse ai i përbërë nga lidhëza kushtore **po** dhe e kryera e tejshkuar e foljes jam.

Nga ana tjetër shembujt e sjellë për zgjidhje, përveçse konkretizojnë rregullën teorike që ka dhënë pak më përpara, sjellin tërthorazi disa raste bashkëlidhësh kohore, që janë tipike për periudhat me fjali të nënrenditur kushtore.

Në asnjë nga këto tekste A. Xhuvani nuk e përmend rrethanorin e kushtit në listën e plotësorëve që numëron. Në dy tekstet e para ai numëron dhe jep shembuj për plotësorët e vendit, të kohës, të mënyrës, të shkakut, të çfarësisë, të mjetit dhe të veglës.

M. Lambertz, Periudha hipotetike në gjuhën shqipe, përkth. nga V. Dashi, IGJL A-8 Sintaksa, f. 1

⁴⁴ A. Xhuvani, Njohunit e para të sintaksës shqipe, pjesë e parë për Klasët e nalta të Fillores, Shpallje dytë e përmirësime, Botim i Ministrisë së Arsimit, Nr. 8, Tiranë, Shtypshkronja Nikaj, 1925, f. 46

⁴⁵ A. Xhuvani, Njohunit e para të sintaksës shqipe, pjesë e parë për Klasët e nalta të Fillores, Shpallje dytë e përmirësime, Botim i Ministrisë së Arsimit, Nr. 8, Tiranë, Shtypshkronja Nikaj, 1925, f. 42

Periudha hipotetike në gjuhën shqipe, përkthyer nga V. Dashi dhe përgatitur për botim nga T. Topalli dhe E. Malaj, Botimet Albanologjike, Tiranë 2011

M. Lambertz-i ka trajtuar paralelisht me mjetet lidhëse të fjalive në periudhën me fjali të nënrenditur kushtore edhe kohën dhe mënyrën e foljes kallëzues të fjalisë së nënrenditur që fillon me lidhëzën përkatëse, por gjithashtu edhe kohën dhe mënyrën e foljes kallëzues me të cilën bashkëlidhet në fjalinë drejtuese, madje në fund të monografisë ai ka paraqitur në një tabelë përmbledhëse të numërtuar deri në 37 raste të mbledhura të bashkëlidhjes së trajtave mënyrore e kohore të foljeve kallëzues në të dyja fjalitë që ndërtojnë periudhën hipotetike, sipas lidhëzave përkatëse apo sipas mjeteve dhe formave të tjera me të cilat del se janë shprehur raportet kushtore në atë periudhë. Me plot gojë mund të thuhet që ky autor ka trajtuar jo vetëm shumë nga mjetet e shprehjes së raporteve kushtore në periudhë, por, edhe pse nuk është i specifikuar, fakti që, ai ka trajtuar, veç lidhëzave/lokucioneve lidhëzore kushtore që bashkojnë fjalitë në periudhë, veç bashkëlidhjes së trajtave kohore e mënyrore të foljeve kallëzues të fjalive në periudhën me fjali të nënrenditur kushtore, edhe disa mjete të tjera të shprehjes së këtyre raporteve siç janë: zëvendësimi i mundshëm i fjalisë së nënrenditur kushtore, herë me *“nji fjali kryesore me indikativin, me një pyetje, independente ose me një shprehje eliptike (parataksë), rasti i proverbave.”*⁴⁶, herë me *“nji fjali relative me një kuptim të përgjithshëm”*⁴⁷, [fjalitë lidhore me përemrin lidhor të pacaktuar kush] apo herë me *“nji particip me prepozicionet me, tui, pa* (kur kuptimi asht negativ), d. m. th. prej përfaqësuesit të infinitivit ose të gerundiumit të gjuhës shqipe”⁴⁸ [këto ndërtime në punimin tonë janë përfshirë në rubrikën e shprehjes së raporteve kushtore në fjali me forma të pashtjelluara foljore] apo me *“nji adverb ose caktim adverbial substantivik”*⁴⁹. Në fokusin e tij kanë qenë edhe pasqyrimi dhe trajtimi i rasteve të bashkimit të fjalive në periudhë me mjetin lidhëz zero, në rastet kur fjalia e nënrenditur fillon me folje kallëzues në mënyrën lidhore; i rasteve kur fjalia e nënrenditur kushtore është në formën mohore; ndarjen, edhe pse në kuadër të trajtimit të periudhës me fjali të nënrenditur kushtore me lidhëzën kushtore **në**, të periudhës me fjali të nënrenditur kushtore në potenciale dhe joreale, duke dhënë për të dyja këto kategori shembuj dhe shpjegimet përkatëse. Ai ka trajtuar gjithashtu edhe pozicionin fjalëve [gjymtyrëve në fakt, sespse këtu flet për pozicionin e subjektit dhe predikatit] në fjalinë e nënrenditur kushtore dhe jo vetëm në fund, por edhe gjatë shtjellimit të çështjeve të ndryshme në lidhje me fjalinë kushtore, e ka treguar se ajo mund të para ose pasvendoset ndaj fjalisë drejtuese.

Shembujt janë të konsiderueshëm të nxjerrë nga tekste të vjetra ose të letërsisë artistike, madje edhe nga proza popullore a tekste fetare, ndonjëherë edhe përsëriten në trajtimin e çështjeve të ndryshme. Lidhëzat janë sjellë edhe në variante dialektore të shoqëruara me shembuj, por sidomos me argumente se si janë ndërtuar ose përfutur

⁴⁶ Po aty, f. 197-198

⁴⁷ Po aty, f. 199

⁴⁸ Po aty, f. 203-217

⁴⁹ Po aty, f. 220

analogjikisht nga ndikimi i ndonjë gjuhe tjetër romane perëndimore apo nga rumanishtja dhe me funksionet e ndryshme që ato kryejnë, përveç atij të bashkimit të dy fjalive përbërëse të periudhës hipotetike. Pas analizës së secilës lidhëz, autori jep paralelisht kohët dhe mënyrat e foljeve që ndërtojnë fjalinë drejtuese dhe atë të nënrenditur të emërtuara apodozë dhe protazë dhe rendin e fjalive, pa lënë mënjanë edhe caktimin e modalitetit të periudhës përkatëse.

Lamberci tregon edhe raste të përdorimit të ndërtimeve me **tui** dhe variantet dialektore (**tue, dukë, dyke**) si fjali kondicionale gjithashtu ai flet për ndërtimet me: **me, pa, mbë** për fjalitë kondicionale që përdoren për të kryer funksione të tjera dhe për zëvendësimin e tyre me fjali të tjera. Sillen gjithashtu shembuj të fjalive kushtore të bashkuara me pranëvënie të cilat prihen nga: **ndo-ndo, o-o, në më-në më, (në mos më)** etj. Fjalitë kanë ndërtim të njëjtë pozitiv ose njëra pozitiv dhe tjetra negativ me “shprehjen **në mos, në jo, jo, jo**, pa verbin”(f.115). Po në këto ndërtime ky studiues i gjuhës shqipe përfshin edhe të ashtuquajturat konstrukte tautologjike. Ai flet gjithashtu edhe për rendin e fjalëve në periudhën hipotetike (f. 117) dhe jepen edhe disa raste të tipit irreal të periudhës hipotetike.

Ilia D. Sheperi, “Gramatika dhe Sintaksa e gjuhës shqipe”, Vlorë 1927

Sheperi e përmend fjalinë kushtore kur flet për mënyrën kushtore: “Kushtorja e shfaq vepërimin si qëllim ose përfundim të një kushti, i cili shfaqet me fjali të dytë (fjali kushtore) ose nënkuptohet. ... **Të** mos kishja punë do të *kishja ardhur*.”⁵⁰ Me një tjetër emërtim fjalinë e nënrenditur Sheperi e përmend edhe kur flet për periudhat me fjali të nënrenditura të cilat i quan të bashkëlidhura: “Fjalit e periudhës, sipas lidhjes që kanë me njërajetrën janë: a) të bashkërenditura,... b) të bashkëlidhura, kur lidhen në mënyrë që njera varet nga tjetëra si plotës i sajë, ose si *ffjali e varme*.”⁵¹

Idenë për bashkëlidhjen dhe llojet e fjalive të bashkëlidhura ai e sqaron më tej në pjesën e sintaksës “Bashkëlidhja” duke dhënë në fillim përkufizimin për fjalinë e nënrenditur: “Nga dy fjali të bashkëlidhura ajò që plotësòn tjetrën merr përpara një nga lidhëzat e bashkëlidhjes, ose një nga përemrat a ndajfoljet lidhore, dhe quhet fjali e varme ose e dytë.”⁵² Kuptojmë nga përmbajtja e përkufizimit se ai pranon që fjalitë [se për periudhën nuk flitet fare në tekst] bashkohen me lidhëza dhe përemra lidhorë si mjete lidhëse, por në ndarjen që u bën, fjalitë e varme i konsideron pjesë të fjalive kryesore, ndërkohë që e ka qartësuar që në fillim të pjesës “Sindaksa” që fjali kryesore quhen ato që plotësohen nga fjalit` e varme.⁵³ Kur merr të trajtojë fjalinë kushtore, të cilën më përpara e ka barazuar me plotësin e kushtit, kuptojmë që kriteri që ka ndjekur për ndarjen në fjali të nënrenditura është ai i paralelizmit me gjymtyrët

⁵⁰ I. D. Sheperi, Gramatika dhe Sintaksa e gjuhës shqipe, Vlorë 1927, f. 166

⁵¹ Po ai, f. 163

⁵² Po ai, f. 171

⁵³ Po ai, f. 139

e fjalisë: “*Fjalit` e varme, si pjesë te fjalive kryesore, sherbejnë në to: ... dh) si plotës kushti (fjali kushti). P. sh. Në punëfsh do të fitosh.*”⁵⁴

Nga mjetet e shprehjes së raporteve kushtore, në gramatikën e I. D. Sheperit konstatuam se ai ka folur për:

1. Lidhëzat: **në, po, të** dhe lokucionet lidhëzore: **në se, në është se, në qoftë se, po të, sikur të** [duke numëruar si lidhëz edhe pjesëzën **të** që shërben për të formuar mënyrën lidhore, madje, duke e konsideruar lokucion lidhëzor dhe **po të**];
2. Trajatat kohore dhe mënyrore të foljeve kallëzues në fjalitë e nënrenditura në periudhën me fjali të nënrenditur kushtore, prej të cilave, sipas tij, kushti paraqitet përkatësisht si i vërtetë dhe i mbaruar: me lidhëzat e lokucionet lidhëzore **në, në se, në është se, në qoftë se** dhe me mënyrën dëftore ose habitore; i pritëm apo i mundëshëm me lidhëzën **në** dhe me mënyrën dëshirore, ose me lokucionet **po të, sikur të** dhe me mënyrën lidhore apo i perealizuar për përfitim e të cilit bashkëveprojnë kohët dhe mënyrat e të dyja fjalive (kryesore - mënyra kushtore dhe e nënrenditur - e pakryera e lidhore ose e habitore) në bashkëvajtje me pjesëzën **të** të mënyrës lidhore (të cilën I. D. Sheperi e konsideron lidhëz) ose me lokucionet **po të, sikur të**;
3. Atë që sot njihet si paskajorja geqe, të cilën e quan mënyrë dhe i jep funksionin e zëvendësimit të mënyrave lidhore e kushtore: “**Me dhënë** fjalën duhet me e mbajtë.”⁵⁵;
4. Nëpërmjet një shembulli është përfshirë si mjet edhe pranëvënia, pra bashkimi i fjalive pa lidhëza [kur fjalia e nënrenditur fillon me folje në mënyrën lidhore]: “...të paskëshe punuar, do të *keshe fituar.*”⁵⁶

A. J. Rrota, Gjuha e shkrueme ase vërejtje gramatikore, ASHRSH, IGJL, Botime Françeskane, Shkodër, 2006

At Justin Rrota në tekstin e tij të gramatikës trajton këto çështje nga raportet kushtore:

1. Përkufizimin e fjalisë së nënrenditur kushtore që ai e quan qyshkore (kondicionale): “*Fjalit qyshkore përmbajn qyshkun, a kushtin mbas së cilit bâhet shka thotë kryefjalija.*”⁵⁷
2. Lidhëzat dhe lokucionet lidhëzore, me të cilat fjalia e nënrenditur bashkohet me kryesoren, por duke i quajtur ato fjalëza: “*Fjalit qyshkore lidhen me kryefjali nepër fjalzat: Në, në mos, në kjoftë se, në (po) kje se, po kje qi, bâna e.*”⁵⁸

⁵⁴ Po ai, f. 172

⁵⁵ Po ai, f. 176

⁵⁶ I. D. Sheperi, Gramatika dhe Sintaksa e gjuhës shqipe, Vlorë 1927, f. 176

⁵⁷ A. J. Rrota, “*Sintaksi i shqipes*”, botimi I, Botime Françeskane, Shkodër 2005, f. 93

⁵⁸ Po ai, po aty

3. Konceptimin e periudhës hipotetike, si unitet midis fjalisë qyshkore dhe kryefjalisë: “Fjalija qyshkore bashkë me kryefjalin përbajn perjudhën hipotetike.”⁵⁹
4. Ndarjen e perjudhës hipotetike, simbas mënyrës, në të cilën kryehet, a mund të kryehet qyshku i vëm.
5. Bashkëlidhjen kohore e mënyrore të foljeve kallëzues të fjalive në periodën hipotetike.

Për fatin tonë të mirë, puna e A. J. Rrotës nuk mbaron me kaq, sepse, në vitin 2006, nga Akademia e Shkencave të Shqipërisë, nëpërmjet Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, na vjen botimi “Gjuha e shkrueme ase vërejtje gramatikore”⁶⁰, nga Botime Françeskane në Shkodër. Në këtë botim voluminoz prej 614 faqesh gjejmë, përveç informacioneve të sipërpërmendura nga botimi i vitit 1943, edhe kriterin e ndjekur për klasifikimin e fjalive të nënrenditura që është ai i paralelizmit me gjymtyrët e fjalisë. Kështu në f. 496 të librit ai thotë: “Kemi njaqë farë fjalish së dyta, sa janë farët a gjymtyrët e fjalisë së thjeshtë.” Fjalinë e nënrenditur kushtore, të cilën e gjejmë edhe me emrin kondicionare ai e vendos në grupin e fjalive të ndajfoljorit (adverbialit), pas fjalive vendore, kohore, mënyrore, dhe pikërisht në grupin e fjalive shkajkore (kauzale) pas fjalive shkakore (kauzale) të mirëfillta, dhe pas fjalive qëllimore (finale). Është pikërisht grupi i tretë brenda fjalive shkakore ai në të cilin shprehet kushti i lidhur me veprimin e kryefjalisë dhe, për rrjedhojë, kundërshtimi a pengimi, fjalitë e të cilit janë fjali kushtore (kondicionare).

E gjejmë me vend të përmendim këtu edhe tri vërejtje të sjella nga autori në formën e rregullave apo këshillave që kanë të bëjnë me përdorimin e kohëve e mënyrave të foljeve të fjalive kushtore dhe lidhëzave që bashkojnë pjesën kryesore me të nënrenditurën kushtore. Vërejtja e parë vjen si një rregullë përgjithësuese, sipas së cilës, “ndër fjali kushtore, shkon zakonisht, koha e mënyrës dëshirore. Nuk përliqjet prandaj përdorimi i lidhës në këtë rasë: **Në mos shkojsh ti, po shkoj vetë.**” *Vërejtja e dytë është këshillë që të dallohen kohët e dy “të thanmevet” që përdorin lidhëzat në qoftë se dhe në qe se për të cilat nxjerr përfundimin “për të parën kur ndjekë një fjali me qetashen: a t`ardhëshmen”.* Duke iu rikthyer përdorimit të mënyrës dëshirore në fjalitë kushtore, në vërejtjen e tretë, ky gjuhëtar e konsideron të mangët fjalinë kushtore, sidomos atë mohuese, që ndërtohet vetëm me mënyrën dëshirore pa qenë e prirë nga lidhëza përkatëse **në**. “Jo: Mos më gjetsh në shtëpi, linja librin motrës; Mos daltë, tepron. Por: **Në** mos më gjetsh...; **Në** mos daltë...” Te ky gjuhëtar ndeshemi së pari me termat protazë dhe apodozë dhe me termin hipotetike që jepet si unitet i këtyre dy fjalive.

Kostaq Cipo: Sintaksë Tiranë, 1951 (Botim i Ministrisë së Arsimit)

⁵⁹ Po ai, po aty

⁶⁰ A. J. Rrota, Gjuha e shkrueme ase vërejtje gramatikore, ASHRSH, IGJL, Botime Françeskane, Shkodër, 2006, f. 93

Sintaksa Instituti i Shkencave Tiranë 1952

K. Cipo në tekstin e tij “*Sintaksa*” përdor dy emërtime për fjalinë kushtore: Fjalja kushtore-Perioda hipotetike. Në gramatikën e tij ai trajton këto çështje të periudhës me fjali të nënrenditur kushtore:

1. Përkufizimin e fjalisë kushtore: “*Fjalja kushtore* është fjalja që tregon kusht në rrjedhim të së cilës munt të ndodhë e munt të mos ndodhë ç’është thënë në fjalinë kryesore ose në çdo fjali tjetër nga e cila varet kushtorja dhe lidhet me anë të këtyre lidhëzave kushtore...”⁶¹
2. Llojin e lidhëzave dhe të lokucioneve lidhëzore, me të cilat bashkohen fjalitë në periudhën hipotetike, si edhe krahas me to edhe bashkëlidhjen kohore e mënyrore të foljeve kallëzues: “... **në qoftë se**+i tanishmi ose i pritmi, **në rast se**+i tanishmi ose i pritmi, **po qe se**+i tanishmi, **po**+aorist, **po të**+mën. lidh., **në**+i tan. i dëft., **në**+dëshirore, **të**+imperf. lidh., **të**+lidh-habit, **sikur të**+plusq. lidh., **sikur**+imperf. lidh-habit., **sikur**+imperf. ose plusquamperfekt të koniuktivit dhe **me kusht që**.”⁶² [fjalinë kushtore që prihet nga ky lokucion lidhëzor, që e quan lidhëz, e klasifikon si hipotezë të mundësisë]
3. Sqaron se ç’kuptohet me periudhë/periodë hipotetike: “*Protasa me gjithë apodosën formon periudhën hipotetike.*”⁶³ dhe jep mendimin e tij për klasifikimin e fjalisë kushtore në: periodë hipotetike të realitetit, të mundësisë dhe të pamundësisë. Siç duket nga ky alternim i termave fjali me periudhë, Cipo nuk ka vendosur një kufi të qartë midis fjalisë dhe periudhës, kur dihet që e para është një nga pjesët e kësaj të fundit, çka ai e ka shprehur edhe nëpërmjet përkufizimit që ka dhënë për të dyja këto njësi sintaksore “... *Me ato dy fjali është ndërtuar e ngritur në këmbë një organizmë e gjallë ku mina e detit dhe ajo e të gjëmuarit përmbushin nga një funksion të ndryshëm. Kjo organizmë kështu quhet fjali.*”⁶⁴ dhe përkufizimit të periodës: “*Quajmë periodë një radhë fjalish me kuptim të plotë e të vazhduar dhe simetrikisht të ndrequra. ... Periodë munt të quhet edhe një fjali e vetme, kur është njaft e zgjëruar dhe shpreh kuptim të plotë.*”⁶⁵ Duke u nisur nga përkufizimi i fjalisë kushtore [pika 1. këtu sipër] si edhe nga një rregullë e shprehur në fund të ndarjes “*Perioda*” në tekst: “*Nuk ka perioda të formuara vetëm me fjali të varura, aqë më pakë me fjali të varura të pashjtjella.*”⁶⁶ kuptojmë që autori, pavarësisht se e njeh dhe e bën të ditur dallimin mes këtyre dy njësive sintaksore, përsëri nuk e ka evituar përdorimin e njërës për tjetrën, vetëm në aspektin e emërtimeve në klasifikim, por jo të funksionit që kryen secila prej tyre në ligjërim. Të njëjtin qëndrim kontradiktor me veten mban Cipo gjatë sqarimit se ç’kuptohet me secilën prej llojeve të periudhave kushtore, të ndara

⁶¹ K. Cipo, Sintaksa, Instituti i Shkencave, Tiranë 1952, f. 95

⁶² Po ai, f. 95

⁶³ Po ai, f. 95

⁶⁴ Po ai, f. 8

⁶⁵ K. Cipo, Sintaksa, Instituti i Shkencave, Tiranë 1952, f. 15

⁶⁶ Po ai, po aty

sipas modalitetit, kur, edhe pse e ka shpjeguar që perioda është unitet i protasës dhe apodosës, përsëri në shembuj flet për fjali kushtore të realitetit, mundësisë dhe pamundësisë.

4. Shprehja e raporteve kushtore vetëm me “*prezantin e koniuktivit*” është një nga mjetet e tjera që citohet nga Cipo vetëm nëpërmjet dy shembujve: “Të kem një thes, të jap një torbë; të kem pare, blej një lopë.”⁶⁷
5. Në radhën e mjeteve të shprehjes së raporteve kushtore, Cipo numëron edhe fjalitë e pashtjella duke dhënë shembuj me ndërtime që në gramatikë njihen si forma të pashtjelluara foljore, konkretisht me përcjellore: “**Duke u martuar** në këso rrethanash të ngushta, të cilat pa dyshi s`iishin për dasmë, Skënderbeu do të futte zjarrin në shtëpi të tij.”⁶⁸, me mohore: “pa bërë dëm s`të thotë njeri plaç.” dhe me ndërtimin me “*me të*”: “*E drejta e të dhënit urdhër mund të fitohet vetëm me të pasur durim.*”⁶⁹ Në të gjitha rastet e cituara prej tij me këto ndërtime bëhet zëvendësimi përkatës me fjali të nënrenditura kushtore, për të treguar që ato ndërtime janë të barazvlefshme me to, duke u shtuar atyre edhe mjetin tjetër atë të shprehjes me fjali të nënrenditura që bashkohen me lidhëzën kohore e shkakore **kur** që “*vishet me vlerë kushtore.*” “*Vetëm kur* të gjej nja pesqind pajtimtarë, munt ta ve në shtyp librin tim (=në qoftë se gjej...)”⁷⁰

M. Domi: Gramatika e gjuhës shqipe, pjesa II, Sintaksa, tekst për shkollën 7-vjeçare, Tiranë, 1955 dhe “Gramatika e gjuhës shqipe” Sintaksa për shkollat e mesme Prishtinë, 1969 dhe 1971

Mahir Domi në tekstet e tij të gramatikës e trajton fjalinë kushtore si një nga më të pasurat e gjuhës sonë për format me të cilat çfaqen dhe kuptimet që shprehin. Ai trajton në tekst:

1. Ndarjen e fjalive të nënrenditura kushtore në të shtjelluara dhe të pashtjelluara;
2. Konceptin e periudhës hipotetike të përbërë nga protaza dhe apodoza;
3. Klasifikimin e periudhës hipotetike në të realitetit, të mundësisë dhe të pamundësisë;
4. Lidhëzat dhe lokucionet lidhëzore, me të cilat fjalia e nënrenditur bashkohet me kryesoren [në punimin tonë janë pasqyruar në rubrikën e evolucionit të mjeteve lidhëse];
5. Bashkëlidhjen kohore e mënyrore të foljeve kallëzues të fjalive në periudhën hipotetike;

⁶⁷ Po ai, f. 96

⁶⁸ Po ai, po aty

⁶⁹ Po ai, po aty

⁷⁰ Po ai, po aty

6. Raste të tjera të shprehjes së raporteve kushtore;
7. Kriterin e ndjekur për klasifikimin e periudhave me fjali të nënrenditur, nga të cilët ai ndjek kriterin funksional;
8. Rastin e bashkimit jolidhëzor të fjalive në periudhën me fjali të nënrenditur kushtore, në rastet kur fjalia e nënrenditur fillon me folje kallëzues në mënyrën lidhore ose (me lidhëzën **zero**).

S. Mansaku, Rreth formave të shprehjes së raporteve kushtore në shqipen e sotme letrare, SF 1969/3

Një studim sintaksor që e trajton në mënyrë mjaft të zgjeruar shprehjen e raporteve kushtore është ai i S. Mansakut: «Rreth formave të shprehjes së raporteve kushtore në shqipen e sotme letrare» Në këtë studim sintaksor autori numëron si forma të shprehjes së raporteve kushtore:

- «Periudhën me fjali të varur kushtore të cilën e ndan në: me fjali të varur lidhëzore kushtore, jolidhëzore (me folje kallëzues në mënyrën lidhore) dhe me forma të pashtjelluara (përcjellore dhe mohore)
- Periudhën me fjali asindete
- Periudhën me fjali të bashkërenditura (veçuese, shtuese dhe kundërshtore)
- Periudhën me fjali të tjera të varura që shprehin edhe marrëdhënie kushtore [këtu numëron disa periudha të ndërtruara me lidhëza kohore, me fjali të varur shkakore, me fjali kryefjalore të bashkuara me përemra lidhorë të pacaktuar dhe me fjali krahasore të rritjes përpjestimore] që shprehin edhe marrëdhënie kushtore
- Plotësorët e kushtit»⁷¹

Një vend të konsiderueshëm në studimi zë trajtimi i periudhës me fjali të varur kushtore si mënyra më e zakonshme e shprehjes së raporteve kusht-pasojë, duke u kufizuar në trajtimin e periudhës me fjali të varur si një nga format e shprehjes së raporteve kushtore: □... *nuk do të trajtojmë periudhën me fjali të varur kushtore në tërësinë e saj, por duke e parë atë si një nga format kryesore të shprehjes së raporteve kushtore, do të cekim ndonjë problem të saj.*□⁷².

Çështjet që kanë të bëjnë me periudhën me fjali të varur kushtore janë përqendruar kryesisht në vlerësimin e klasifikimeve të ndryshme të këtij tipi të periudhave, si duke u bazuar në aspektin strukturor të cilin e konsideron si atë që □*ofron më tepër mundësi për të zbuluar të gjitha ndërtimet që zotëron gjuha shqipe për shprehjen e raporteve kushtore*□⁷³, ashtu edhe në klasifikimin e tyre sipas modalitetit duke

⁷¹ S. Mansaku, Rreth formave të shprehjes së raporteve kushtore në shqipen e sotme letrare, SF 1969/3, f. 153

⁷² Po ai, f. 154

⁷³ Po ai, f. 155

sugjeruar për disa arsye bindëse ndarjen e tyre në potenciale dhe ireale dhe trajton disa çështje problematike që kanë të bëjnë me klasifikimin e periudhës me fjali të varur kushtore sipas kuptimit modal dhe, pasi bën disa vërejtje, propozon klasifikimin e periudhave kushtore në dy grupe: potenciale dhe ireale.

Një çështje tjetër që ka tërhequr vëmendjen e këtij gjuhëtari është edhe dallimi i fjalive kushtore nga disa fjali që duket të jenë kushtore vetëm nga lidhëza (sidomos **në qoftë se**) që bashkon dy pjesët e fjalive në periudhë, pra nga ana strukturore, por, nga ana kuptimore dhe nga mungesa e raporteve kushtore, bëjnë pjesë në tipa të ndryshëm fjalish të bashkërenditura apo të nënrenditura dhe ai i grupon në një tip të veçantë periudhash të cilin e emërton periudha me fjali opozicionale.

Meqenëse në pjesën ku trajton fjalitë kushtore lidhëzore, vendin më të madh e zënë ato lloj ndërtime ku raportet kusht-pasojë janë të dobësuar, pavarësisht nga prania e lidhëzës kushtore, gjejmë të argumentuar mundësinë e zëvendësimit të fjalive të tilla me të nënrenditura kryefjalore dhe kundrinore, të funksionimit të tyre si fjali të ndërmjetme dhe si fjali që qartësojnë lidhjet kuptimore mes fjalisë kryesore dhe një fjalie tjetër të varur, ndërtime që i përkasin më tepër stilit publicistiko-shkencor.⁷⁴

Së fundi në periudhat me fjali të varura lidhëzore kushtore autori përfshin edhe ndërtimet tautologjike, në të cilat përdorimi i të njëjtit kallëzues në të dyja pjesët e periudhës e pasqyron pasojën e fjalisë kryesore si rezultat të natyrshëm të kushtit të parashtruar në fjalinë e nënrenditur.

Në ndërtimet jolidhëzore S. Mansaku argumenton mjaftueshmërinë e mënyrës lidhore, nëpërmjet modalitetit që zotëron, për të shprehur kuptimin kushtor, me gjithë mungesën e lidhëzës kushtore. Ndërtimet me forma të pashtjelluara sillen në këtë studim me përcjelloren dhe pjesoren të cilat shfaqen me gërshetime nuancash të tjera kuptimore. Vëmë re rëndësinë e trajtave foljore në dallimin e raporteve kushtore nga nuancat e tjera me të cilat mund të gërshetohen ato.

Autori flet edhe për forma të tjera të shprehjes së raporteve kushtore siç janë periudhat asindetike, disa tipa fjalish të bashkërenditura, periudhat me disa lloj lidhëzash kohore, shkakore, kryefjalore, krahasore. Ai bën dallimin e periudhave me fjali të nënrenditur kushtore nga ato me fjali lejore dhe e mbyll studimin me shembuj të shprehjes së raporteve kushtore në fjali: me emra të prirë nga parafjalët me dhe pa, me disa ndajfolje mënyre ose kohe dhe me disa togje fjalësh pa lidhje gramatikore me fjalinë ku bëjnë pjesë, të cilët i referohen kuptimit të bërë më parë.

Me mjaft interes është edhe studimi i E. Guinard me titull: *La proposition subordonnée conditionnelle*⁷⁵ (Fjalja e varur kushtore). Guinard e trajton fjalinë

⁷⁴ S. Mansaku, Rreth formave të shprehjes së raporteve kushtore në shqipen e sotme letrare, SF 1969/3, f. 157-158

⁷⁵ Emile, Guinard, Les propositions subordonnées dans l'albanais moderne, Thèse de Doctorat de 3-ème cycle, Directeur de recherche Monsieur le Professeur Henri Boissin, Faculté des Lettres de l'Université de Paris, Ecole Nationale des Langues Orientales Vivantes, Paris, 1967, f. 57-68

kushtore në kuadrin e gjerë të periudhave me fjali të nënrenditur të shqipes, pjesë e një teze doktorature. Me gjithë ndonjë vërejtje që do të bëjmë këtu më poshtë për mospërkime ndërmjet lidhëzave a lokucioneve lidhëzore në shqip, sipas mënyrës qëi përketen Guinard dhe ndërtimeve të shqipes me ato lidhëza a lokucione, është për t'u vlerësuar fakti që si studiues i huaj, ka shfaqur interes dhe është përpjekur të sjellë ndihmesën e vet në fushën e sintaksës së periudhës.

Në këtë studim gjejmë të trajtuara disa çështje për raportet kushtore si:

1. Përkufizimin e fjalisë së nënrenditur kushtore: “*La proposition subordonnée conditionnelle exprime généralement un fait, un évènement posé comme condition de la réalisation du fait exprimé dans la proposition principale.*”⁷⁶ [Fjalja e varur kushtore shpreh përgjithësisht një fakt, një ngjarje të vendosur si kusht të realizimit të faktit të shprehur në fjalinë kryesore.]

2. Ndarjen e fjalisë së nënrenditur në: hipotetike, potenciale dhe joreale, duke marrë për bazë për të bërë këtë ndarje, aspektin sipas të cilit autori e përfytyron realizimin e këtij fakti: eventualitet [realitet], mundësi, pamundësi.

3. Lidhëzat dhe lokucionet lidhëzore që i grupon në “mots subordonnants” [fjalë nënrenditëse] nga të cilat numëron: të, të mos, në, po, po të, po të mos, sikur, sikur të, sikur të mos, në rast se, në qoftë se, po qe se, me kusht që, kur.

Për mendimin tonë, nuk ka një korrespondim të qartë ndërmjet përkthimit nga frangjishtja në shqip të disave prej lidhëzave apo lokucioneve lidhëzore dhe përshtatjes që ai u ka bërë ndërtimeve kushtore të shqipes në frëngjisht. Lokucionit lidhëzor **në qoftë se**, që cilësohet prej tij si lidhëz me një përdorim shumë të përgjithshëm: “*C`est une conjonction d`un emploi très général.*”⁷⁷ i vë përbri ndërtimet: **dans le cas où**, **en admettant que**, dhe **si**, nga të cilat në gjuhën shqipe vetëm lidhëza kushtore si ka përkthimin, përdorimin dhe kuptimin e **në qoftë se**, kurse në rast se përdoret në ndërtime që e kanë më të shprehur karakterin rastësor të realizimit të kushtit, në krahasim me ato me lokucionin lidhëzor kushtor **në qoftë se**, kurse ndërtimet që prihen nga **duke pranuar që** janë një mjet alternativ i shprehjes së raporteve kushtore në gjuhën shqipe dhe nuk mund të kenë të njëjtën shtrirje në përdorim me periudhat me fjali të nënrenditur që bashkohen me lokucionin lidhëzor **në qoftë se**. Mospërkime të tilla gjejmë edhe për llojet e tjera të lidhëzave apo lokucioneve lidhëzore kushtore që ky autor sjell si shembuj në shqip, duke u përpjekur më tepër t`i përafrojë ato me përdorimin që kanë në kontekstin e ndërtimeve në shqip se sa thjesht t`i referohet përkthimit që kanë ato.

Gjatë shtjellimit të çështjeve që kanë të bëjnë me mjetet e shprehjes së raporteve kushtore ai flet për lidhëzën në dhe përbri saj në frëngjisht është dhënë s`il est vrai que (nëse është e vërtetë që), lokucionit po qe se dhe lidhëzor në qoftë se i është vënë

⁷⁶ Emile, Guinard, Les propositions subordonnées dans l`albanais moderne, Ecole Nationale des Langues Orientales Vivantes, Paris, 1967, f. 57

⁷⁷ Po ai, f. 58

përbri: dans le cas où (në rast se); po identifikohet në frëngjisht me à la condition que (me kusht(in) që), apo pjesëza të [të cilën ai nuk e cilëson se ç`pjesë ligjërare është] dhe e përkthen si lidhëz nënrenditëse pikërisht si e frëngjishtes, që në pjesën më të madhe të rasteve ka ekuivalenten në qoftë se], që shërbejnë për të bashkuar fjalinë e nënrenditur kushtore me fjalinë drejtuese.

Në këtë studim gjejmë gjithashtu edhe raste të ndërtimit të fjalisë së varur kushtore me lidhëzën **kur**, për të cilën ai thekson përdorimin e mirëfilltë si kohore apo shkakore dhe nënvizon: “*ky nocion kohor i lidhëzës nuancohet nga një nocion eventualiteti ose kushti dhe kur ka kuptimin*

nëse është e vërtetë që, (s`il est vrai que)

nëse mundëm të konstatojmë se, (si l`on a pu constater que)”⁷⁸

Po te ky autor gjejmë edhe trajtimin e përemrave lidhorë kush dhe që si edhe lidhëzën posa si mjete të lidhjes së fjalisë së varur kushtore me fjalinë kryesore.

E gjejmë me vend të vëmë në dukje që, në mbyllje të trajtimit që i bën fjalisë kushtore, E. Guinard thekson «Fjalía e varur kushtore e gjuhës shqipe mund të shprehet edhe nga një paskajore (që në fakt përkthehet prej tij si një mohore- **pa bërë** dëm...), nga pjesorja e tashme e pacaktuar (e tipit **me të patur** durim, **me mos pasurë** mëshirë) dhe vetëm me lidhore të tashme e cila, sipas tij, formon një fjali kushtore joreale (të kem).⁷⁹

S. Prifti: Sintaksa e gjuhës shqipe, Prishtinë, mars 1971

Pa dyshim nga gramatikën e S. Priftit⁸⁰ trajtimi i periudhës me fjali të nënrenditur kushtore zë një vend mjaft të rëndësishëm, në të gjithë përbërësit e saj. Ai ka folur për:

1. Përkufizimin e fjalisë kushtore si “*Fjali që përmbahet në fjalinë nga e cila varet, pra fjali kushtore quhet fjalía e varur që tregon kushtin e një pasojë.*”⁸¹
2. Përcaktimin e farëve të fjalive të varura në bazë të pozitës që zënë në periudhë duke u mbështetur kështu në kriterin funksional të paralelizmit të fjalive të nënrenditura me gjymtyrët e fjalisë së thjeshtë: “*Sikurse gjymtyrët, që ndërtojnë fjalinë nuk kanë të njëjtën pozitë në të, ashtu edhe vetë fjalitë, të thurura e të inkuadruara në njësi më të zgjeruara komunikative, siç janë periudhat nuk zënë në to të njëjtin vend. Kjo pozitë [ky pozicion] përcaktohet nga funksioni më i përgjithshëm i fjalisë në periudhë si gjymtyrë e saj. Në këtë bazë fjalitë mund t`i ndajmë në tre grupe të mëdhenj: a) në fjali kryefjalore*

⁷⁸ Po ai, f. 66

⁷⁹ Po ai, f. 67-68

⁸⁰ S. Prifti, Sintaksa e gjuhës shqipe, mars 1971, Prishtinë, f. 386-387

⁸¹ Po ai, f. 386.

(subjektore), b) në fjali kallëzuesore (predikative), c) në fjali plotësore apo përcaktore.”⁸²

3. Mjetet e shprehjes së raporteve sintaksore, të cilat i emërton “*Mjete të shprehjes së lidhjeve sintaktike*: “

Në përkufizimin për fjalinë kushtore kjo e fundit paraqitet nga S. Prifti si fjali që shërben për të shprehur kushtin e veprimit apo të gjendjes që përmbahet në fjalinë nga e cila ajo varet pra fjalia kushtore quhet fjalia e varur që tregon kushtin e një pasoje.⁸³ Raporti ndërmjet kushtit dhe pasojës mendohet në përgjithësi si raport shkaku ndaj pasojës dhe në bazë të këtij raporti, fjalitë që përmbajnë përkatësisht kushtin dhe pasojën emërtohen fjali kushtore njëra dhe e rrjedhimisht tjetra. Autori flet për termat me të cilët i gjejmë të emërtuara fjalitë si të varurën, edhe drejtuesen, protazën që përfaqëson fjalinë kushtore e quan ndryshe edhe hipotezë dhe të dyja fjalitë së bashku formojnë të ashtuquajturën periudhë kushtore ose hipotetike. S. Prifti flet, ndonëse kalimthi, edhe për rrethanorin e kushtit të cilin e emërton plotësor kushtor dhe jep shembuj të përdorimit të tij në bashkërenditje me një fjali kushtore në periudhë. Megjithëse ai shpreh rezerva për adaptimin e termit periudhë kushtore apo hipotetike, për arsye se ai (termi) nuk i përfshin dot të gjitha rastet e gjendjes gramatikore të apodozës dhe të protazës, ai pranon ta përdorë atë për hir të traditës.

Rastet e diskutueshme për të cilat autori nuk duket të jetë i bindur, janë ato kur apodoza, (e cila është gjithmonë kryesore), varet nga fjali të tjera brenda një periudhe të përbërë edhe nga pjesë të tjera, veç atyre që ndërtojnë hipotetiken.

Kur flet për mënyrën e ndërtimit të fjalisë kushtore, vëmë re përdorimin e disa termave që paraqiten si lloje të fjalisë kushtore duke u nisur nga plotësia gjymtyrale. Sipas këtij kriteri ai dallon fjali të thjeshta, të përbëra, të ngjizura dhe eliptike dhe ato thjesht sa numërohen dhe vetëm për llojin eliptik jep shembuj.

Në gramatikën e S. Priftit gjejmë edhe lloje të tjera fjalish kushtore të klasifikuara sipas kriteresh të tjera p. sh.: sipas formës së lidhjes ai dallon fjali sindete dhe asindete; sipas trajtës foljore që ndërton fjalinë kushtore ai dallon fjali të shtjellura dhe të pashtjellura dhe së fundi sipas mënyrës me të cilën merret apo mendohet kushti ai dallon periudhën kushtore të realitetit, të mundësisë dhe të pamundësisë. Secilit lloj i është kushtuar vëmendje e veçantë duke e argumentuar dhe duke e konkretizuar me shembuj.

Trajtimin e çështjeve që kanë të bëjnë me periudhën me fjali të nënrenditur kushtore ai e mbyll me gërshetimet funksionale të kësaj fjalie me fjali të nënrenditura krahasore, të mënyrës, kohës dhe vendit dhe shenjat e pikësimit, të cilat i gjejmë në f. 400 të tekstit dhe përbëjnë dy pikat e fundit të këtij studimi.

⁸² S. Prifti, Sintaksa e gjuhës shqipe, pjesa e I-rë Fakulteti i Historisë e Filologjisë, Katedra e gjuhës shqipe, Botuar nga dega e botimeve të universitetit, Tiranë 1959, f. 50

⁸³ S. Prifti, Sintaksa e gjuhës shqipe, mars 1971, Prishtinë, f.386-387

M. Totoni është autor i teksteve të shkollave tetëvjeçare, i disa artikujve në lidhje me këtë çështje, por në veçanti e ka rimarrë për trajtim më të kujdesshëm në librin “*Fraza me nënrenditje*”⁸⁴. ku para dhe gjatë trajtimit ndeshemi me termin frazë përdorimin e të cilit ai e vë në dukje që në hyrje të librit në “*Vështrimin kritik*” që i bën klasifikimit të frazave me fjali të nënrenditur.

Ai sqaron konceptin frazë duke bërë njëherësh dallimin e tij nga koncepti fjali. “*Me frazë do të kuptohet njësi sintaksore ligjërimore që karakterizohet nga intonacioni i mbaruar dhe nga kumtimi i plotë brenda një konteksti të caktuar...Me fjali do të kuptohet ajo njësi sintaksore që ka në bazë një folje të shtjelluar. Fjalja është thjesht strukturë që mund të formulizohet.*”⁸⁵

Te ky autor ndeshemi për herë të parë me klasifikimin e lidhëzave në: lidhëza me kuptim të diferencuar dhe me kuptim të padiferencuar, si edhe me rolin që ato luajnë vetëm apo në bashkëveprim me bashkëlidhjen kohore a mënyrore të foljeve në fjalitë kryesore dhe të nënrenditur, në përcaktimin e llojit të marrëdhënies kushtore si të mundshme a të pamundshme. Përveç termit frazë për të cilin folëm, ky gjuhëtar ruan në përdorim termat fjali e nënrenditur e kryesore, kusht, e kushtor, por ndonjëherë edhe hipotetik (shkak ose kuptim hipotetik f. 98 dhe 104-105). Studimi për fjalinë kushtore (si edhe për të nënrenditurat e tjera që trajtohen në këtë libër mbyllet me rendin e fjalive dhe aktualizimin e frazës.

Për Th. Dhimën “*Marrëdhëniet kushtore realizohen nëpërmjet lidhëzave nënrenditëse kushtore, bashkëlidhjes së formave mënyrore e kohore të foljeve kallëzues të pjesëve dhe nëpërmjet kontekstit.*”⁸⁶

Duke i përgjithësuar edhe lokucionet lidhëzore në kategorinë e lidhëzave, ai numëron këto lidhëza nënrenditëse kushtore: “*Pjesa e nënrenditur lidhet me kryesoren me lidhëzat: në qoftë se, nëse, në është se, po qe se, po të jetë se, në rast se, në, po, sikur, lidhëza zero (ose forma zero e lidhëzës sikur), me kusht që, mjaft që. ... Si lidhëz kushtore mund të përdoret edhe lidhëza kohore kur, e cila e humbet kuptimin kohor dhe fiton kuptim kushtor, nëse pjesa kryesore është pyetëse.*”⁸⁷

Për Th. Dhimën mes fjalive në periudhën me nënrenditje kushtore vendosen 2 lloje marrëdhëniesh reale dhe joreale dhe të parat ndahen në të mundësisë dhe të pamundësisë. Duke e shoqëruar secilin rast me shpjegime dhe shembuj ai jep paralelisht me lidhëzat që përdoren për secilin lloj të marrëdhënies edhe trajtat kohore e mënyrore të foljeve kallëzues të fjalive në periudhë. Duket qartë nga sa më sipër që ai mbështet M. Totonin.

⁸⁴ M. Totoni, vep. cit. f. 98-107

⁸⁵ Po aty f. 9

⁸⁶ Th. Dhima, Gjuha shqipe, Sintaksa, SHBLU, Tiranë 2005, f. 196

⁸⁷ Po ai, po aty

1.3 Çështje të terminologjisë së raporteve kushtore

Kur mendojmë për kushtin, na vijnë në mend terma të tillë si: kusht, hipotezë, rrethanë, kushtëzim, kushtore, supozim, etj.

Në fjalorët e gjuhës shqipe kushti përkufizohet si rrethanë a gjendje nga e cila varet qenia e diçkaje ose zhvillimi i saj.”⁸⁸

Hipoteza jepet si “Mendim i pranuar përkohësisht, hamendje a pandehje dhe si përfundim shkencor mbi bazën e disa të dhënave që ende nuk është vërtetuar plotësisht me anë të provave.”⁸⁹

Në frëngjisht kushti⁹⁰ jepet si rrethanë e jashtme nga e cila varen njerëzit a sendet, kurse hipoteza⁹¹ është propozim i pranuar përkohësisht për të shërbyer si bazë arsyetimi, demonstrimi, shpjegimi dhe që do të justifikohet me pasojat nga përvoja.

Në anglisht kushti⁹² del si rrethanë e përkohshme nga e cila varet kryerja e një veprimi a marrëveshjeje, kurse Hipoteza⁹³ në këtë fjalor jepet si diçka e paprovuar por e pranuar si e vërtetë për qëllime argumentimi, studimi ose hetimi.

Siç del nga përkufizimet e fjalorëve, kushti qenka rrethanë, kurse hipoteza – mendim a propozim i pranuar përkohësisht, supozim, përfundim i pavërtetuar në praktikë. Mirëpo vetë rrethana⁹⁴ s`është gjë tjetër veçse: një tërësi kushtesh të veçanta në të cilat

- a) ndodh diçka
- b) të cilat ndikojnë në zhvillimin e një ngjarjeje a
- c) përcaktojnë gjendjen e diçkaje a të dikujt.

Ajo që duket si lojë fjalësh ku “aktorët” janë rrethana dhe kushti, tregojnë lidhjen e ngushtë midis këtyre termave, ndërkohë që te hipoteza kjo lojë bazohet mbi supozimin

“Të supozosh do të thotë të marrësh si të vërtetë diçka që merret si pikënisje për të pranuar një hipotezë, ose të marrësh me mend diçka të mundshme a të vërtetë, pa mundur të japësh një gjykim të prerë për të.”⁹⁵

Nga lat. *supponere* sub+ponere “to put under” të vësh poshtë/nën.

Në frëngjisht *supposition* ka për sinonim *hypothèse*.

⁸⁸ Fjalori i shqipes së sotme, 1984, f. 579

⁸⁹ Po aty, f. 428

⁹⁰ Dictionnaire du Français Contemporain, Larousse, 1971, f. 275

⁹¹ Po aty, f. 609

⁹² Merriam Webster`s school Dictionary, publishers SPRINGFIELD, MASSACHUSETTS, U.S.A., f.183

⁹³ Po aty, f. 433

⁹⁴ FSHS, 1984, f. 1044

⁹⁵ Po aty, f. 1121

Në Dictionnaire du Français Contemporain, Larousse për fjalinë e nënrenditur kushtore thuhet se “është ajo që shpreh një kusht nga i cili varet fjalia kryesore dhe që lidhet me të me lidhëzat kushtore.”⁹⁶

Në fjalorin e shqipes së sotme për termin kushtore gjejmë dy interpretime:

- “1) që lidh një fjali të varur e cila tregon kushtin e kryerjes së një veprimi me fjalinë drejtuese që shpreh këtë veprim;
- 2) që tregon se veprimi a gjendja që shënohet nga folja lidhet me një kusht.”⁹⁷

Në në pjesë të mirë të gramatikave të konsultuara termat protazë dhe apodozë i gjejmë të përdorur në vend të emërtimeve përkatësisht fjali e nënrenditur dhe fjali kryesore dhe të dyja së bashku formojnë periudhën hipotetike.

Disa autorë si S. Prifti janë të mendimit se fjalia kryesore bashkë me të nënrenditurën përbëjnë të ashtuquajturën periudhë hipotetike, një përkufizim ky që e gjejmë edhe tek autorë të huaj si G. dhe R. Le Bidois⁹⁸, të cilët mendojnë se “ajo që përbën thelbin e një fraze hipotetike është përafrimi kundërvënës, bashkëlidhja racionale e dy pjesëve të periudhës të menduara dhe të paraqitura në një mënyrë të tillë që njëra imponohet me forcë si të sugjerojë idenë e një supozimi dhe tjetra atë të një pasoje (ose së paku të një konkluzioni) të *lidhur ngushtësisht me të parën*.”

Çështja e përdorimit të termave frazë apo fjali lidhur ngushtë me termin kushtore është trajtuar nga L. Tesnière i cili sqaron arsyen e përdorimit të termit frazë kushtore dhe jo fjali kushtore, sepse bëhet fjalë për frazë të përbërë nga jo më pak se dy fjali nga të cilat njëra shpreh kushtin dhe tjetra e pëson atë. Këtë arsyetim e konkretizon me shembullin: Po të bënte kohë e mirë, do të dilja për shëtitje. Në këtë frazë fjalia e parë e shprehur me folje në mënyrën dëftore shpreh kushtin, kurse e dyta që, në mënyrë paradoksale e ka foljen në mënyrën kushtore, nuk shpreh kusht. Përdorimin e termave protazë dhe apodozë ky autor e trajton në kapitullin 274 të këtij libri kur flet për frazën retorike e cila për të është në përgjithësi ajo e gjuhëve primitive.⁹⁹

Duke e konsideruar shumë të vlefshme rimarrjen e kësaj terminologjie të shkëlqyer, e cila, si rezultat i humbjes së pamërituar të vlerave nga i cili vuajnë shumë disiplina

⁹⁶ Dictionnaire du Français Contemporain, Larousse 1971, f. 275

⁹⁷ Fjalor i shqipes së sotme 1984, f. 589

⁹⁸ G. dhe R. le Bidois, Syntaxe dy français moderne. Ses fondement historiques et psychologiques, Paris, Picard, Tome II, 1971, f. 522

⁹⁹ Lucien Tesnière, Éléments de syntaxe structurale, Paris, Librairie C. Klincksieck, 1959, f. 592-593. “Faza e trajtuar kështu na çon te periudha që është e para formë artistike që grekët dhe latinët i kanë dhënë asaj. Ky lloj ndërtimi është thelbësisht i përbërë nga kundërvënja e dy pjesëve që i përgjigjen pak a shumë simetrikisht njëra-tjetrës dhe që mjeshtrat e retorikës klasike i njohin me emra origjinarë nga greqishtja: protazë (do të thotë etimologjikisht “paravënie”), që përgjithësisht është fjalia e nënrenditur dhe apodozë (do të thotë etimologjikisht “kthim”), që është fjalia kryesore që e drejton të nënrenditurën, të cilat ndjekin njëra-tjetrën në vargun e folur.” , Po ai, f. 633

klasike, është vjetëruar, autori e mbyll trajtimin e kësaj çështjeje me dy shembuj nga periudhat klasike një nga greqishtja dhe një nga latinishtja.

Periudhën kushtore me këtë terminologji e ka trajtuar më gjatë S. Prifti¹⁰⁰, i cili merret hollësisht me pozicionin e secilës prej fjalive që përbëjnë periudhën kushtore në raport me njëra-tjetrën dhe gjithashtu edhe në raport me fjalitë e tjera të bashkërenditura a të nënrenditura-pjesë përbërëse të periudhës me më shumë se dy pjesë.

Xhuvani: fjali të lidhuna bashkë, fjali e varme, periudhë, kusht, kushtore, etj.

Sheperi: fjali të bashkëlidhura, fjali e varme, periudhë, kusht, etj.

A. J. Rrota: qyshk, qyshkore, kondicionale, periudhë hipotetike, fjali qyshkore kushtore (protazë), kryefjalja (apodhozë).

Cipo: kusht, kushtore, fjali kushtore, protaza, apodoza, perioda hipotetike, etj.

M. Domi: kusht, protasë = fjalinë kushtore, apodosë fjalinë që plotësohet prej saj. Të dyja së bashku formojnë periudhën hipotetike.

S. Mansaku: fjali kryesore, fjali e varur, kusht, pasojë, kushtore, periudhë me fjali të varur kushtore,

M. Lambertz: konjuksion, fjali kondicionale, fjali koncesive, protaza; fjali e varme dhe fjali kryesore; supozim; apodoza; prepozitive; postpozitive; por edhe të prapavendosur; potencial; ireal; prepozicione, etj.

S. Prifti: kusht, rrjedhim, fjali e varur/e rrjedhimit=apodozë, protazë=fjali kushtore/hipotezë, periudhë kushtore apo hipotetike [të pranuar me rezerva, për hir të traditës]

Në gramatikën e Akademisë së Shkencave përdoren termat që përdoren edhe në gjuhën e sotme shqipe: periudhë me fjali të varur, fjali drejtuese dhe fjali kushtore, plotësor kushti, fakte të supozuara, supozim, përmbajtje e realizueshme dhe e përealizueshme, kusht, kushtore, por përdoret gjithashtu edhe termi hipotetik kur flitet

¹⁰⁰ po ai, po aty, f. 386 e në vazhdim

për karakterin e supozues të një tipi fjalie kushtore që bashkohet me fjalinë drejtuese me lidhëzën sikur.

Edhe pse vetëm sa ceket, termi hipotetik përdoret edhe në vitin 2000 nga prof. M. Totoni¹⁰¹ për të emërtuar me fjalë të tjera kushtin dhe karakterin e lidhjes në atë që ai e quan frazë kushtore. Termat e tjerë kusht, pasojë, kushtore, kryesore, e nënrenditur janë po ata që janë ndeshur edhe në sintaksat e tjera.

Ajo që vihet re qartë në lidhje me terminologjinë sintaksore në përgjithësi dhe me atë kushtore në veçanti, është përdorimi i të dyja formave në latinisht dhe në shqip si për emërtimin e kohëve e mënyrave të foljeve kallëzues në fjali ashtu edhe të emërtimeve të pjesëve të tjera të ligjëratës.

Terminologjia kushtore ka evoluar drejt njësimi duke filluar gradualisht nga M. Domi, e deri te përdorimi i një terminologjie të përbashkët në sintaksën e Akademisë e më pas në atë të studiuesve të këtyre raporteve në vijim.

Në këtë punim është përdorur terminologjia: kusht, kushtore, fjali drejtuese (kryesore ose jo), fjali e nënrenditur kushtore, periudhë me fjali të nënrenditur, hipotetik (për sistemin), etj.

¹⁰¹ M. Totoni, vep. cit. f. 98

KREU II

ÇËSHTJE TË KLASIFIKIMIT TË PERIUDHAVE ME FJALI TË NËNRENDITUR KUSHTORE DHE VENDI I SAJ NË KËTO KLASIFIKIME

2.1 Klasifikimet e ndjekura nga autorë të ndryshëm

2.1.1 Trajtimi dhe zbatimi i kriterëve për klasifikimin e periudhës me fjali të nënrenditur

Dihet tashmë që, klasifikimi i periudhave me fjali të nënrenditur, është konsideruar nga ata që janë marrë me trajtimin e tyre, si çështje e vështirë për t'u zgjidhur. Një pjesë e mirë e gjuhëtarëve që i kanë hedhur idetë e tyre nëpër gramatika, e kanë përmendur qoftë edhe në mënyrë të pjesshme klasifikimin e periudhave në fjali, pavarësisht nga kriteret e ndryshme që janë ndjekur për t'i klasifikuar ato. Në funksion të kriterëve semantike disa gramatika përcaktojnë këto klasa fjalish të nënrenditura rrethore: kohore, shkakore, qëllimore, hipotetike, rrjedhimore, lejore dhe krahasore. Klasifikimin e periudhave me fjali të nënrenditur apo të fjalive të nënrenditura, siç ka ndodhur me disa autorë, e kanë trajtuar si një nga çështjet problematike në gramatikat e tyre një pjesë e mirë e gjuhëtarëve të përmendur që në parathënie të këtij punimi dhe disa të tjerë e kanë trajtuar veçanërisht si çështje më vete siç ka bërë: S. Floqi¹⁰², S. Prifti¹⁰³, M. Totoni¹⁰⁴, M. Domi¹⁰⁵ dhe pjesërisht si pjesë të ndonjë referati nga Th. Dhima¹⁰⁶, L. Rugova¹⁰⁷.

S. Floqi në veprën e cituar në f. 224-225 flet për klasifikimet e ndryshme që janë bërë deri atëherë kur ai e shkroi këtë artikull dhe paralelisht me kriterin e ndjekur që ai përmend, jep edhe emrat e autorëve të huaj që kanë zgjedhur kriterin përkatës dhe, para se të parashtrijë mendimin e vet për kriterin që mendon të ndjekë gjatë punimit,

¹⁰² S. Floqi, po aty, f. 225 dhe Disa tipe semantiko-strukturore të periudhës me fjali të varur pa lidhje korrelative, SF 1967/3, f. 21-30

¹⁰³ S. Prifti, Klasifikimi i fjalive të varura, SF 1972/2, f. 137-152

¹⁰⁴ M. Totoni, Klasifikimi strukturor-semantik i frazave me fjali të nënrenditur, SF 1990/2, f. 21-27, dhe Frazat me nënrenditje, SHBLU, Tiranë 2000, f. 9-15

¹⁰⁵ M. Domi, Gramatika e gjuhës shqipe II, Sintaksa, Tiranë 1997, f. 492

¹⁰⁶ Th. Dhima, Disa koncepte sintaksore në gramatikat e shqipes të gjysmës së parë të shek. XX, Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare, 23/1 Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Filologjisë, Prishtinë 2004, f.289-290

¹⁰⁷ L. Rugova, Klasifikimi i periudhës me nënrenditje në gramatikat shqipe të gjysmës së parë të shekullit XX, po aty, f. 437-440

hedh një vështrim edhe mbi mënyrën se si është trajtuar kjo çështje në gramatikat e gjuhës shqipe. (f. 226)

Kriteri strukturor (gramatikor-formal) mbështetet në mjetet gramatikore të lidhjes së fjalive të varura me fjalitë e plotësuar prej tyre. Këto mjete janë: lidhëzat e ndryshme nënrenditëse, disa fjalë të tjera lidhëse (përemra e ndajfolje lidhore) dhe intonacioni. Ky aspekt lejon një ndarje në fjali sindete dhe asindete. Sindete vjen nga greq. “*syndetos*” = i lidhur bashkë. “*syndesmos*” greq.-lidhëz. Asindete vjen po nga greq. “*asyndetos*” = i palidhur bashkë (me lidhëza e fjalë lidhore). Në grupin e fjalive sindete hyjnë fjalitë e lidhura me lidhëza e fjalë lidhëse, kurse në grupin e dytë hyjnë fjalitë e bashkuara vetëm me anë të intonacionit. Ata që ndjekin këtë lloj klasifikimi e vazhdojnë ndarjen në nëngrupe e në farë fjalish më të veçanta, sipas kategorisë gramatikore të secilës fjalë lidhëse në fjali lidhëzore dhe në fjali lidhore ose relative.

Kriteri funksional (gramatikor-logjik), mbështetet në paralelizmin e fjalive të varura me gjymtyrët e fjalisë (S. Floqi, kur flet për këtë klasifikim (të bërë nga gjuhëtarë rusë, anglezë dhe frëngë), shprehet se paralelizmi është bërë midis pjesëve të ligjëratës dhe fjalive të nënrenditura). Një klasifikim të tillë, duke e paraqitur si praktikë të disa gramatikave tradicionale e gjejmë te sintaksa italiane e G. Graffi-t “*Disa gramatika tradicionale dallojnë...frazat të varura në bazë të analogjisë me tri pjesët e ligjëratës dhe flasin pra për frazat të nënrenditura “emërore”, “mbiemërore” dhe “ndajfoljore”...Në grupin e frazave emërore përfshihen: kryefjaloret, plotësoret dhe pyetëset e zhdrejta. Frazat e quajtura nga gramatika tradicionale “mbiemërore” njihen si “lidhore”, sepse të dy termet shpesh janë konsideruar sinonime; dhe “ndajfoljoret” duket logjike të quhen rrethanore dhe të zëvendësojnë emërtimin tradicional. Frazat kohore, shkakore, etj. sillen si ndajfolje (ose më mirë të themi si disa prej këtyre të fundit), jo sepse janë të tilla në një farë kuptimi, një imitim, por, sepse të dyja këto klasa të shprehjes realizojnë të njëjtën veçori të përgjithshme, atë të të qenit elemente rrethanore”¹⁰⁸*

Sinonimia funksionale që është menduar se fjalitë e nënrenditura kanë me gjymtyrët e fjalisë, i ka bërë gjuhëtarët që kanë mbështetur këtë kriter klasifikimi t'i emërtojnë fjalitë e nënrenditura sipas gjymtyrës respektive, funksionin e së cilës kryen kjo fjali e nënrenditur në raport me fjalinë kryesore brenda periudhës.

Kështu pra duke marrë parasysh gjymtyrët kryesore të fjalisë: kallëzuesi dhe kryefjala dhe të dytat: përcaktori, kundrinori dhe rrethanori (pa përfshirë këtu gjymtyrët e tjera të dyta si: e krahasimit, e shtimit, e përjashtimit, e kundërisë dhe e spikatjes),

¹⁰⁸ Giorgio Graffi, Sintassi, Il Mulino, Bologna 1994, 4.3.1, f. 115-117 «Alcune grammatiche tradizionali distinguono...le frasi dipendenti in base all'analogia con tre parti del discorso, e parlano quindi di frasi subordinate «sostantive», «aggettive» ed «avverbiali» All'interno di questa classe di frasi, distinguiamo poi le soggettive, le complete e le interrogative indirette. Le frasi dipendenti che la grammatica tradizionale chiama a volte «aggettive» sono più note con il nome di relative e spesso le due definizioni sono considerate sinonime; Sembra dunque logico chiamare circostanziali anche le frasi di questo tipo e sostituire denominazione a quella tradizionale di «avverbiali»; le frasi temporali, causali, ecc. Si comportano come gli avverbi (o, per meglio dire, come alcuni di questi ultimi) non perché ne sioano, in un certo senso, un imitazione, ma perché entrambe queste classi di espressioni realizzano la stessa proprietà generale, quella cioè di essere degli elementi circostanziali.»

mbështetësit e këtij kriteri klasifikimi kanë emërtuar fjalitë e nënrenditura analoge me këto gjymtyrë nga ana funksionale me të njëjtat terma dhe janë përfutur përkatësisht: fjali të nënrenditura kryefjalore, kallëzuesore, përcaktore, kundrinore dhe rrethanore. Tipi i fundit i fjalive të nënrenditura, duke qenë më i larmishëm në format e shprehjes dhe duke u mbështetur mbi lidhjet semantike që këto fjali vendosin me fjalitë drejtuese ndahet më tej në rrethanore: vendore, kohore, mënyrore, shkakore, rrjedhimore, qëllimore, kushtore, lejore.

Kriteri semantik (brendia kuptimore e periudhës) është parë shpesh i ndërthurur me atë strukturor duke i dhënë përparësi herë njërit e herë tjetrit kriter. Punën për vënien në zbatim të këtij kriteri klasifikimi e ka filluar S. Floqi me dy artikujt e cituar më sipër në të cilët të dy kriteret ndërthuren pa iu përmbajtur një rendi gjithmonë rreptësisht të përcaktuar. Këtë e vë re edhe M. Totoni në artikullin “Klasifikim strukturor-semantik i frazave me fjali të nënrenditur” ku ai shprehet: “Në këtë klasifikim S. Floqi nisat nga elemente të strukturës për të arritur te kuptimi, por, në të vërtetë, kriteri përcaktues sidomos për dallimin e tipave është kuptimi.”¹⁰⁹ Pikërisht kalimi nga njëri kriter te tjetri nuk është i prerë gjë që i ka dhënë të drejtë S. Priftit¹¹⁰ ta quajë kriterin e ndjekur nga S. Floqi strukturor-semantik, sepse ai nisat nga elemente të strukturës për të arritur te kuptimi. Nxjerrja e kriterit semantik në plan të parë (siç ndodh sidomos në ndarjen në tipa të fjalive të grupit të parë dhe të dytë, ku edhe pse në bazë të klasifikimit vë mjetin lidhës dhe korrelatin, përsëri në të dyja grupet kuptimi i periudhës mban peshën kryesore), përlij emërtimin e këtij kriteri si semantik-strukturor.

E njëjta gjë mund të thuhet edhe për A. Xhuvani-n¹¹¹, i cili i quan fjalitë e nënrenditura si fjali të lidhuna bashkë dhe thotë se ato mund të lidhen me fjalinë e parë me anë të lidhëzave, ndër të cilat përmend edhe lidhëzën kushtore në qoftë se dhe mund të jenë kryefjalë, kundrinë ose mund të dëftojnë kohë, shkak, kusht. (f. 37) Edhe ai, kur analizon llojet e fjalive sipas ndarjes që u është bërë sipas kriterit që ka ndjekur, e përmend si lloj më vete fjalinë lidhore duke ndërthurur kështu parimin funksional me atë strukturor formal. Sipas funksionit ai i ndan fjalitë në: kryefjalore, kundrinore, kohore, mënyrore, vendore, shkakore, lidhore, qëllimore, ndërmjetëse, krahasore, **kushtore**, rrjedhore dhe konçesive (lejore).

I. D. Sheperi është nisur nga parimi i analogjisë funksionale kur shprehet: “Fjalit e varme, si pjesë të fjalive kryesore, shërbejnë në to: në vend të emrit, si kryefjalë, kallëzues, kundrina ose ndajshtime; në vend të mbiemrit si plotës të ndonjë emëri të fjalit kryesore; dhe si plotës të disa llojeve...”¹¹² ndër të cilët rendit të qëllimit, të shkakut, të kohës, **të kushtit** dhe të kundërsisë.

Por fakti që një paragraf më përpara ai ka përmendur si mjete lidhëse, përveç lidhëzave të bashkëlidhjes, siç i quan ai lidhëzat nënrenditëse, edhe përemrat a

¹⁰⁹ Studime Filologjike 1990/2, f. 23

¹¹⁰ S. Prifti, Klasifikimi i fjalive të varura, SF 1972/2, f. 149

¹¹¹ A. Xhuvani, vep. cit., f. 30-31 (pj I), 31-42 (pj II)

¹¹² I. D. Sheperi, vep. cit. f. 172

ndajfoljet lidhore; na bën të dyshojmë nëse i ka përdorur dy kriteret (funksional dhe strukturor) të përzierë për klasifikimin e fjalive, kjo edhe për faktin tjetër që fjalitë e bashkuara me këto mjete lidhëse (përemra a ndajfolje lidhore) ai i trajton më vete si fjali përmendëse (relative) dhe tregon funksionin e tyre në raport me fjalinë kryesore. (f. 177)

A. J. Rrota¹¹³ ndjek kriterin funksional të paralelizmit me gjymtyrët e fjalisë dhe këtë e përmbledh me përkufizimin: “Kemi njaq farë fjalish së dyta, sa janë farët a gjymtyrët e fjalisë së thjeshtë.” Në klasifikimin që u bën fjalive ai dallon: fjali të subjektit, të predikatit, të atributit, të objektit dhe të adverbjarit. Siç duket qartë nga emrat që mbajnë grupet e fjalive të nënrenditura, ai është ndikuar nga gramatika logjiciste. Fjalinë e nënrenditur kushtore e vendos në grupin e fjalive të adverbjarit.

Paralelisht me ndarjen që bën në grupe të mëdha: në fjali vendore (lokale), fjali kohore (temporale), fjali mënyrore (modale) dhe fjali shkakore (kauzale), ai bën edhe ndarjen në nëngrupe të tri grupeve të mëdha: në grupin e fjalive kohore ai përmend tri nëngrupe të cilat i ndan sipas shtrirjes kohore të marrëdhënieve në a) njëkohore, b) parakohore dhe c) mbaskohore; grupi i fjalive mënyrore ndahet në nëngrupet: a) fjali krahasore (komparative), b) fjali rrjedhore (konsekutive) dhe c) fjalitë e vërteta mënyrore (modale). Në grupin e fundit të fjalive ndajfoljore të shkakut ai numëron nëngrupet e: a) fjalive të njëmendta të shkakut, b) të fjalive qëllimore (finale) dhe c) të **fjalive kushtore (kondicionare)**. Një ndarje e tillë duket të jetë bërë sipas faktit se çfarë tregojnë fjalitë: - arsyen, shkakun a mjetin; qëllimin, kushtin me të cilin është lidhur veprimi i kryefjalisë (pikërisht kjo i bën të quhen **fjali kushtore**) dhe kundërshtimin a pengimin.

K. Cipo¹¹⁴ bën pjesë në grupin e I. D. Sheperit, A. Xhuvanit që, përveç parimit funksional të paralelizmit të fjalive të nënrenditura me gjymtyrët e fjalisë, ku numëron fjalitë e varura: subjektore, objektore, shkakore, kohore, vendore, krahasore, qëllimore, të mënyrës, lejore, **kushtore**, rrjedhore, kufizore; ai veçon edhe fjalitë lidhore dhe pyetëse të çdrejta dhe dyshimore të cilat i quan “lari” të fjalisë objektore. Në këtë mënyrë del i ndërthurur aspekti funksional me atë strukturor dhe me atë të modalitetit.

S. Prifti në Sintaksën e 1962¹¹⁵ përpiket të arsyetojë klasifikimin e mbështetur mbi bazën e analogjisë funksionale me gjymtyrët e fjalisë. Ai shpjegon që fjalitë e shqyrtuara në periudhë fitojnë: aspektin gjymtyral që i bën të konsiderohen gjymtyrë të periudhës; aspektin funksional, sipas të cilit kryejnë në periudhë një funksion të caktuar; Është pikërisht përvetësimi i pothuajse të gjitha aspekteve të veçanta që kanë

¹¹³ A. J. Rrota, Sintaksa e gjuhës shqipe (ose Sintaksi i shqipes 1942) për klasën II, III, IV të shkollave të mesme, Shkodër, Shtypshkronja A. Gj. Fishta, 1943, f. 99-103 dhe Gjuha e shkrueme ase vërejtje gramatikore, ASHSH IGJL, Botimi I, Botime Françeskane, Shkodër, 2006, f. 496

¹¹⁴ K. Cipo, Gramatika e gjuhës shqipe për klasat e V-ta, VI-ta, VII-ta të shkollave 7-vjeçare, Tiranë 1949; Sintaksa, Tekst për Institutin pedagogjik, Tiranë 1951, botim i ministrisë së Arsimit dhe Sintaksa, Instituti i Shkencave, Tiranë 1952, f. 52

¹¹⁵ S. Prifti, Sintaksa e gjuhës shqipe, pjesa I, Dispensa I, 1962, Klasifikimi i fjalivet të varura në periudhë

gjymtyrët në fjali dhe shndërrimi i fjalive të nënrenditura në gjymtyrë të periudhës arsyeja që shpjegon, sipas S. Priftit, analogjinë e fjalive në periudhë me gjymtyrët në fjali. Në klasifikimin e tij, gjejmë dy grupe të mëdha: 1) fjali të varura emërore në të cilin përfshin: fjalitë kryefjalore, kallëzuesore, kundrinore, ndajshtimore dhe cilësore dhe 2) fjali të varura **ndajfoljore** ose **rrethanore** në të cilin përfshin: fjalitë vendore, kohore, shkakore, qëllimore, mënyrore, krahasore, **kushtore**, lejore, rrjedhimore dhe kufizuese.

Me gjithë vërejtjet e bëra në lidhje me klasifikimet e ndryshme, në gramatikat e veta apo në kreun përkatës të gramatikës së Akademisë, edhe M. Domi¹¹⁶ zgjedh si më të pranueshmin e më të përshtatshmin klasifikimin e periudhave me fjali të nënrenditur sipas kriterit funksional, pa lënë pas dore edhe anën strukturore e semantike të tyre. Edhe ai i klasifikon periudhat me fjali të varur në bazë të funksionit që ato kryejnë në raport me fjalinë kryesore, në bazë të raporteve sintaksore që ato vendosin me këto të fundit dhe gjithashtu duke u mbështetur dukshëm në paralelizmin me gjymtyrët e fjalisë. Tipat e fjalive që ai numëron janë: kryefjalore, kallëzuesore, kundrinore (të drejta dhe të zhdrejta), përcaktore dhe rrethanore. Rrethanoret i ndan më tej në: vendore, kohore, mënyrore, shkakore, rrjedhimore, qëllimore, **kushtore**, lejore. Edhe këtu fjalia e nënrenditur kushtore zë vend në grupin e fjalive rrethanore.

Vëmë re që ky autor ndan më tej vetëm dy grupet e mëdha të tipave të fjalive: kundrinoret dhe rrethanoret, por ne mendojmë se kanë po të njëjtën rëndësi edhe grupet e tjera dhe edhe ato janë më tej të ndashme; përcaktoret në përcaktore me përshtatje të plotë a të pjesshme ku hyn edhe ndajshtimi, me drejtim dhe me bashkim dhe përcaktore kallëzuesore (për të mos përmendur këtu edhe ndarjen e mëtejshme që mund t'u bëhej fjalive kallëzuesore në të thjeshta emërore dhe të përbëra sipas tipave të kallëzuesve)

S. Floqi në studimin sintaksor për disa tipa të veçantë periudhash¹¹⁷ tregon se ndjek kriterin semantik-strukturor për klasifikimin e periudhave dhe tregon tiparet karakteristike të tyre:

- mjet i lidhjes së fjalisë së varur me kryesoren janë më të shumtën e herës lidhëzat e më rrallë përemrat a ndajfoljet lidhore
- këtyre lidhëzave a përemrave nuk mund t'u përgjigjet kurrsesi një fjalë korrelative në fjalinë kryesore
- fjalia e varur ka të bëjë sipas tipit ose me një fjalë të vetme a togfjalësh frazeologjik të fjalisë kryesore (fjala mbështetëse), ose me tërë fjalinë kryesore nëpërmjet kallëzuesit dhe grupit të tij në fjalinë kryesore

¹¹⁶ "Klasifikimin e periudhave me nënrenditje ne do ta bëjmë duke vështruar së pari funksionin, pse ky lejon të jepen në mënyrë më të sistematizuar e përgjithësuese raportet sintaksore. Do të vështrohen raportet kuptimore të fjalive të varura me fjalitë kryesore a drejtuese të tyre në atë vijë që vështrohet ai i gjymtyrëve brenda në fjali." M. Domi, Gramatika e gjuhës shqipe II, Sintaksa, Tiranë 1997, Kreu XXV, f. 495-496

¹¹⁷ S. Floqi, Disa tipe semantike strukturore të periudhës me fjali të varur pa lidhje korrelative, SF 1967/3, f. 21- 31.

- shkalla e lidhjes së fjalive në periudhë varet ose nga vetitë semantiko-strukturore të fjalisë së plotësuar dhe atëherë kemi një periudhë ku fjalitë janë bashkuar shumë ngushtë nga pikëpamja kuptimore dhe gramatikore-intonacionore ose varet nga vetitë semantike të fjalisë kryesore, kur fjalia e varur ka të bëjë me gjithë brendinë e fjalisë kryesore dhe atëherë shkalla e lidhjes së fjalive në periudhë është më e çlirët dhe e tillë është edhe lidhja gramatikore-intonacionore. Fjalia e nënrenditur kushtore zë vend në grupin e fjalive lidhëzore.

Nëse do të përpiqeshim t'i gruponim gjuhëtarët sipas kriterëve të ndjekura për klasifikimin e periudhave me fjali të nënrenditur do të shihnim se, pavarësisht nga ndërthurjet me kriteret e tjera (siç ndodh me K. Cipo-n, i cili kriterin funksional e ndërthur me atë strukturor dhe me të modalitetit; I. D. Sheperi-n, i cili, përveç kriterit funksional, mendohet të ketë përdorur edhe atë strukturor, meqë ndër tipat e fjalive përmend edhe fjalinë lidhore; A. Xhuvani-n, që ndërthur kriterin funksional me atë strukturor-formal;), del qartë se kriteri funksional është i pari dhe më i përdoruri nga thuajse të gjithë autorët që kemi përmendur në këtë punim. Bëjnë përjashtim nga ky rregull S. Floqi, i cili, siç e thamë është mbështetur mbi kriterin semantiko-strukturor dhe M. Totoni, i cili e thellon më tej idenë e të parit, por i jep përparësi kriterit strukturor nëpërmjet *“vënies në dukje të rolit të faktorëve që marrin pjesë në organizimin strukturor dhe kuptimor të klasave e të tipave të frazave me nënrenditje, duke numëruar si të tillë: fjalën mbështetëse (natyra leksiko-gramatikore e së cilës përcakton strukturën e fjalisë së nënrenditur), mjeti i lidhjes, karakteri i lidhjes, rendi i fjalive dhe aktualizimi i frazës, rendi i gjymtyrëve të fjalive, bashkëlidhja kohore dhe mënyrore e foljeve kallëzues”*¹¹⁸

¹¹⁸ M. Totoni, *Fraza me nënrenditje*, SHBLU, Tiranë 2000, f. 15

2.1.2 Fjali, periudhë, frazë, fjali e përbërë-njësia sintaksore që është marrë për bazë në klasifikime të ndryshme

Përpara se të shohim vendin që i është caktuar fjalisë së nënrenditur kushtore dhe kriteret e ndryshme të ndjekura nga gjuhëtarë e gramatika të ndryshme për të sjellë këtë apo atë lloj klasifikimi, e gjejmë me vend të sqarojmë se cila njësi sintaksore është klasifikuar; fjalia, periudha apo fraza.

Në gramatika të ndryshme janë përdorur herë njëri e herë tjetri term.

Përkufizimi i periudhës nga A. Xhuvani¹¹⁹, I. D. Sheperi¹²⁰ është bërë mbi baza kuptimore. Ajo jepet si mendim i plotë a kuptim i plotësuem dhe i kundërvihet përkufizimit të fjalisë që shpreh një mendim a gjykim të shfaqur me të folur a me të shkruar.

I. D. Sheperi: fjali periudhë/bashkëlidhje: (kryesore+ të varme/të dyta)

I. D. Sheperi termin periudhë e përdor dy herë brenda dy paragrafëve §514 dhe §515¹²¹ ku shprehet përkatësisht te paragrafi i parë: “*Sipas shërbimit që kryejnë në periudhë fjalit janë kryesore ose të pavarme dhe të varme ose të dyta.*” dhe te i dyti: “*Fjalit e periudhës, sipas lidhjes që kanë me njërajtrën janë: a) të bashkërenditura... dhe b) të bashkëlidhura...*” dhe një herë e gjemë të përdorur në shënimin poshtë paragrafit §553 në f. 169 ku ai bën dallimin e lidhëzave bashkërenditëse ku numëron shtueset, dallueset, kundërshtoren por dhe përmylltoret, të cilat lidhin pjesë homogjene të fjalisë ose periudhës dhe prandaj i quan lidhëza bashkërenditëse, kurse lidhëzat e tjera i quan lidhëza të bashkëlidhjes.

M. Domi/Sintaksa e Akademisë: fjali-periudhë (fjali kryesore+ fjali e nënrenditur)

Në tekstin e Gramatikës së gjuhës shqipe në kapitullin e parë të punuar nga M. Domi dallimi ndërmjet fjalisë dhe periudhës jepet si më poshtë:

*“Fjalia është fragment i ligjërimit i përbërë zakonisht prej dy a më shumë fjalësh kuptimplota të bashkuara sipas raportesh të caktuara, në bazë të ligjeve të një gjuhe, në një tërësi të vetme kuptimore, gramatikore e intonacionore.”*¹²²

Këtë çështje M. Domi e ka trajtuar më parë në një artikull¹²³ në të cilin ai argumenton se përse “*është e vërtetë që fjalia është një bashkim fjalësh e trajtash të bashkëlidhura për nga kuptimi dhe nga ana gramatikore sipas ligjeve të një gjuhe*”¹²⁴. Këtë e bën

¹¹⁹ A. Xhuvani, Sintaksa shqip, Pjesë e dytë për klasët e ulëta të shkollave të mesme, Tiranë 1938, f. 28

¹²⁰ I. D. Sheperi, Gramatika dhe Sintaksa e gjuhës shqipe, Vlorë 1927, f. 39

¹²¹ I. D. Sheperi, Gramatika dhe Sintaksa e gjuhës shqipe, Vlorë 1927, f. 163

¹²² Gramatika e gjuhës shqipe, v II, Sintaksa, Tiranë 1997, f. 60

¹²³ M. Domi, Çështje të përgjithshme të sintaksës, SF 1980/3, f. 97-119

¹²⁴ Po aty, f. 101

duke transformuar një fjali të rregullt duke prishur lidhjet kuptimore të fjalëve në një renditje të çfarëdoshme të tyre prej nga del se një ndërtim i tillë nuk përbën fjali. “*Periudhë është njësia e tërësishme e lidhur kuptimore, strukturore e intonacionore, e përbërë prej dy a më shumë njësish kallëzuesore në formë fjalie, në raporte të caktuara midis tyre.*”¹²⁵

Në këtë tekst theksohet se nuk ekziston një vijë e qartë ndarëse midis fjalisë dhe periudhës dhe se në disa gramatika përdoret termi fjali për të dyja konceptet duke e bërë dallimin vetëm në ndarjen në fjali të thjeshtë dhe të përbërë që u përgjigjen respektivisht fjalisë dhe periudhës. Në artikullin e sipërpërmendur të M. Domit vëmë re një ndryshim në përkufizimin e periudhës: “*Periudhë është tërësia e njësishme...*” dhe një fjali që nuk e gjemë në përkufizimin e Gramatikën e 1997 të shtuar këtij përkufizimi “*që jep një kumtim të plotë.*” Gjymtyrët e dyta ai i klasifikon sipas funksioneve semantike-sintaksore që ato përmbushin. (f. 105)

A. J. Rrota: fjali fjali e përbame prej fjalish së dyta (fjali e parë+ fjali e dytë)

A. J. Rrota për fjalinë thotë se “Ajo është një grumbull fjalësh që rrëfejnë një mendim të plotë.”¹²⁶, kurse në vend të termit periudhë përdor temin fjali e përbame prej fjalish së dyta me të cilin nënkupton një fjali e cila ka, përveç fjalisë së parë edhe një ose më shumë fjali të dyta a të varëshme. Këto të fundit, zënë, sipas tij, vendin e një gjymtyrë të fjalisë së thjeshtë dhe u përgjigjen të gjitha pyetjeve që bën ajo gjymtyrë e fjalisë së thjeshtë, në vend të së cilës rri.

K. Cipo: fjali periodë/periudhë hipotetike (protazë+ apodozë/fjali e varur+ kryesore)

S. Floqi: fjali periudhë (fjali kryesore+ fjali e varur)

Çështjen e dallimit midis fjalisë dhe periudhës e ka trajtuar edhe S. Floqi¹²⁷, i cili, pasi kritikon pranimin e ndërtimeve me formë të pashtjelluar si fjali, për arsye se ato nuk kanë kategoritë gramatikore karakteristike që ka një folje, ai bën edhe dallimin e ndërtimit “fjali kryesore + fjali e varur” të cilën e quan periudhë me fjali të varur nga ndërtimi “bërthamë kallëzuesore + të ashtuquajturat “fjali të pashtjella”, të cilin e quan fjali të vetme dhe propozon emërtimin e tyre “gjymtyrë të përbëra”. Në këtë mënyrë ai shfaq mendimin se në gjuhën shqipe do të njihen dy nyje sinonimike funksionale: brenda fjalisë - gjymtyrët e fjalisë; kurse në periudhë - fjalia e varur.

M. Totoni: fjali frazë (fjali kryesore+ fjali e nënrenditur)

¹²⁵ Gramatika e gjuhës shqipe, v II, Sintaksa, Tiranë 1997, f. 61

¹²⁶ A. J. Rrota, Sintaksa e gjuhës shqipe, për klasën II, III, IV të shkollave të mesme, botim i dytë, Shkodër 1944, f. 3

¹²⁷ S. Floqi, Disa tipe semantiko-strukturore të periudhave me fjali të varura në shqipen e sotme, Konferenca I e studimeve albanologjike, Tiranë 1962, f. 224

Siç e sollëm përkufizimin e M. Totonit për frazën edhe në faqen 40 të këtij punimi, këtu duhet të theksojmë se synimi i ti ka qenë të vërë në dukje nëpërmjet dallimit të saj nga fjalia, edhe qëndrimin e tij të ndryshëm nga ai i gjuhëtarëve të tjerë: “Me frazë do të kuptohet njësi sintaksore ligjërimore që karakterizohet nga intonacioni i mbaruar dhe nga kumtimi i plotë brenda një konteksti të caktuar. Frazja mund të ketë strukturë fjali ose jo. Ajo mund të përbëhet nga një ose më shumë fjali, por edhe nga një fjalë e vetme, e cila mund të plotësohet nga konteksti... Frazja mund të jetë e thjeshtë, kur struktura e saj përputhet me strukturën e fjalisë dhe e përbërë, kur struktura e saj përmban dy a më shumë fjali. Me fjali do të kuptohet ajo njësi sintaksore që ka në bazë një folje të shtjelluar.”¹²⁸

Siç e vëmë re në përkufizimet e dhëna për fjalinë e frazën janë bërë me koncepte të logjikës.

Duke parë përdorimin në vend të njëri-tjetrit të termave fjali, periudhë, frazë, e gjejmë me vend të theksojmë se, nëse përdorimi i këtyre termave është thjesht dhe vetëm çështje përzgjedhjeje emërtimi, çështja e shtruar është lehtësisht e zgjidhshme, por, nëse nuk është e tillë, siç rezulton në jo pak raste, çështja bëhet më e ndërlikuar, sepse hyjnë në diskutim ndryshimet strukturore, formale e gramatikore ndërmjet fjalisë e periudhës.

Dallimi ndërmjet tyre sipas nesh qëndron:

- në përmbajtjen më të pasur, më komplekse e më të plotë që periudha ka në raport me fjalinë, (ndonëse duhet thënë se ky nuk është një përgjithësim absolut, sepse ndodh që edhe një fjali e mëvetësishme mund të japë një kumtim kompleks po ashtu si periudha);
- në larminë dhe në kompleksitetin e formave strukturore të periudhës në raport me fjalinë.

Në rastin konkret, kur, nga disa studiues, është bërë klasifikimi i fjalive (të nënrenditura kushtore) në vend të klasifikimit të periudhës me fjali të nënrenditur kushtore, në të cilin merren parasysh raportet midis fjalive të periudhës, plotësia kuptimore dhe strukturore e tyre; përdorimi i këtyre termave, s`duket dhe aq “i padëmshëm”, sepse e zhvendos vëmendjen nga njësi e tërësishme në njësinë më të vogël kumtuese, aq më tepër kur një kufizim i tillë është bërë i ditur edhe në Gramatikën e gjuhës shqipe - Sintaksën, botim i Akademisë së Shkencave në f. 60 ku thuhet: “Fjalia që është pjesë e periudhës, s`i ka të gjitha tiparet e fjalisë së mëvetësishme... Si rrjedhim, njësi e kallëzuesore që përbëjnë periudhën iu është mohuar karakteri i fjalisë duke u quajtur në traditat gramatikore të disa vendeve e nga disa studiues -pjesë të “fjalisë së përbërë”


¹²⁸ M. Totonit, Frazja me nënrenditje, SHBLU, Tiranë 2000, f. 9, shënimi 1

2.1.3 Klasifikimi nga gramatikanët sipas modalitetit (reale, joreale apo potenciale)

Çështja që duhet sqaruar në këtë rast nuk është thjesht emërtimi i llojeve të kushtit, por kriteri i ndjekur për të arritur në një tip klasifikimi a në një tjetër.

Skema nr. 2

M. Lambertz:



K. Cipo, siç e theksuam edhe pak më sipër, pavarësisht paqëndrueshmërisë në terminologji, sepse i përdor të alternuar termat fjali kushtore dhe periudhë kushtore, edhe pse e ka sqaruar se ç`kuptohet me secilën prej tyre që në krye të tekstit të gramatikës së tij dhe pavarësisht se nuk e shpjegon se mbi bazën e ç`kriteri i ndan periudhat në këtë mënyrë, sqaron se njeh tri lloje periudhash:

“Fjalja kushtore është tri farësh: periodë hipotetike e realitetit, periodë hipotetike e mundësisë dhe periodë hipotetike e pamundësisë.”¹²⁹

Skema nr. 3

K. Cipo



Për llojin e parë ai nuk jep sqarime për arsyen e këtij emërtimi, por kalon thjesht në lidhëzat me të cilat ndërtohen ato dhe njëkohësisht edhe mënyrën e foljeve me të cilat takohen në fjali ato: **në qoftë se, po qe se, në + mënyra dëftore**. Kufizimi i lidhjes së tri lidhëzave të lartpërmendura me fokje kallëzues vetëm në mënyrën dëftore tregon që autori është i bindur që kushti të jetë real dhe periudha që e përmban atë, të jetë hipotetike e realitetit, duhet që folja të jetë vetëm në mënyrën dëftore.

Kushtore të mundësisë ai quan fjalinë që e pranon mundësinë e protazës dhe të apodozës, po nuk e pohon dhe krahas këtij përkufizimi jep lidhëzat dhe kohët e mënyrat e foljeve: **në qoftë se + dëftore, po + aorist, po + present koniuktif**.


¹²⁹ K. Cipo, vep. cit. f. 95-96

Me gjithë kufizimin vetëm në këto mjete lidhëse dhe në kohët e mënyrat e kufizuara me të cilat ato vendosin lidhje: lidhëzën kushtore **po** dhe lokucionin lidhëzor **në qoftë se**, në fund të shpjegimeve për këtë lloj kushti e fjalie të nënrenditur kushtore, shembulli që ai pohon se është vërtet një fjali kushtore e mundësisë jepet me lidhëzën kushtore në, e cila nuk ishtë përmendur si mjet lidhës pikërisht për këtë tip periudhash dhe që i prin një kallëzuesi në mënyrën dëshirore. “... **në** e gjeç rrugës, thuaj të fala. ... Nga këto tri shëmbëlla vetëm kjo e fundit është me të vërtetë fjali kushtore e mundësisë”¹³⁰

Kurse për fjalinë kushtore të pamundësisë gjejmë këtë argumentim: “Kur pranoj në protasët një hipotezë të pamundur ose në kundërshtim me të vërtetën, sepse ka ndodhur e përkundërta e asaj që pohohet, ahëre edhe rrjedhimi (apodosa) do të jetë i pamundur dhe kemi një fjali kushtore të pamundësisë.” Lidhëzat janë sjellë të shoqëruara nga kohët e mënyrat me të cilat i gjejmë të përdorura për të bashkuar fjalitë në periudhë: po të/të + imperfekt, po të/të + plusquamperfekt, të + lidhore-habitore, vetëm me prezentin e koniuktivit, sikur + imperfekt ose plusquamperfekt të koniuktivit.

Skema nr. 4.


A. J. Rrota



Për përcaktimin e llojeve të fjalive kushtore A. J. Rrota¹³¹ mbështetet në mënyrën e kryerjes a të moskryerjes së kushtit të vënë dhe dallon: fjalinë (qyshkore) kushtore të njimendët (rreale), fjalinë (qyshkore) kushtore të mundëshme (potenciale) dhe fjalinë (qyshkore) kushtore të pamundëshme (irreale). “Në tipin e parë puna e kryefjalisë ndodhë sigurisht, në qoftë se shkon në vend kushti i vum, në tipin e dytë shka tregohet në kryefjalin mund të ndodhi, po u krye kushti i vum dhe në tipin e tretë, shka tregohet në kryefjalin nuk mund të ndodhi, mbassi kushti i vum nuk kryhet kurr” (f. 85)

Skema nr. 5.

M. Domi




¹³⁰ K. Cipo, Sintaksa, Instituti i Shkencave, Tiranë 1952, f. 95

¹³¹ A. J. Rrota, vep. cit. f. 85

M. Domi duke marrë si kriter mënyrën sipas së cilës mund të kryhet kushti e kuptimin që marrin, autori, në librin e parë, dallon tri lloj periudhash hipotetike: - të realitetit; - të mundësisë e - të pamundësisë duke argumentuar me shembuj secilin lloj. Në gramatikën e vitit 1971 në fillim dallon fjalitë kushtore të mirëfillta dhe fjalitë hipotetike dhe më tej, duke marrë për bazë llojet e kushtëzimit midis përmbajtjes së fjalisë kushtore dhe fjalisë që plotëson ajo si real apo të mundshëm, irreal a të pamundshëm, nuk jep emra të tjerë fjalish sipas llojit të kushtit, por shpjegon nëpërmjet shembujsh, realizimin ose jo të veprimit të kushtëzuar në varësi të realizimit a mosrealizimit të kushtit.

Skema nr. 6

E. Guinard



E. Guinard¹³², pasi jep përkufizimin e fjalisë së nënrenditur kushtore e cila shpreh përgjithësisht një fakt, një ngjarje të vendosur si kusht për realizimin e faktit të shprehur në fjalinë kryesore, ai përcakton kriterin që, sipas tij duhet ndjekur për t'i ndarë fjalitë kushtore: *“Sipas aspektit prej të cilit autori mendon, përfytyron realizimin e këtij fakti: eventualitet i pastër e i thjeshtë, mundësi, pamundësi: ‘Ne, - thotë ai, mund t'i ndajmë të nënrenditurat kushtore në tri klasa të mëdha: Hipotetike, Potenciale, Joreale”*¹³³

Siç e vëmë re edhe te ky autor kriteri për klasifikimin e fjalive është realizimi ose jo i faktit të shprehur në fjalinë e nënrenditur.

Para se të kalojmë në analizimin e këtyre tri klasave veç e veç, autori vë në dijeni lexuesin se ai ka vënë re një “sjellje” të ndryshme të fjalive kushtore në tri gjuhë: frëngjisht, shqip dhe rumanisht si në përdorimin e lidhëzave që bashkojnë fjalitë që ndërtojnë periudhën kushtore, ashtu edhe në kohët dhe mënyrat e foljeve të këtyre fjalive.

Fjali e nënrenditur hipotetike për E. Guinard është ajo fjali që shpreh një fakt mbi realitetin për të cilin folësi nuk jep shpjegime, nuk shpreh mendimin e vet dhe që

¹³² E. Guinard vep. cit

¹³³ Po ai f. 57

tregon që nga realizimi i kushtit vjen ose varet fakti i shprehur në fjalinë kryesore. Të dyja kushtet mendohen prej tij si hipotetike.

Vëmë re këtu dy çështje të cilat duhet të ndalemi pak: së pari emrin që ky tip fjalie mban (hipotetike) jemi mësuar ta gjejmë nëpër tekste si unitet të dy pjesëve - të nënrenditur dhe kryesore- të periudhës kushtore ndërkohë që këtu ky term përfaqëson veçse fjalinë e nënrenditur. Mendojmë që kjo është çështje parapëlqimi emërtimi, meqë faktet e të dyja fjalive mendohen si hipotetike, edhe pse ai i fjalisë së nënrenditur shpreh një fakt mbi realitetin, pa shtuar asnjë lloj ngjyrimi subjektiv dhe pra fjalia mund të emërtohej eventuale apo reale. Çështja e dytë ka të bëjë me faktin se ai flet për fjalinë e varur kushtore dhe jo për periudhën me fjali të varur kushtore duke u kufizuar në punim vetëm me trajtimin (për aq sa ka ai synimin, meqë fjalinë e varur kushtore e trajton në kuadrin e gjerë të fjalive të varura të gjuhës shqipe) e mjeteve të shprehjes së raporteve kushtore.


“E nënrenditura potenciale” shpreh një fakt të mundshëm, të parashikueshëm ose imagjinar pa i paraprirë realizimit të tij. Ajo nënvizon që realizimi i këtij fakti (pra atij që shprehet në të nënrenditurën) përbën një kusht për realizimin e faktit të shprehur në fjalinë kryesore. Meqenëse realizimi i këtij kushti është i mundshëm, i tillë do të jetë edhe ai i fjalisë kryesore.

Fjalia e nënrenditur joreale ndahet prej këtij autori në joreale të së tashmes dhe në joreale të së shkuarës të cilat dallohen nga njëra-tjetra nga koha në të cilën duhej të realizohej kushti në fjalinë e nënrenditur, por që nuk është realizuar dhe për rrjedhim edhe fakti i fjalisë kryesore është i porealizueshëm.

Ajo që duam të vëmë në dukje këtu është që në të nënrenditurën joreale të së tashmes autori përfshin dy fakte që u përkasin dy kohëve të ndryshme: njëri që nuk përputhet me realitetin e së tashmes dhe tjetri që konsiderohet si i pamundur për t'u realizuar në të ardhmen gjë që nuk pasqyrohet në emërtimin e këtij tipi fjalie. (f. 62-63)

Skema nr. 7

S. Prifti



S. Prifti për të dalluar farët e periudhës kushtore merr si kriter mënyrën se si merret a mendohet kushti i dhënë: kushti mendohet si objektiv, i mundshëm ose i pamundshëm prandaj edhe periudhat janë: 1) kushtore e realitetit kur folësi e mendon kushtin në mënyrë objektive dhe e konsideron atë si një pohim a mohim të padyshimtë, pa treguar se cili është mendimi i tij i vërtetë në lidhje me raportin real që ka kushti me apodozën.

2) kushtore e pamundësisë kur kushti merret a mendohet si diçka e pamundur si e kundërta e asaj që ndodh në realitet dhe të tillë janë edhe kushti edhe protaza. 3) kushtore e mundësisë, kur kushti dhe pasoja merren si të mundshme, si diçka që pritet të realizohet apo të mos realizohet.

Në lidhje me këtë ka bërë një trajtim të përfshirë në studimin për disa çështje që kanë të bëjnë me periudhën kushtore, S. Mansaku¹³⁴.

Skema nr. 8


S. Mansaku



Ai çështjen e klasifikimit sipas kuptimit modal e lidh me periudhën në tërësi dhe, për këtë arsye, vë në dukje, nëpërmjet vërejtjeve, mospërputhjen e kriterëve për të dalluar realitetin nga irealiteti dhe nga mundësia. Ai nuk pajtohet me mënyrën e ndarjes sipas kuptimit modal që u është bërë tipave të fjalive kushtore në reale, joreale dhe potenciale, sepse vë re që, në disa raste, merr përparësi periudha në tërësi dhe, në raste të tjera, merret parasysh vetëm modaliteti i fjalisë drejtuese duke e konsideruar kushtin si fakt real. Duke u mbështetur mbi këto arsyetime ai mendon se është më mirë që periudhat kushtore, sipas kuptimit modal, të ndahen në dy grupe: potenciale dhe ireale.

Skema nr. 9

M. Totoni



¹³⁴ S. Mansaku, Rreth formave të shprehjes së raporteve kushtore në shqipen e sotme letrare, SF, 1969/3, f. 155

M. Totoni¹³⁵ pasi bën ndarjen e marrëdhënieve kushtore në reale dhe joreale dhe jep mendimin se në tipin e dytë këto marrëdhënie mund të shfaqen si të mundshme a të pamundshme, duke u bazuar në mundësinë ose jo të realizimit të pasojës në varësi të realizimit apo jo të kushtit. Ai jep konceptet reale dhe joreale për marrëdhënien kushtore që shprehet në periudhat kushtore dhe flet për mbështetëset e këtyre marrëdhënieve ku numëron lidhëzat, bashkëlidhjen e formave mënyrore e kohore të foljeve kallëzues dhe kontekstin.

Ashtu siç e pamë më sipër, problemi që u shtrua për zgjidhje ishte të përcaktohej se cili kriter konsiderohej më i saktë për t'u ndjekur: të merrej për bazë ndërtimi kompleks i periudhës kushtore ku hyn edhe fjalia drejtuese edhe e nënrenditura, apo të merrej parasysh fakti, i cili duket më bindës, se si paraqitet kushti në fjalinë e nënrenditur kushtore. Le të marrim një shembull konkret: **Nëse** me të vërtetë ekziston diçka e kushtueshme në themelet e kësaj shtëpie, policia do ta gjejë...

M. Camaj vepra V f.133

Kur kushti është real:

Kushti që në themelet e asaj shtëpie për të cilën flitet në fjali të ketë diçka të kushtueshme është i mundshëm dhe ai që flet pret që gjërat të shkojnë pikërisht kështu. Përdorimi i mënyrës dëftore në të dyja fjalitë, si në të nënrenditurën, ashtu edhe në drejtuesen, si edhe përdorimi i emrit të pashquar të vërtetë me parafjalën me që është i barazvlershëm me ndajfoljen vërtet dhe që është përdorur në fjalinë e nënrenditur kushtore në funksion të rrethanorit të mënyrës, përforcojnë idenë e ekzistencës së një ideje të hedhur (mbi kushedi se ç`baza) se në themelet e asaj shtëpie ka diçka të kushtueshme dhe i mbetet detyrë policisë ta gjejë. Për të provuar që ideja e hedhur është reale, mund t'i shtojmë periudhës mohimin e kushtit: Por në themelet e kësaj shtëpie nuk ekziston asgjë e kushtueshme. Nëse periudha rezulton me kuptim siç ndodh në këtë rast, atëherë kushti është real dhe periudha është kushtore e realitetit.

Kur kushti është i mundshëm:

Nëse me të vërtetë ekzistonte diçka e kushtueshme në themelet e kësaj shtëpie, policia do ta gjente... Ajo që pritet, në fakt, nuk është dhe aq e sigurt, edhe pse është e mundshme të vërtetohet ideja e hedhur. Kohët e përdorura në të dyja fjalitë (e pakryera e dëftores në fjalinë kushtore dhe e kushtores në fjalinë drejtuese), na japin idenë e mundësisë, por të pasigurisë. Po të provojmë t'i shtojmë periudhës mohimin e kushtit të shprehur në fjalinë kushtore: Por, për fat të keq në themelet e kësaj shtëpie nuk ekzistonte asgjë e kushtueshme. ; periudha rezulton me kuptim dhe kushti është i mundshëm pra periudha është kushtore e mundësisë.

¹³⁵ Vep. cit. f.98

Kur kushti është joreal:

Nëse me të vërtetë do të ekzistonte diçka e kushtueshme në themelet e kësaj shtëpie, policia do ta kishte gjetur. Kushti i referohet një fakti që nuk ka ndodhur, është një lajm i rremë, sepse nga kërkimet e policisë nuk u gjet asgjë e kushtueshme pra: nëse në themelet e asaj shtëpie do të kishte vërtetë ndonjë gjë të kushtueshme, mbas gjithë atyre kërkimeve të policisë, do të ishte gjetur. Pra policia s'ë gjeti, sepse s'ishte në themele, nuk vërtetohet kushti i ekzistencës së “thesarit”. Duke mos qenë i vërtetë kushti, nuk mund të jetë e vërtetë as pasoja - gjetja e tij prej policisë. Këtë e sinjalizon përdorimi i kushtores në të dyja fjalitë. Për të provuar nëse kushti është vërtetë joreal, i shtojmë pohimin e kushtit dhe të pasojës: *Por “diçkaja” e kushtueshme ekzistonte në themelet e asaj shtëpie dhe u gjet nga policia. Siç e shohim na del një periudhë kontradiktore gjë që vërteton jorealitetin e kushtit dhe e bën periudhën të marrë emrin kushtore e jorealitetit.* Të njëjtin arsyetim do të ndiqnim edhe në rastin e periudhës:

Nëse dikush vjen e m'ë merr këtë tokë një ditë, do t'ë grryjej të dy sytë me këta thoj! M. Camaj, *Vepra letrare I*, f.101.

Duke mbajtur parasysh shpjegimin e modalitetit në gramatikën e gjuhës shqipe¹³⁶ është marrë në konsideratë roli që luan secili prej mjeteve të ndryshme gjuhësore në shprehjen e modalitetit të fjalisë ku ndodhet.

Roli i mënyrave të foljeve është më i rëndësishmi, sepse nëpërmjet kësaj kategorie: *“...shprehet lidhja midis veprimit të emërtuar nga folja dhe realitetit objektiv. Pra me anë të kategorisë gramatikore të mënyrës folësi shpreh qëndrimin e tij ndaj veprimit të emërtuar nga folja, duke e paraqitur atë si të vërtetë, të mundshëm, të dëshirueshëm etj.”*¹³⁷.

Rol ndihmës në shprehjen e modalitetit luajnë foljet me vlerë modale, të cilat, të shoqëruara nga folja në mënyrën lidhore ndërtojnë kallëzuesin e përbërë dhe *“...shërbejnë për ta paraqitur veprimin e shprehur nga folja ndjekëse si të mundshëm ose të lejueshëm, të detyrueshëm ose të domosdoshëm.”*¹³⁸.

Së fundi rol ndihmës luajnë edhe pjesëzat modale, të cilat: *“...shërbejnë për të shprehur qëndrimin e folësit ndaj një a më shumë mendimeve, ndaj vërtetësisë së një ngjarjeje a dukurie të realitetit objektiv.”*¹³⁹

Në ndërtimet kushtore me kallëzues të përbërë të ndërtuar me foljet modale gjysmëndihmëse mund, duhet, do, të cilat S. Riza i ka quajtur «folje funksionalisht të pavetëmjaftueshme»¹⁴⁰ kushti i shprehur është i mundshëm.

¹³⁶ Me termin modalitet kuptohet të shprehurit e qëndrimit të folësit ndaj asaj që kumton, në lidhje të ngushtë me realitetin objektiv. Ky qëndrim i folësit mund të shprehet me mjete të ndryshme gjuhësore: me anë të mënyrave të foljes, me anë të foljeve me vlerë modale, me anë të pjesëzave modale. *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Tiranë 1995, f. 261

¹³⁷ *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Tiranë 1995, f. 272

¹³⁸ Po aty, f. 261

¹³⁹ Po aty, f. 419

¹⁴⁰ S. Riza Vepra të zgjedhura, ASHRSH, QSA, Tiranë 2009, f. 457-458 *“Pra foljet dua, mund, duhet etj. të shembujvet t'anë-vullnetin, aftësinë, nevojën etj. i çfaqin jo në vetëvehte e për vetëvehte, por*

Ndryshe mendon për këtë çështje S. Riza në “Vepra të zgjedhura”: “*Nga të gjitha mënyrët foljore e vetmja që shpreh realitetin a egzistencën e konstatueshme është mënyra dëftore, por ... ndërsa me mënyrën dëftore folësi shpreh një fenomen për ta konstatuar si efektivisht ekzistues, përkundrazi me mënyrët II. **habitore**, III. **kushtore**, IV. **lidhore**, V. **dëshirore**, VI. **lidhore-habitore** dhe VII. **urdhërore** folësi shpreh nga një fenomen për ta prezumuar si potencialisht ekzistues dmth. si qëndruar në këtë apo atë raport ndja egzistencës efektive...*”¹⁴¹

S. Riza mendon gjithashtu se në ndërtimin: “*Do të vinja po të kisha kohë (por e di mirëfilli se nuk do të kem kohë, e se prandaj edhe nuk do të vinj) [me kohën e tashme të mënyrës kushtore], kushti ...jipet prej folësit si i paplotësueshëm, kurse në shembullin e dytë: Do të kisha ardhur po të kisha pasur kohë (por në të vërtetën nuk kam pasëur kohë, e prandaj edhe nuk kam ardhur) [në të kryerën e kushtores] veprimi jipet si i paplotësuar. Anasjelltas, nëqoftëse kushti pranohet si i plotësueshëm, atëherë në vend të mënyrës kushtore përdoret dëftorja. Do të vinj po të kem kohë.*”¹⁴²

“*Por, në gjuhën shqipe dëshirorja përdoret ... sa herë që kemi të bëjmë me të mvarura kushtore-joireale, prirë nga parafjala në. ... Gjithashtu origjinarisht, shprehja e kushtit me anë të këtyre trajtave do të jetë përsjellë nga nënkuptimi i dëshirueshmërisë së këtij kushti (jo-ireal).*”¹⁴³

Duke vlerësuar trajtimet e mësipërme të kësaj çështjeje, ne mbështesim mendimin dhe argumentet e profesor Mansakut që periudhat me fjali të nënrenditura kushtore, meqenëse i referohen periudhës në tërësi, janë potenciale dhe ireale, duke u shtuar këtyre argumenteve edhe faktin që një kusht që është i mundshëm, mund të jetë pjesë e realitetit, në çastin e realizimit, kurse një kusht joreal e ka të përfshirë, madje të sigurt pamundësinë e realizimit.

2.1.4 Disa të meta të klasifikimeve të mëparshme

2.1.4.1 Të meta të klasifikimit mbi bazën e kriterit strukturor

Termi aspekt strukturor në këto klasifikime merret me një vështrim të ngushtë, sepse kufizohet vetëm në mjetet gramatikore të lidhjes.

përkundri në lidhje e për pasojë pikërisht në marrëdhënie me n jë fenomen të dytë, i cili hepërhe është end vetëm i menduar, dhe shndërrimin e të cilit në një fenomen efektiv foljet dua, mund, duhet etj. e paraqesin si të vendosur, të mundur, të duhur etj. Prandaj na mendojmë se t'ashtuqajturat folje ndihmëse mënyrore janë për t'u tejkonceptuar dhe *tejpagëzuar folje “të pavetëmjaftueshme marrëdhënore.”*

¹⁴¹ Po ai, f. 497 dhe 499

¹⁴² Po ai, f. 503

¹⁴³ Po ai, f. 509

Duke pasur parasysh elementet që përcaktojnë strukturën e periudhës:

- Lidhëzat dhe përemrat lidhorë
- Trajtat mënyrore e kohore të foljeve kallëzues
- Bashkëlidhja e trajtave mënyrore e kohore të foljeve kallëzues
- Vendi a rendi i fjalive në periudhë;

duket se janë lënë pa u marrë parasysh aspekte të rëndësishme të këtij kriteri.

Nga ana tjetër, duke njohur ndarjen morfologjike të lidhëzave¹⁴⁴ nga ana e kuptimit në dy grupe: në lidhëza semantike dhe josemantike, do të vërenim që nga kjo ndarje do të përftoheshin dy grupe: njëri që përfshin periudhat, fjalitë e të cilave bashkohen me lidhëza semantike dhe tjetri ku mbeten për t'u grupuar vetëm një numër i kufizuar periudhash.

Por, ndërsa për të studiuar periudhat e grupit të dytë na mjafton ky kriter i zbatuar, sepse janë dy lidhëza të përcaktuara qartë se dhe që dhe shërbejnë për të bashkuar një fjali drejtuese me një fjali të nënrenditur: kryefjalore, kundrinore, kallëzuesore dhe/ose përcaktore; për grupin e dytë, na duhet të përdorim patjetër një kriter tjetër: atë të ndarjes sipas marrëdhënieve a raporteve që vendosen ndërmjet fjalive në periudhë, sepse nga kriteri i parë kemi përfutur një grup të përbashkët me lidhëzat bashkërenditëse: këpujore, veçuese, kundërshtore e përmbyllëse dhe ato nënrenditëse: vendore, kohore, shkakore, qëllimore, **kushtore**, krahasore, mënyrore, rrjedhimore, lejore, kundërvënëse.

Lidhëzat vërtet janë një element me mjaft peshë në strukturën e fjalisë dhe shpesh edhe përcaktues në shprehjen e raporteve kuptimore midis fjalisë së nënrenditur dhe asaj kryesore, por në disa raste, sidomos kur ato janë të shumëkuptimshme, nuk mund ta kryejnë me sukses “detyrën” e tyre, pa ndihmën e së paku njërit prej elementeve të tjerë p. sh.: bashkëlidhjes mënyrore e kohore të foljeve kallëzues të të dyja fjalive të periudhës si asaj kryesore dhe së nënrenditurës. Në raste të tjera si te fjalitë kryefjalore, kallëzuesore e kundrinore ku lidhëzat nuk janë tregues të rëndësishëm të raporteve sintaksore, hyn në veprim përbërja e fjalisë drejtuese.

Dallimi i fjalive lidhëzore nuk mbetet vetëm formal, por gërshetohet me aspektin funksional e semantik apo logjiko-gramatikor në përgjithësi. Emërtimi i lidhëzave nënrenditëse dhe dallimi i tyre në lloje të ndryshme nuk bëhet në baza krejt formale, por edhe kuptimore, kurse emërtimi i përemrave lidhorë dhe ndajfoljeve lidhore dhe termat lidhëza dhe fjalë lidhëse mbështeten në baza funksionale.

Megjithëse lidhëzat janë formuar nga përemrat lidhorë dhe ndajfoljet lidhore, këta të fundit, kanë edhe funksion sintaksor, pra shërbejnë si gjymtyrë të fjalisë ku ndodhen, në dallim nga lidhëzat, që shërbejnë vetëm për të bashkuar pjesët e periudhës.

¹⁴⁴ Gramatika e gjuhës shqipe I, Morfologjia, Tiranë, 1995, kreu X, Lidhëza, f. 398

E theksojmë këtë dallim, me qëllim që të përcaktohen më mirë raportet sintaksore që ata shprehin dhe të kuptohet qartë natyra e fjalisë së varur që fillon me këto fjalë lidhëse.

Ndarja e fjalive të lidhura me fjalë lidhëse në pyetëse të zhdrejta dhe në lidhore përzien modalitetin me formën e lidhjes.

Ky klasifikim nuk siguron shtrirjen e tij edhe në klasifikimin e gjymtyrëve të fjalisë.

2.1.4.2 Të meta të klasifikimit sipas kriterit funksional

Ky kriter barazon fjalitë e nënrenditura me gjymtyrët e fjalisë, qofshin këto kryesore apo të dyta. Pavarësisht nga disa karakteristika të ngjashme me ato të gjymtyrëve të fjalisë që ka dhënë S. Prifti¹⁴⁵ siç janë:

Varësia

Funksioni (zgjerojnë, plotësojnë, sqarojnë fjalinë nga varen)

Zëvendësimi reciprok i fjalive të varura nga plotësori dhe anasjelltas,

edhe ai vetë konstaton që një zëvendësim i tillë nuk është gjithmonë i mundshëm, por edhe analogjia funksionale me gjymtyrët e fjalisë nuk është e plotë, sepse, edhe pse ka plotësor mjeti, nuk njihet ndonjë fjali e nënrenditur mjeti; njihet fjalia rrjedhimore, por s'ka plotës të rrjedhimit; fjalitë kryefjalore, kallëzuesore dhe kundrinore nuk kanë lidhëza të veçanta për t'u bashkuar me fjalinë drejtuese. Gjithashtu ai vë në dukje edhe një të metë tjetër të këtij klasifikimi, për të cilën, megjithatë, gjen një argument për ta konsideruar si kriter për t'u ruajtur: *“Ky klasifikim ka të metë, se është më pak gramatikor dhe më tepër logjik, por gjuha pa mendimin mbetet gjithmonë një gjë e zbrazët.”*¹⁴⁶

Një gjë të tillë e ka vënë në dukje edhe S. Floqi i cili thekson se ka marrëdhënie që shprehen në periudhë, por nuk shprehen në fjali¹⁴⁷ dhe këtu sjell si shembull mosnjohjen e plotësve të lejimit (si gjymtyrë fjalie) dhe mungesën e fjalive të varura të sasisë dhe të mjetit (si fjali në periudhë). Gjithashtu ai vë në dukje që nuk ka zbuluar ndonjë lidhje kuptimore ndërmjet përmbajtjes së fjalisë së varur kryefjalore dhe kryefjalës si gjymtyrë fjalie.

Duke u bashkuar me mendimet e shprehura më sipër, ne mendojmë gjithashtu që analogjia ndërmjet gjymtyrëve të fjalisë dhe fjalive të nënrenditura nuk është uniforme në të gjitha gjymtyrët e fjalisë që njihen. Te disa autorë¹⁴⁸ janë njohur fjalitë e nënrenditura ndajshtimore, madje ky tip fjalie njihet edhe nga sintaksa e shqipes së sotme, si një nga nëndarjet e fjalisë së nënrenditur përcaktore, ndërkohë që duhet

¹⁴⁵ S. Prifti, Klasifikimi i fjalive të varura, SF 1972/2, f. 137-152

¹⁴⁶ S. Prifti, Konferenca I e studimeve Albanologjike, Tiranë 1965, f. 381

¹⁴⁷ S. Floqi, po aty, f. 225

¹⁴⁸ S. Prifti, po aty, dhe I. D. Sheperi, vep. cit. f.152-153

theksuar se ndajshtimi është një lloj përcaktori që dallohet nga përcaktorët e llojeve të tjera nga përshtatja (jo e plotë) vetëm në numër me gjymtyrën e përcaktuar.

Edhe më i pashpjegueshëm duket kalimi te nënndarjet e përcaktorit siç është ndajshtimi, në një çast që nuk kemi parë te asnjë autor të përmendet fjalia e nënrenditur përcaktore kallëzuesore, derisa ky lloj përcaktori me lidhje të dyfishtë me kallëzuesin nga njëra anë dhe me kryefjalën a kundrinorin nga ana tjetër njihet si një nga gjymtyrët e dyta brenda fjalisë.

P. sh.: I. D. Sheperi njeh me emrin “*kallëzues të kundrinës*” (f. 147) përcaktorin kallëzuesor të kundrinorit, kurse përcaktor kallëzuesor të kryefjalës, me sa kuptojmë nga mënyra e trajtimit, ky autor quan gjymtyrën emërore të kallëzuesit emëror të cilën e emërton “*kallëzues ose atribut*” (f. 142)

A. Xhuvani, K. Cipo, R. Përnaska dhe E. Guinard në veprat e cituara më sipër nuk pranojnë fjalinë e nënrenditur kallëzuesore (sepse nuk e kanë renditur ndër llojet e numëruara), ndërkohë që kallëzuesi është gjymtyra më me peshë në fjali, qoftë kjo e mëvetësishme apo e nënrenditur. Duke përbërë bërthamën e fjalisë rreth së cilës sillen gjymtyrët e tjera, madje edhe vetë kryefjala, e cila, nga pjesa më e madhe e gjuhëtarëve, është trajtuar gjithashtu si kryegjymtyrë dhe, duke njohur tashmë konceptin e S. Priftit për konsiderimin e fjalive të nënrenditura si “gjymtyrë plotësore të fjalisë së mbirenditur të plotësuar, kryesore ose jo” që dallohen nga gjymtyrët e zakonshme të fjalisë nga të qenët gjymtyrë predikative pra gjymtyrë të periudhës në tërësi¹⁴⁹, lind pyetja se përse nuk është studiuar nga këta autorë tipi i fjalive të nënrenditura kallëzuesore. Për sa u përket fjalive përcaktore, të cilat janë një mishërim i drejtpërdrejtë i paralelizmit me gjymtyrët e fjalisë, me to janë kuptuar fjalitë që varen nga një emër dhe që nga ndonjë autor (S. Prifti) janë quajtur edhe cilësore. Ato bashkohen me fjalinë nga varen dhe të cilën përcaktojnë me anë të përemrave lidhorë.

2.1.4.3 Të meta të klasifikimit sipas kriterit semantik strukturor

Me gjithë disa anë pozitive të këtij tipi klasifikimi, që edhe ne gjatë punimit i kemi vënë në dukje, ai është kritikuar së pari nga Eqrem Shijaku në diskutimin rreth kumtesës së S. Floqit për disa tipe të periudhës me fjali të varur që rezultojnë pas zbatimit të klasifikimit sipas kriterit semantiko-strukturor. E. Shijaku shpreh: “*Kumtuesi përpiket të gjejë një sistem unik për sintaksën e periudhës. Po kriteri semantiko-strukturor, që ai propozon për periudhën, nuk zbatohet në fjali, ku edhe vetë kumtuesi merr parasysh kriterin semantiko-funksional... Kriteri semantiko-strukturor, sipas mendimit tim, vështirëson studimin e sintaksës dhe sidomos nga*

¹⁴⁹ S. Prifti, vep. cit. SF 1972/2, f. 139-143

pikëpamja metodiko-shkollore paraqet vështirësi për analizën logjike të periudhës, e cila lehtësohet nga kriteri funksional dhe sistemi i pyetjeve.”¹⁵⁰

Me gjithë marrjen parasysh të më shumë se një elementi të strukturës së periudhës me fjali të nënrenditur, ne pajtohemi me mendimin e M. Totonit të shprehur në librin me titull “*Fraza me nënrenditje*”¹⁵¹ që ky klasifikim:

Nuk është i plotë, sepse grupi i tretë, të cilit S. Floqi (që ka ndjekur kriterin semantik-strukturor të klasifikimit të periudhave me fjali të nënrenditur i ka përmendur vetëm emrin, nuk është dhënë me nënndarje të mëtejshme dhe për rrjedhim:

- kanë mbetur jashtë klasifikimit fjalitë përcaktore që kanë si fjalë mbështetëse një emër a një togfjalësh;
- kanë mbetur gjithashtu jashtë klasifikimit fjalitë rrethore që saktësojnë një gjymtyrë të fjalisë kryesore;
- roli dhe vlera e korrelatit ndikojnë në kuptimin e periudhës, në varësi të pozicionit që ai zë në raport me fjalinë e nënrenditur: nëse korrelati ndodhet para fjalisë së nënrenditur, fillohet dhe sqarohet nga ajo, por nuk sqarohet se ç`ndodh kur korrelati ndodhet pas saj dhe këtej buron edhe pamundësia e përfshirjes së këtyre dy tipave të frazave në të njëjtin grup;
- fjalët që merren si korrelatë kanë kuptime dhe funksione të ndryshme dhe u përkasin pjesëve të ndryshme të ligjëratës: përemra dëftorë, të pacaktuar, ndajfolje sasive, mënyre etj.;
- natyra leksiko-gramatikore e fjalës me të cilën lidhen fjalitë e nënrenditura nuk vë në dukje ndonjë dallim thelbësor, nga ana strukturore, ndërmjet tipave korrelativë përemërorë-përemërorë dhe frazave ku fjalia përcaktore lidhet me një emër, prandaj mund të përfshihen fare mirë në një grup të dy këta tipa.

Për të korrigjuar këtë mangësi M. Totoni propozon nocionin e fjalës mbështetëse “që shërben si mjet i organizimit të frazës dhe natyra leksiko-gramatikore e saj përcakton strukturën e fjalisë së nënrenditur, lidhjen dhe marrëdhënien që vendoset me të.”¹⁵² Ai nuk e mënjanon nocionin e korrelatit, por nga përkufizimi që jep për secilin nocion, arrijmë të bëjmë dallimin ndërmjet tyre. Me pak fjalë: fjala mbështetëse drejton një fjali të nënrenditur, kurse korrelati kryen në fjalinë kryesore po atë funksion që mund ta kryejë edhe fjalia e nënrenditur. Korrelati mund të jetë fjalë mbështetëse kur qëndron para fjalisë së nënrenditur, kurse e anasjellta nuk ndodh, për shkak të rendit të ngulitur të fjalës mbështetëse para fjalisë së nënrenditur, në dallim nga zhvendosja më e lirë e korrelatit, i cili mund të pozicionohet edhe pas fjalisë së nënrenditur duke rimarrë përmbajtjen e saj në fjalinë kryesore dhe duke shfaqur funksionin e vet aktualizues.

¹⁵⁰ E. Shijaku, Konferenca I e studimeve Albanologjike, Tiranë 1965, f. 384

¹⁵¹ M. Totoni, *Fraza me nënrenditje*, SHBLU, Tiranë 2000, f. 13

¹⁵² M. Totoni, vep. cit. f. 17

2.1.5 Cilit kriter i përmbahemi në këtë punim

Fjalitë e nënrenditura rrethore mund të përmbushin pjesën më të madhe të funksioneve rrethore. Disa prej tyre japin të njëjtën ndihmesë semantike dhe mund të zhvendosen me të njëjtën lehtësi si sintagmat ndajfoljore të quajtura rrethorë. Termi rrethor tregon një grupim të bërë mbi baza semantike, por pas këtij emërtimi semantike fshihet një klasë ndërtimesh sintaksorisht jounike, joharmonike, që vë në veprim mekanizma kompleksë. Ne përdorim termin të nënrenditura rrethore duke qenë të ndërgjegjshëm për faktin që këto grupime tradicionale janë bërë mbi baza semantike.

Me gjithë vërejtjet e bëra nga S. Floqi, M. Domi, M. Totoni etj., për mosndjekje të një kriteri unik për klasifikimin e periudhave me fjali të nënrenditur, edhe ata vetë i kanë gërshetuar kriteret e ndryshme, sepse, të marrë veç e veç, asnjëri prej tyre nuk arrin ta përfshijë gjithë problematikën dhe kompleksitetin e kësaj kategorie të ndërlikuar.

Në këtë punim, duke u përpjekur nga njëra anë t'u shmangemi sadopak të metave që vumë në dukje më sipër, i përmbahemi kriterit strukturor të gërshetuar me kriterin funksional-sintaksor, dhe nga ana tjetër duke vlerësuar si bindëse mendimet e secilit prej gjuhëtarëve që janë shprehur për anët pozitive të kriterit funksional dhe e kanë zbatuar atë në shumicën e gramatikave shkollore.

Duket se përfshirja e kriterit strukturor (jo i vetëm), në klasifikimin e periudhave me fjali të nënrenditura nga S. Floqi në kumtesën: “Disa tipe semantiko-strukturore të periudhës me fjali të varur në shqipen e sotme”¹⁵³ është mirëpritur nga N. Havjari: “Me këtë kusht, pra zotërimi i parimit struktural mbi atë funksional për klasifikimin e përgjithshëm, mendoj se nuk prish punë aspak e, meqë na jep një sistem unik, mund të mirëpritet.”¹⁵⁴

S. Prifti vë në dukje këto të mira të kriterit funksional: “Analogjia funksionale ndërmjet gjymtyrëve të fjalisë dhe të fjalivet në periudhë është një element real me shumë rëndësi, që formon një vijë kuptimore të fuqishme për grumbullimin dhe lidhjen në mes të faktevet sintaktike, e cila i shërben fort edhe përvehtësimit sa më të lehtë të sintaksës.”¹⁵⁵ [...] “Prandaj unë mendoj se është më mirë të ruhet parimi funksional i klasifikimit të (fjalivet apo) periudhaves me fjali të varur. Ky ka këto të mira: a) nuk e dobëson anën kuptimore të periudhës; b) përsëritja dhe kryqëzimi, të paevitueshëm për mendimin tim në sintaksë, shtrihet në anën formale (mjetet e shprehjes); c) ndihmon më mirë për kuptimin e rolit të gjuhës dhe të sintaksës dhe për t'i parë format e ndryshme të shprehjes si forma të *mendimit*.”¹⁵⁶

¹⁵³ Konferenca I e studimeve Albanologjike, Tiranë 1965, f. 221

¹⁵⁴ N. Havjari, po aty, f. 383

¹⁵⁵ S. Prifti, Konferenca I e studimeve Albanologjike, Tiranë 1965, f. 379

¹⁵⁶ Po ai, po aty, f. 381

Ne marrim parasysh elementet strukturore të përmendura më sipër, të cilave nuk u është kushtuar vëmendja e duhur për të parë rolin që luajnë në ndërtimin e periudhës.

Duke gërshetuar kriteret tashmë të njohura e drejtojmë vëmendjen në studimin e tërësisë: fjali kryesore a drejtuese dhe fjali e nënrenditur duke e parë përbërjen leksikore të të dyja fjalive si bashkëveprim të rëndësishëm për të shprehur më qartë lidhjet kuptimore brenda periudhës.

Intonacioni që mban një peshë mjaft të veçantë sidomos në periudhë do të na ndihmojë të studiojmë veçmas periudhat asindetike në të cilat fjalitë bashkohen ndërmjet tyre me anë të intonacionit duke bërë dallimin në përdorimin e termave: palidhëzore për periudhat asindetike dhe jolidhëzore për periudhat ku lidhëza mungon, por mund të shtohet lehtësisht.

Paralelizmi sintaksor, mungesa e ndonjë gjymtyre të domosdoshme në një nga fjalitë e periudhës, fjalët e bashkëlidhura a korrelative, rendi i fjalive në periudhë, bashkëlidhja e trajtave kohore dhe mënyrore të foljeve kallëzues të të dyja fjalive; të gjithë këta elementë të cilët hyjnë në veprim një nga një apo në bashkëveprim me njëri-tjetrin, sidomos kur lidhëza, për shkak të shumëkuptimësisë dhe sferës së gjerë të përdorimit, nuk arrin ta përmbushë e vetme shprehjen e raporteve sintaksore brenda periudhës, do të na shërbejnë për të konstatuar e analizuar të gjitha mjetet e shprehjes së raporteve sintaksore në rastin tonë kushtore.

Në punim nuk është bërë një klasifikim mbështetur mbi kriteret që mendojmë se janë më të dobishme për t'u ndjekur, por, bazuar në mbështetjen e tri kriteret të përziera strukturore, semantike e funksionale, të cilat gjejnë shtrirje më të gjerë si në sintaksën e fjalisë, edhe në atë të periudhës, marrim parasysh gjatë renditjes së çështjeve praktike që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me çështjen për të cilën është ndërmarrë ky punim.

2.2 Vendi i fjalisë së nënrenditur kushtore në këto klasifikime

Skema nr. 10


A. Xhuvani

Klasifikimi sipas kriterit funksional-strukturor

Fjali të varme
kryefjalore
kundrinore
kohore
mënyrore
vendore
shkakore
lidhore
qëllimore
ndërmjetëse
krahasore
kushtore
rrjedhore
konçesive (lejore)


Skema nr. 11

I. D. Sheperi
Klasifikimi sipas kriterit funksional



Skema nr. 12

A. J. Rrota
Klasifikimi sipas kriterit funksional




Skema nr. 13

K. Cipo
Klasifikimi sipas kriterit funksional



Skema nr. 14

S. Prifti
Klasifikimi sipas kriterit funksional




Skema nr. 15

E. Guinard
Klasifikimi sipas kriterit funksional (strukturor)

Skema nr. 16


M. Domi
Klasifikimi sipas kriterit funksional strukturor semantik



Skema nr. 17

S. Floqi

Klasifikimi sipas kriterit semantik strukturor funksional



Skema nr. 18

Sintaksa e Akademisë

Klasifikimi sipas kriterit funksional

Fjali kryefjalore

- - lidhëzore filluese
- - përemërore
- -pyetëse e zhdrejtë

Fjali kallëzuesore

- - tipi lidhëzor
- - tipi përemëror
- - tipi ndajfoljor
- - tipi ndajfoljor pa fjalë të bashkëlidhura (korrelative)

Fjali kundrinore

- - lidhëzore
- - përemërore
- - pyetëse e zhdrejtë

Fjali përcaktore

- - dalluese
- - përshkuese
- - ndajshimorë
- - filluese

Fjali rrethanore

- - vendore
- - kohore
- - mënyrore
- - qëllimore
- - shkakore
- - rrjedhimore
- - **kushtore**
- - lejore
- - krahasore

Skema nr. 19

M. Ttoni

Klasifikimi sipas kriterit strukturor semantik

Fraza pa fjalë mbështetëse analitike

- Ftilluese
 - **dëftore**
 - **nxitëse a dëshirore**
 - **pyetëse**
 - **karakterizuese**
- Rrethanore
 - **kohore**
 - **vendore**
 - **mënyrore**
 - **sasiore**
 - **kushtëzuese**
 - **shkakore**
 - **qëllimore**
 - **rrjedhimore**
 - **kushtore**
 - **lejore**
 - **përqasore**
 - **përrjashtimore**

Fraza pa fjalë mbështetëse sintetike


Fraza me fjalë mbështetëse

- lidhëzore ftilluese
 - dëftore
 - nxitëse a dëshirore
 - pyetëse

Fraza me fjalë mbështetëse lidhëzore saktësuese

Fraza me fjalë mbështetëse lidhëzore krahasore

Fraza me fjalë mbështetëse sintetike

Skema nr. 20**Th. Dhima****Klasifikimi sipas kriterit strukturor-semantik dhe funksional**

T. Topalli mbështet klasifikimin sipas kriterit funksional dhe njeh të njëjtat periudha me fjali të nënrenditura që njihen dhe numërohen nga Sintaksa e Akademisë.

Nga të dhënat e nxjerra nga skemat e mësipërme ku janë paraqitur klasifikimet e bëra nga autorë të ndryshëm, mund të themi se, në pjesën më të madhe të rasteve fjalia e nënrenditur kushtore është pjesë përbërëse e nënndarjes së fjalive rrethimore (adverbjare), pra zë vendin e një rrethimori kushti, megjithëse ky i fundit nuk dëgjohet të përmendet si një nga gjymtyrët e dyta të fjalisë, për arsyet e përmendura në këtë punim.

Nga kjo rregullë e përgjithshme bëjnë përjashtim klasifikimet e bëra nga S. Floqi, M. Totoni dhe Th. Dhima, të cilët, si rezultat i përfshirjes në kriteret që ndjekin edhe të atij semantik krahas atij strukturor dhe funksional, arrijnë në ndarje paksa më të ndërlikuara me më tepër nëntipa periudhash me fjali të nënrenditura, por megjithatë edhe për këta autorë, fjalia e nënrenditur kushtore është pjesë përbërëse e periudhave që bashkohen me lidhëza (S. Floqi) dhe e frazave pa fjalë mbështetëse analitike rrethimore (M. Totoni), të cilin e mbështet edhe Th. Dhima me ndryshimin që njësinë sintaksore nuk e emërton frazë, por fjali e përbërë. Pozicion të ndryshëm nga sa

përmendëm më sipër zë fjalia e nënrenditur kushtore edhe te A. J. Rrota, i cili e klasifikon atë në grupin e fjalive shkajkore.

KREU III

SISTEMI HIPOTETIK I SHQIPES SI TËRËSI E MJETEVE DHE FORMAVE TË SHPREHJES SË RAPORTEVE KUSHTORE

3.1 Ç`kuptohet me sistem hipotetik

Po të zgjidhnim t`i përmbaheshim njërit prej përkufizimeve që Fjalori i Shqipes së Sotme¹⁵⁷ jep për sistemin : “Tërësi që është një unitet pjesësh a elementesh me lidhje të ngushta e me marrëdhënie të ndërsjella ndërmjet tyre”, duket se është tepër e vështirë që t`i përgjigjemi pozitivisht pyetjes, nëse rrethanori i kushtit dhe periudha me fjali të nënrenditur kushtore mjaftojnë për të formuar sistemin hipotetik të shqipes. Problemi nuk qëndron vetëm në numrin e vogël të elementeve (rrethanori i kushtit dhe fjalia e nënrenditur kushtore) që do të përfshiheshin në këtë sistem, por edhe në përgjithësimin që do t`i bëhej këtij tipi kaq specifik e kompleks. Duke i dhënë çdonjërit prej elementeve përbërës të këtij sistemi vendin që i takon sipas rëndësisë që ka, mendojmë se mund t`i afrohem ngadalë përgjigjes së duhur. Një sistem i tërë lidhjesh dhe marrëdhëniesh të elementeve përbërëse të tij siç janë mjetet dhe format e shprehjes së raporteve kushtore vihet në lëvizje nëpërmjet bashkëveprimit të pandërprerë të tyre.

Vështrimi tërësor i tyre, formalo-gramatikor, strukturor dhe funksional na bën të mendojmë se sistemi hipotetik i shqipes është tërësia e gjithë këtyre mjeteve që funksionojnë, herë vetëm dhe herë në bashkëpunim me njëri-tjetrin, duke bërë të mundur ekzistencën e tij krahas me sistemet e tjera kohore, vendore, shkakore, qëllimore etj.

Të gjitha këto forma dhe mjete, duke bashkëvepruar me njëra-tjetrën apo duke marrë përparësi sipas rastit, veprojnë të gjitha në emër të sistemit për të arritur shprehjen e raporteve kushtore. Po të analizojmë rolin e secilit në veçanti do të fillonim me lidhëzat kushtore mjaft të larmishme të cilat, siç e pamë në disa raste më sipër dhe do ta shohim edhe më tej, thjesht dhe vetëm prania e tyre në periudhë, nuk mjafton për të dalluar një fjali të nënrenditur kushtore nga një ndërtim në të cilin shprehen raporte kundërie, krahasimi, përqsajeje a filluese. Në raste të tilla merr përparësi ana kuptimore ndaj asaj strukturore. Në ndërtime të tjera siç janë ato me mënyrën lidhore në fillim të fjalisë së nënrenditur kushtore, prania e lidhëzës nuk është element i domosdoshëm për shprehjen e raporteve kushtore, sepse merr përparësi një mjet tjetër

¹⁵⁷ Fjalor i Shqipes së Sotme, Tiranë 1984, f. 1090

mjaft i rëndësishëm siç është mënyra lidhore e foljes e cila, nëpërmjet modalitetit të mundësisë, pasigurisë, supozimit, dëshirës që shpreh, ka aftësinë të dallojë kuptimin kushtor në një periudhë ku mund të ketë edhe nuanca të tjera.

Nëse mund të sjellim për analogji një konceptim të sistemit të drejtshkrimit nga A. Kostallari, do të jetë më e lehtë të kuptohet ajo që shprehëm më sipër: “Njësia bazë për drejtshkrimin, ashtu si edhe për gjuhën është fjala, - me kufijtë dhe me identitetin e saj, me lidhjet e saj të shumanshme. Është thënë me të drejtë se drejtshkrimi i fjalës është edhe jetëshkrimi i fjalës. Ashtu sikurse jeta e veçantë e çdo fjale përcaktohet, në fund të fundit, nga kategoritë e përgjithshme ku ajo bën pjesë, nga marrëdhënjet brenda një klase e nënsistemi të caktuar brenda sistemit tërësor të gjuhës, ashtu edhe ortogrami i çdo fjale, **zgjidhja e kësaj ose asaj çështjeje të veçantë drejtshkrimore përcaktohet, në fund të fundit nga tërësia e drejtshkrimit si sistem dhe nga marrëdhënjet midis hallkave të këtij sistemi.** Ky sistem, i krijuar historikisht, ndërtohet sipas disa parimeve të caktuara e udhëhiqet prej tyre. Përcaktimi i drejtë shkencor i këtyre parimeve, **i rolit të tyre në sistemin drejtshkrimor të shqipes, pra edhe i marrëdhënieve ndërmjet tyre, ka rëndësi vendimtare** për t’i vënë mbi një bazë të shëndoshë *zgjidhjet e veçanta.*”¹⁵⁸


Bashkërendimi i punës së mjeteve morfologjike e sintaksore:

- përdorimi i lidhëzave nënrenditëse dhe bashkërenditëse;
- bashkëlidhja e trajtave kohore e mënyrore të foljeve kallëzues të fjalive;
- përdorimi i formave foljore të shtjelluara dhe të pashtjelluara, të përdorura në funksion të shprehjes së lidhjes së varësisë që ekziston ndërmjet fjalisë kryesore dhe asaj të nënrenditur
- përdorimi i ndërtimeve të tjera sintaksore si:
- pranëvënia e fjalive pa pasur nevojën e një lidhëze,
- përdorimi i një gjymtyre të dytë të fjalisë siç është rrethanori i kushtit,
- gërshetimi i raporteve kushtore me raporte të tjera;
- rendi i gjymtyrëve në fjali dhe i fjalive në periudhë.

bashkëveprimi i tërësisë së këtyre elementeve duke u mbështetur mbi marrëdhëniet natyrore kusht-pasojë midis sendeve dhe dukurive të realitetit që na rrethon përforcojnë shtyllat mbi të cilat ngrihet i pasur dhe kompleks sistemi hipotetik, i cili është paraqitur prej nesh me skemën e mëposhtme:

¹⁵⁸ A. Kostallari, Gjuha e sotme letrare shqipe dhe disa problem themelore të drejtshkrimit të saj, ASHRPSH, IGJL, Tiranë 1973, f. 63

Skema nr. 20



3.2 Zhvillimi i sistemit hipotetik të shqipes

Si të gjitha pjesët e sistemit të gjuhës shqipe edhe sistemi hipotetik ka evoluar gjatë shekujve. Është pasuruar sistemi lidhëzor, janë ndërlikuar bashkëlidhjet e trajtave kohore e mënyrore të foljeve kallëzues të fjalive që përbëjnë periudhën me fjali të nënrenditur kushtore.

3.2.1 Evolucionin e lidhëzave dhe lokucioneve lidhëzore kushtore

Krahasimi për evolucionin e lidhëzave/lokucioneve lidhëzore kushtore ka përfshirë veprën e Buzukut [kemi konsultuar variantin e transkriptuar dhe me vërejte kritike nga Çabej¹⁵⁹ dhe për lidhëzat jemi mbështetur mbi artikullin e E. Lafes¹⁶⁰ për lidhëzat te vepra e Buzukut të mbledhura e të vjela shterrueshëm prej tij si edhe gramatikat në gjuhën shqipe që patëm mundësi të konsultonim, tek të cilat janë trajtuar çështje të

¹⁵⁹ E. Çabej, “Meshari” i Gjon Buzukut (1555) botim kritik, pjesa e parë dhe pjesa e dytë, Universiteti shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë e i Gjuhësisë, Tiranë 1968

¹⁶⁰ Lidhëzat te libri i parë shqip, SF 1971/4

raporteve kushtore duke filluar që nga S. Frashëri apo në punime të veçanta të cilat kanë qenë objekt i shqyrtimit edhe të çështjeve të tjera gjatë këtij punimi.

Por gjithashtu pas skedimit të shembujve të periudhave të bashkuara me lloje të ndryshme të lidhëzave kushtore dhe lokucioneve lidhëzore kushtore janë dhënë përfundime në lidhje me ndryshimin e numrit apo formave alternative të tyre, të cilat, edhe pse janë të tilla, meqenëse në disa raste imponojnë edhe ndryshime të mjeteve morfologjike të shprehjes së raporteve kushtore në fjali apo në periudhë, janë numëruar më vete.

Në artikullin me mjaft vlerë të E. Lafes, nëpërmjet njohjes së mënyrës se “*si paraqitet* kjo pjesë e ligjëratës te libri i Buzukut ka për qëllim të kuptohet më mirë se nga ç`bazë është nisur dhe si është zhvilluar ai sistem i pasur e i zhdërvjellët i mjeteve gjuhësore që ka *gjuha e sotme letrare*.”¹⁶¹ numërohen lidhëzat dhe lokucionet lidhëzore kushtore që Buzuku ka përdorur në librin e parë shqip dhe autori i këtij artikulli studimos merr përsipër të shprehë edhe konstatimin e vet në lidhje me përqendrimin e peshës së shprehjes së raporteve kushtore në periudhën me fjali të nënrenditur kushtore vetëm tek 4 mjetet lidhëse: lidhëza kushtore **në** dhe lokucionet lidhëzore kushtore **në kloftë qi, në kloftë se** (të përdorura nga një herë) e **se...në (se në)** (i përdorur katër herë) tek Buzuku.¹⁶²

Buzuku

Lidhëza kushtore

Në, se... në

Lokucione lidhëzore kushtore

Në kloftë qi, në kloftë se

Statistikat e nxjerra nga E. Lafe në artikullin e tij për lidhëzat kushtore dhe lokucionet lidhëzore kushtore për të cilat interesohemi, tregojnë se lidhëza kushtore **në** është një ndër lidhëzat me dendurinë më të lartë nga lidhëzat që ka përdorur Buzuku. Gjithashtu me mjaft interes për të bërë krahasimin janë të dhënat për shpeshësinë e përdorimit të kësaj lidhëze me kohët e foljeve kallëzues në mënyrën dëftore dhe në mënyrën dëshirore ku mënyra dëshirore merr përparësi në lidhjen që vendos me lidhëzën kushtore **në** në periudhat me fjali të nënrenditura kushtore.

¹⁶¹ Lidhëzat te libri i parë shqip, E. Lafe, SF 1971/4, f. 101-102

¹⁶² Po aty, f. 136

Po t'i referohemi emërtimit të lidhëzave duhet thënë se jo gjithmonë ka qenë e njëjta terminologji. P. sh. S. Frashëri në kreun e nëntë me titull Lidhjet¹⁶³, përmend 3 lidhëza kushtore, pikërisht

në(ndë), të, po qe

nga të cilat veçon lidhëzën **në** për ta dalluar nga parafjala **në**. “Fjala **në** është lidhje kur themi: **Në** daç eja; Do të vete **në** më thirçinë; dhe është përparje kur themi: Vete **në** pshatt; Rri **në** *shtëpi*.”

A. M. Xanoni shprehet kështu për lidhëzat: “Janë me qyshke

n`, ne, kuer

ato qi bashkojnë propozicione ndër t`cillat njeni sosh ngërthen qyshken ku a pshtetë t`dalunit e ndoi sendit qi diftohet prej propozicionit tietër b. f.: Na kaa dhanë Zoti fialën me nai i ndiguiue lutat: **ne ja bâishim si duhet**.”¹⁶⁴

G. Mikeli¹⁶⁵, megjithëse në tekstin e vet flet më tepër për fonetikën dhe morfologjinë, në kapitullin për sintaksën përmend lidhëzat:

n`, e, ndryshej, no

M. Lambertz¹⁶⁶ numëron këto lidhëza e lokucione lidhëzore:

ndë, për në, ndë qoftë se, ndë qoftë që, ndë se, ndë që, andë, po, po që, pokka, kur, sikur, sikur në, si, masi, kah, ku, nekë, kish

Te I. D. Sheperi¹⁶⁷ gjejmë të përmendura lidhëzat:

¹⁶³ S. Frashëri, Shkronjëtoe e gjuhësë shqip, ASHSH Instituti i Historisë, Tiranë 1988, Vepra 5, f.170

¹⁶⁴ S. J. Xanoni, vep. cit., f. 160

¹⁶⁵ G. Mikeli, vep. cit., f. 123

¹⁶⁶ M. Lambertz, vep. cit. f. 15-175

në, po, të

dhe lokucionet:

në se, në është se, në qoftë se, po të, sikur të

A. J. Rrota në “Syntaksa e gjuhës shqipe”¹⁶⁸ mjetet lidhëse që shërbejnë për të bashkuar fjalinë kushtore me kryefjalinë i quan fjalza dhe numëron si të tilla:

**në, në mos, n`është se, në qoftë se, në qe se,
po qe se, bane e, sikur të**

K. Cipo¹⁶⁹ në sintaksën e vet, pasi jep përkufizimin e fjalisë kushtore fillon të flasë për lidhëzat me anë të të cilave bashkohen fjalitë në periudhë, por pa i numëruar ato njëri pas tjetrit. Paralelisht me secilën lidhëz që prezanton, jep edhe formën foljore me të cilën gjendet e shoqëruar lidhëza përkatëse në fjali. Si lidhëza kushtore gjejmë te ky autor:

**në qoftë se, në rast se, në,
po, po qe se, po të,
të, sikur, sikur të**

¹⁶⁷ I. D. Sheperi, vep. cit. §585 a)-ç), f. 176

¹⁶⁸ A. J. Rrota, Syntaksa e gjuhës shqipe për klasën II, III, IV të shkollave të mesme, Shkodër, Shtypshkronja A. Gj. Fishta 1943, f. 85

¹⁶⁹ K. Cipo, Sintaksa, Tiranë 1952, f. 95

M. Domi në gramatikën e vitit 1955¹⁷⁰ dhe në atë të vitit 1971¹⁷¹ numëron lidhëzat nënrenditëse:

**në qoftë se, në qoftë që, në është se (që), nëse, në,(në veri për në),
po, po që, po qe se, po qe që, sikur të, kur, si**

dhe në f. 244 në një nga shënimet ai shprehet se fjalia kushtore mund të gjendet edhe me shprehje që kanë të njëjtën vlerë me lidhëzat nënrenditëse kushtore dhe si të tilla jep:

me kusht që, në rast se, bane e

A. Xhuvani¹⁷² i ndan lidhëzat në të thjeshta dhe të përngjitura dhe numëron:

po, në, sikur, në qoftë se, po qe se

S. Prifti në tekstin e sintaksës të botuar në Prishtinë¹⁷³ numëron këto lidhëza kushtore: lidhëzën **në** dhe lidhëzat që ndërtohen në bazë të saj:

në qoftë se, në qoftë që, në është se, në është që

lidhëzën **po** dhe ato që ndërtohen në bazë të saj:

po qe, po qe se, po qe që, (po të jetë që)

¹⁷⁰ M. Domi, Gramatika e gjuhës shqipe, pjesa II, Tekst për shkollën 7-vjeçare, Tiranë 1955, f. 240

¹⁷¹ M. Domi, Sintaksa e gjuhës shqipe, Prishtinë 1971, f. 112

¹⁷² A. Xhuvani, Libri i gjuhës shqipe për klasët e nalta të Filllores e të parat e Qytetses, pj.II, Tiranë 1942

¹⁷³ S. Prifti, Sintaksa e gjuhës shqipe, Mars 1971, Prishtinë, f. 390

lidhëzën sikur,

shprehjen në rast se, në rast që, lidhëzën kohore kur ose si.

E. Guinard në trajtimin që i bën fjalisë së varur kushtore, siç e quan ai, numëron këto lidhëza nënrenditëse kushtore:

**të, të mos, po, po të, po të mos, po qe se,
në, në rast se, në qoftë se,
sikur, sikur të, sikur të mos,
me kusht që, kur**

Në kreun që flet për periudhën me fjali të varur kushtore në gramatikën e Akademisë¹⁷⁴ numërohen këto lidhëza a lokucione lidhëzore kushtore:

**në, në qoftë se, në se, në është se, në rast se,
po, po qe se, po qe që, po të jetë se,
sikur, me kusht që, me konditë që, mjafton që, kur**

M. Ttoni numëron këto lidhëza (jo lokucione lidhëzore):

lidhëza me kuptim të diferencuar

lidhëza me kuptim të padiferencuar

**Sikur, zero, po, në, me kusht
që, me konditë që, mjaft që**

**Në qoftë se, nëse, në është se, po qe
se, po të jetë se, në rast se, kur**

¹⁷⁴ Gramatika e gjuhës shqipe II, Sintaksa, ASHRSH IGJL, Tiranë 1997, Kreu XXXVI, 582

Një mjet tjetër i shprehjes së raporteve sintaksore që vepron njëkohësisht me intonacionin, është pranëvënia: vendosja njëra pranë tjetrës e njësive përkatëse sintaksore, e gjymtyrëve të një fare në fjali dhe e fjalive të bashkuara pa lidhëza në periudhë. Pranëvënia është një formë e veçantë e topikës, e rendit të njësive sintaksore. Roli i topikës është i dukshëm në radhë të parë atëherë kur s`ka asnjë mjet tjetër të shprehjes së raporteve sintaksore, si në lidhjen e një ndajfoljeje me një fjalë tjetër të plotkuptimshme. Në lidhjen e fjalive bashkëveprojnë, në më të shumtën e rasteve, mjetet lidhëse ose pranëvënia dhe intonacioni. Lokucionet parafjalore dhe lidhëzore pasurohen gjithnjë.

Kurse lokucionin po të ish se i cili ka vlerën e një lokucioni lidhëzor kushtor po ky autor e shpjegon si pikënisje të një fjalie të varur kushtore të ndjekur nga lidhëza se dhe një fjali kryefjalore pasuese.

Në gjuhën shqipe numri i madh i lidhëzave vihet re më tepër gjatë mbledhjes dhe përpunimit të materialit praktik ku gjejmë lidhëza dhe lokucione të pandeshura më parë nga studimi i shembujve të sjellë nga autorë studimesh të ndryshme që kanë folur për fjalitë e nënrenditura kushtore, por edhe në raport me lidhëzat e sjella nga E.Lafe¹⁷⁵.

Shembujt e mbledhur me variantin **ndë** të lidhëzës kushtore **në** e gjejnë shpjegimin e përdorimit të kësaj lidhëze alternative si rezultat i ndikimit të latinishtes, që ishte gjuha më e përdorur në kohën kur kanë shkruar sidomos autorët e vjetër të gjuhës shqipe. Këtë evoluim të grupit nd në n e shpjegon qartë K. Topalli në monografinë e tij “Sonantet e gjuhës shqipe” ku në lidhje me këtë çështje shprehet: “*Me anë të huazimeve latine mund të konstatohet edhe diçka tjetër, lidhur me fazat e zhvillimit. Fjalët që në latinishte kanë pasur një /n/ dyfishë, si gunna, cannētum, Johannes etj., duke hyrë në gjuhën shqipe kanë dhënë po atë rezultat, domethënë një /n/ të thjeshtë të parotacizuar, sikurse fjalët e trashëguara që kanë pasur grupet bashkëtingëllore /nt/, /nd/; khs. gunë, kënetë, Gjon me punë, unazë, dhen. Rezultatet e njëjta dëshmojnë se në një fazë të caktuar të zhvillimit të tyre të dy këto grupe fjalësh kishin rënë në emërues të përbashkët, domethënë faza /nn/ e fjalëve të trashëguara me /nt/, /nd/ ishte arritur që në periudhën latine.*”¹⁷⁶

Kurse për sa i përket qiellëzorizimit të grupit të bashkëtingëlloreve /kj/ të pranishme në lokucionet lidhëzore kushtore **në kje se, po kje se, në kjoftë se, në kjoftë që**, të gjetura në disa raste të rralla e të përdorura si shembuj në analizën e periudhave me fjali kushtore të ndërtuara me këto lokucione lidhëzore, mund të mbështetemi tek arsyetimet e shpjegimet që jep K. Topalli në monografinë tjetër të tij “Mbylltoret e gjuhës shqipe”, ku shprehet: “Në format e së pakryerës problemi paraqitet më i ndërlikuar, meqenëse mbaresa e e vetës së dytë, që përbëhet nga një zanore qiellzore, nuk ka qenë shkak për këtë dukuri [shndërrimin kj në q], sepse ndërrimi

¹⁷⁵ E. Lafe, “Lidhëzat te libri i parë shqip”, SF 1971/4, f. 136

¹⁷⁶ K. Topalli, Sonantet e gjuhës shqipe, ASHRSH, IGJL, Tiranë, 2001, f. 105-106

/e/>/i/, që ka shoqëruar këtë proces, silurse dëshmojnë materialet dialektore, ka nisur në vetën e tretë njëjës e shumës e pastaj prej këndeje është shtrirë edhe në trajtat e tjera vetore.¹⁷⁷ Ky shpjegim është i vlefshëm për dy lokucionet lidhëzore kushtore që e kanë foljen në përbërje të tyre në kohën e pakryer të mënyrës dëftore, por gjithashtu, si rezultat i mbylljes së arsytimit që më pas kjo analogji është shtrirë edhe trajtat e tjera vetore “e më vonë në gjithë paradigmen”¹⁷⁸ na vjen në ndihmë për të gjykuar së e njëjta dukuri është shtrirë edhe në dy lokucionet lidhëzore kushtore që e kanë foljen në përbërje të tyre në kohën e tashme të mënyrës dëshirore.

Për fjalinë kushtore dhe llojet e lidhëzave është shprehur shkurt edhe H. Pedersen në “*Studime për gjuhën shqipe*”, në rubrikën “*Shënime paraprake*” në §16. Sintaksa pika 9. Fjali të varme shprehet: “...Edhe një fjali kushtore mund të bahet pa një lidhëzë, por vetëm në rasën e dytë të një dileme: **nε** datš te vitš, eja; nuk do, mos vjen; **nε** špetofša dot, špetova; nukε špetova, le te pεsoj IV; **nε** e thetša, e sjel; s`e theta, premε kókεnε. ... Një variacion tjetër në shprehjen kushtore: **nε** daltε vεrtε fjala e dervišit edé te bime djlem; **po** erđi buři nga kurbeti è mos te θεnε pulεnε. Lidhëza kushtore janë: **ku**, **nε**, **po**, **sikúr te**, por edhe **mos**.”¹⁷⁹

¹⁷⁷ K. Topalli, Mbylltoret e gjuhës shqipe, ASHRSH, IGJL, Tiranë, 2002, f. 132

¹⁷⁸ Po ai, po aty

¹⁷⁹ Pedersen. H., Studime për gjuhën shqipe, ASHAK, Botime të veçanta XLVIII, Seksioni i gjuhësisëdhe i letërsisë, Prishtinë 2003, f. 172

Autori Lidhëza	Buzuku	Frashëri	Xanoni	Mikeli	Lambertz	Sheperi	Rrota	Cipo	Domi	Xhuvani	Prifti	Guinard	A. Shkenc.	Totoni
në	+	+				+	+	+	+	+	+	+	+	+
n`ne			+											
n`no				+										
ndë					+									
se...në	+													
për në					+				+					
në mos							+							
ndë të		+												
ndë se					+									
në është se						+								
n`është se							+							
në është se									+		+		+	+
ndë që					+									
në është që									+		+			
në se						+								
në qe se							+							
nëse									+				+	+
në kloftë	+													

se														
ndë qoftë se					+									
në qoftë se						+	+	+	+	+	+	+	+	+
në kloftë qi	+													
ndë qoftë që					+				+		+			
në rast se								+	+		+	+	+	+
në rast që											+			
po					+	+	+	+	+	+	+	+	+	+
po qe		+									+			
po që					+				+					
pokka					+									
po të						+		+						
po të (mos)												+		
po qe se								+	+	+	+	+	+	+
po qe që									+		+		+	
po të jetë që											+			
sikur					+				+		+	+	+	+

sikur të					+	+	+	+	+			+		
sikur të mos												+		
të						+						+		
të mos													+	
me kusht që									+			+	+	+
me konditë që													+	+
mjaft që													+	+
kuer			+											
kur					+				+		+	+	+	+
si					+				+		+			
masi					+									
e				+										
bane e							+		+					
andë					+									
ndryshej					+									
kah					+									
nekë					+									
kish					+									

Pasqyrimi skematik i shpërndarjes së lidhëzave e lokucioneve lidhëzore kushtore

Tabela nr. 4.

Nga vëzhgimi i këtyre lidhëzave dhe lokucioneve lidhëzore kushtore vihet re që që nga mbi 50 të tilla të numëruara [ndonjëherë thjesht të cituara edhe pa shembuj konkretë] nga 13 autorë gramatikash apo punimesh të veçanta dhe nga sintaksa e Akademisë e hartuar nga grup autorësh, vihet re përfshirja në to edhe e njëjës së lidhore **të** apo edhe e disa formave jo të mirëfillta lidhëzore, ndajfolje apo forma dialektore të “sajuara” si lidhëza: (**të mos, bane e, pokka, kah, nekë**), apo edhe e pakryera e foljes kam, që Lambertz e sjell me emërtimin “i ashtuquajturi **kish**” në shembuj të shoqëruar me të pakryerën e foljes në mënyrën lidhore në ndërtime kushtore.

Shpërndarja e tyre është pasqyruar në tabelën e mësipërme (nr. 4) nga mund të nxirren këto të dhëna: lidhëza kushtore **në**, sikurse edhe në gjuhën e sotme është më e përhapura. Ajo ndeshet me variantet e saj dialektore **n`**, **ne**, **ndë**, të cilat shoqërohen ose jo me ndryshime në trajtat kohore e mënyrore të foljeve kallëzues me të cilat vendosin lidhje. Pas saj renditet lokucioni lidhëzor kushtor **në qoftë se**, i cili, me përjashtim të dy rasteve në variantin dialektor që ka prekur një herë lidhëzën në duke dhënë: **ndë qoftë se** te Lambertzi dhe një herë dëshiroren e foljes jam që është pjesë përbërëse e lokucionit, duke dhënë formën e sjellë nga Buzuku: **në kloftë se/që**, në rastet e tjeradel me formën që njihet e përdoret edhe sot. Pas këtij lokucioni renditet lidhëza kushtore **po** e shoqëruar ose jo nga nga nyja të që ndërton mënyrën lidhore apo nga pjesëza mohuese mos dhe pas kësaj lidhëze renditet lokucioni lidhëzor kushtor **po qe se**.

Me një shpërndarje pa shumë diferencë nga njëra tjetra takohen lidhëzat **kur, si** dhe lidhëza **sikur** që shoqërohet ndonjëherë nga nyja të e mënyrës lidhore. Në të njëjtën masë përdorimi gjejmë edhe lokucionet lidhëzore: në është se në dy variantet dialektore **në është se** te Sheperi dhe **në është se** te Rrota, përkatësisht **në rast se, me kusht që** dhe **po të jetë se/që**.

Lokucioni lidhëzor **me konditë që** dhe **mjaft që**, të cilët janë relativisht më të rinj ndeshen më rrallë. Vetëm në dy autorë (M. Domi dhe A. J. Rrota) takohet ndërtimi **bane e** dhe vetëm nga Lambertzi njihen si mjete lidhëse disa ndajfolje mënyre (ndryshej) vendi (kah) etj.

3.2.2 Bashkëlidhja e trajtave kohore e mënyrore të foljeve kallëzues në fjalitë e periudhës me fjali të nënrenditur kushtore

Bashkëlidhja kohore dhe mënyrore e foljeve të fjalive kryesore dhe asaj të nënrenditur të periudhës me fjali kushtore është e shpërndarë sipas llojeve të lidhëzave me të cilat bashkohen fjalitë ndërmjet tyre, sepse secila prej lidhëzave a lokucioneve lidhëzore, sipas veçorisë së ndërtimit dhe sferës së përdorimit, e kërkon foljen e fjalisë së

nënrenditur në atë mënyrë që përshtatet me modalitetin që shpreh dhe në një nga kohët e mënyrës përkatëse dhe sigurisht në bashkëlidhje me foljen e fjalisë drejtuese.

P. sh. periudhat me fjali të nënrenditur kushtore me lidhëzën **në** të ndërtuara me mënyrën dëftore janë më të rralla se ato që ndërtohen me dëshiroren. Mënyra dëshirore kërkohet nga lidhëza **në** duke e bërë këtë lidhëz jo vetëm të dallohet nga të tjerat, por edhe ndërtimet me të i bëjnë tepër të veçanta e karakteristike vetëm për këtë lidhëz kushtore.

Me mënyrën dëftore lidhëza **në** po përdoret më tepër si lidhëz ffilluese në periudhat me fjali të nënrenditur ffilluese kryefjalore e kundrinore.

Për periudhat me fjali të nënrenditur kushtore me lidhëzat **në qoftë se, nëse, në është se, në rast se**, bashkëlidhja kohore e mënyrë e foljeve kallëzues të fjalive të periudhës është e njëjtë: në fjalinë e nënrenditur kushtore folja vendoset në të gjitha kohët e mënyrës dëftore dhe në mënyrën kushtore, kurse në fjalinë kryesore folja është, përgjithësisht në kohën e tashme ose në të kryerën e mënyrës kushtore.

Në periudhat me fjali të nënrenditur kushtore me lidhëzën **po** dhe me lidhëzën kohore **si** që zëvendësohet natyrshëm me të parën, folja e fjalisë së nënrenditur mund të jetë në mënyrat: dëftore, lidhore dhe rrallë edhe në lidhore-habitore. Kur në fjalinë e nënrenditur folja është në mënyrën dëftore në kohën e kryer të thjeshtë ose të kryer të tejshkuar, në fjalinë drejtuese, folja vihet në çdo mënyrë, veç mënyrës kushtore.

Në mënyrën lidhore folja e fjalisë së nënrenditur kushtore mund të vendoset në të gjitha kohët e saj. Kur në fjalinë e nënrenditur folja është në të tashmen e mënyrës lidhore, në fjalinë drejtuese folja është në mënyrën dëftore në kohën e tashme ose në të ardhmen, ose në mënyrën urdhërore. Kur në fjalinë e nënrenditur folja është në të pakryerën e lidhore, folja e fjalisë drejtuese, në shumicën e rasteve, është në mënyrën kushtore ose në të pakryerën e dëftores kur tregon veprim të përsëritur. Në mënyrën kushtore folja e fjalisë drejtuese mund të jetë edhe kur folja e fjalisë së nënrenditur është në kohën e kryer të mënyrës lidhore ose në lidhore-habitore.

Në periudhat me fjali të nënrenditur me lidhëzën **po qe se** folja e fjalisë së nënrenditur kushtore është, përgjithësisht, në mënyrën dëftore dhe rrallëherë mund të jetë edhe në mënyrën kushtore. Kur në fjalinë e nënrenditur kemi dëftoren, në fjalinë drejtuese kemi gjithashtu mënyrën dëftore ose urdhërore dhe kur në të nënrenditurën kemi kushtoren, edhe në kryesoren kemi mënyrën kushtore.

Ndërtimet me fjali të nënrenditura të bashkuara me drejtuesen me lidhëzat **po të jetë se, po të jetë që** i kanë foljet e fjalive të nënrenditura dhe kryesore në mënyrën dëftore.

...**po të jetë se** i epet ndonji Mretniës së tjetrës, ndonji copë ose mandata e sajë, atëherë dhe neve do të kërkojmë interesat t'ona në veri të Shqipniës. Bisedimet e Këshillit Kombtar "Senat", Legjislatur` e parë, 1920, Tiranë, shtypur në shtyp "Mbrothësija", Kristo P. Luarasi 1923, f. 28

Z. Qazim Koculi tha se **po të jetë qi** Qeverija e shëf me nevojë për një komision të jashtëzakonshëm (extra), atëherë, si tha dhe Hysen Bej Vrijoni, jemi gati me i dhënë qeverijës 1-2 e sa të shofi me nevojë për bashkpunimin mbi këtë çështje. Po aty, f. 20

Z. Kryetari mbi këtë propozim tha se, **po të jetë qi** neve i ulim rrogat, atëherë do t'i mbyllet dera njerëzve të vorfun qi mund të zgjidhen këshilltar të Kombit... Po aty, f. 33

Në periudhat me fjali të nënrenditur të bashkuara me lidhëzën **sikur**, folja e fjalisë së nënrenditur mund të jetë në të tashmen dhe në të kryerën e lidhore dhe bashkëlidhet me foljen e fjalisë drejtuese që vendoset në të ardhmen e dëftores, ose mund ta kenë foljen e fjalisë së nënrenditur në të pakryerën ose në më se të kryerën e lidhore ose në lidhore-habitore, foljen e fjalisë drejtuese e kanë në mënyrën kushtore.

Bashkëlidhja në periudhat me nënrenditje me lidhëzat **me kusht që** dhe **mjaft që** realizohet ndërmjet foljeve kallëzues në mënyrën lidhore.

Bashkëlidhja kohore e foljeve të fjalive me nënrenditje kushtore që bashkohen me lidhëzën kohore **kur** nuk është e njëjtë me atë të fjalive të periudhës me nënrenditje kohore.

Folja e fjalisë së nënrenditur kushtore vendoset në kohën e tashme ose të ardhme të mënyrës dëftore ose në të tashmen e mënyrës lidhore dhe përgjegjësja e saj në fjalinë drejtuese mund të jetë në të tashmen ose të ardhmen e mënyrës dëftore.

Periudhat me fjali të nënrenditura kushtore jolidhëzore i kanë foljet e fjalive të nënrenditura dhe drejtuese përkatësisht në mënyrën lidhore në të gjitha kohët e saj, por sidomos në të pakryerën dhe në më se të kryerën e saj dhe drejtuesja në mënyrën kushtore dhe dëftore.

Në ndërtimet me forma të pashtjelluara folja e fjalisë drejtuese e cila është mjaft e rëndësishme për të shprehur marrëdhëniet kushtore (për shkak të mungesës së lidhëzës dhe të modalitetit të formës së pashtjelluar) mund të jetë në mënyrën dëftore dhe kushtore, mënyra këto që e japin më të qartë kuptimin kushtor.

Këto ishin disa përgjithësime teorike mbi lidhëzat e lokucionet lidhëzore dhe mënyrën se si bashkëveprojnë ato me bashkëlidhjen kohore e mënyrore të foljeve kallëzues të fjalive të nënrenditur dhe asaj drejtuese brenda periudhës me fjali të nënrenditur kushtore. Të gjitha këto janë parë se si janë zbatuar në shembujt e vjelë nga materiali praktik, por gjithashtu janë pasuruar edhe me shembuj nga raste të veçanta, qoftë të lidhëzave a lokucioneve lidhëzore që shërbejnë për të bashkuar fjalitë në periudhë, qoftë edhe me bashkëlidhje kohore e mënyrore të ndryshme nga ato që përmendëm më sipër duke e shoqëruar çdo rast me komente të mbështetura mbi baza gramatikore.

3.3 Standardi dhe veçori dialektore në sistemin hipotetik të shqipes

Duket se disa mjete të shprehjes së raporteve kushtore nuk kanë ndryshuar dhe as i kanë humbur funksionet e tyre. Të tilla mund të numërojmë sidomos disa nga ato që shprehin raportet kushtore në nivelin e fjalisë, ta cilat do të trajtohen në mënyrë specifike më poshtë në punim si edhe në nënçështjet e tyre. Zbulimin e njërit prej mjeteve të shprehjes së raporteve kushtore në fjali, pikërisht paskajoren gege, S. Riza në një nga veprat e tij ia atribuon Kostandin Kristoforidhit [K. Kristoforidhi Grammatiki tis Albanikis Glossis (1882)], për të cilin shprehet: “Ndërsa paraardhësit e tij patnë qenë mjaft të lëkundshëm në këtë mes, Kristoforidhi njohu katërcipërisht egzistencën në gegërishte të një paskajoreje (makar jo sintetike, por funksionalisht) **të mirëfilltë** si për kohën e tashme p. sh. “*me kërkue*”, *ashtu për të partashmen “me pasë kërkue” (fq. 123)*”¹⁸⁰, duke dhënë edhe shpjegime për rastet e përdorimit të kësaj forme të pashtjelluar foljore: “*Por paskajorja e partashme e gegërishtes mund të përdoret vetëm me pjesëzën me dhe vetëm me kuptim, qoftë thjeshtë kushtor ...qoftë kushtor krahasor...*”¹⁸¹

Për të kuptuar veçoritë dialektore të sistemit hipotetik në raport me gjuhën standarde kemi mbajtur parasysh këto çështje që lidhen me mjetet e shprehjes së raporteve kushtore:

- Mjetet lidhëse, kryesisht lidhëzat në variantet dialektore, trajtat fonetike, mënyra e ndërtimit të tyre;
- Korrelacioni kohor i trajtave dhe formave të foljeve kallëzues
- Bashkimi i fjalive në periudhë ose me mënyrën lidhore, ose me formën e pashtjelluar foljore-paskajoren gege;
- Denduria e përdorimit të mjeteve lidhëse, në dialektin geg përdoret më shumë lidhëza kohore **si** dhe paskajorja gege, herë në vend të lidhores, herë në vend të paskajores.

Në tërësinë e mjeteve lidhëse të fjalive në periudhën me fjali të nënrenditur kushtore duket se lidhëzat: **në, nëse, po, sikur** dhe me lokucionet lidhëzore: **në qoftë se, në rast se, me kusht që, etj** janë karakteristike për gjuhën standarde, kurse lidhëzat kohore kur dhe si (të përdorura si kushtore) dhe lokucionet e tjera lidhëzore kushtore (përfshi këtu edhe po qe se, që më përpara përdorej kryesisht në gegërisht) të ndërtuara me lidhëzën **që**, në vend të **se: në qoftë që, po qe që, po të jetë që**, etj. kanë përdorim mjaft më të rrallë se ato që janë të gjuhës standarde. Me këto lidhëza a lokucione lidhëzore të prekura nga ndikimet dialektore, trajtat kohore e mënyrore të foljeve kallëzues të fjalive në këto periudha gjenden gjithashtu nën ndikimin e dialekteve, megjithëse kjo nuk prek dukshëm bashkëlidhjen e këtyre trajtave në funksion të shprehjes së raporteve kusht-pasojë.

¹⁸⁰ S. Riza, Vepra të zgjedhura, ASHRSH, IGJL, Tiranë 2009, f. 395

¹⁸¹ Po ai, po aty

3.3.1 Mjetet e shprehjes së raporteve kushtore të prekura më tepër nga dallimet dialektore

Dukuria sintaksore më e qartë që dallon dy dialektet e shqipes është ndërtimi me paskajore në dialektin e veriut dhe mungesa e tij në dialektin e jugut, siç shprehet M. Totoni në një punim ku trajton disa çështje të studimit të sintaksës dialektore.¹⁸²

Forma e folur me të cilën e gjejmë të përdorur dialektin dhe sforcimi për ta pasqyruar në formën e shkruar, natyrisht që vë në dukje disa veçori të tilla si përdorimin më të kufizuar të mjeteve lidhëse, duke i dhënë rëndësi më të madhe intonacionit, si një nga mjetet e tjera më pak, po jo të parëndësishme për shprehjen e raporteve kushtore.

Duke u nisur kryesisht nga ky fakt, mund të thuhet se kjo bën që periudhat me fjali të nënrenditura kushtore në tekstet dialektore të bashkohen ndërmjet tyre më shumë asindetikisht, sesa me anët të lidhëzave të nënrenditura kushtore, sidomos me anë të paskajores geqe që në këto ndërtime zëvendëson mënyrën lidhore:

Lidhëzat në fjali shprehin raporte barazie, ndryshe nga parafjalët që shprehin vetëm raporte varësie, kurse në periudhë lidhëzat përdoren si për raportet e varësisë, si për ato të barazisë. Ato, si gjithë fjalët shërbyese, nuk kanë kuptim leksikor të pavarur, prandaj nuk mund të jenë as gjymtyrë fjalie. Kuptimin leksikor të lidhëzave e përbëjnë marrëdhëniet e ndryshme semantiko-sintaksore që shprehin ato dhe që konkretizohen në fjali e në periudha të caktuara. Nga pikëpamja e kuptimit lidhëzat ndahen në dy grupe: lidhëza semantike dhe josemantike.¹⁸³

Lidhëzat nënrenditëse kushtore për të cilat do të bëhet fjalë gjatë punimit tonë bëjnë pjesë në grupin e lidhëzave semantike, të cilat, përveç marrëdhënieve sintaksore të nënrenditjes, shprehin edhe marrëdhënie të caktuara kuptimore ndërmjet fjalive që lidhin.

Sikur të mblidhshin xhithë mizat mjaltë, do të baheshe ni pare oka, Moravë e Erpërme, Kosovë, Fjalë të urta, 454

Sikur mos t'i kishem duerët e lidhuna mbrapa aq fort me tel, që më shaktonte dhimbje të madhe, un do të kishem qeshë me të madhe për shka shkruhej në atë procesverbal. At Zef Pllumi, Rrno vetëm për me tregue, f. 92

Në këtë ndërtim shfaqen disa çështje të sintaksës dialektore. Njëra nga çështjet ka të bëjë me rendin e gjymtyrëve në fjalinë e nënrenditur. Rendi i zakonshëm i pjesëzës mohuese në raport me kallëzuesin në mënyrën lidhore është vendosja ndërmjet

¹⁸² M. Totoni Çështje të studimit të sintaksës dialektore, SF 1978/4, f. 89-90

¹⁸³ Gramatika e gjuhës shqipe I, Morfologjia, ASHRSH IGJL, Tiranë 1995, Kreu X, f. 398

pjesëzës të që ndërton mënyrën lidhore dhe foljes kallëzues, ndërkohë që në këtë ndërtim ajo është vendosur para pjesëzës të të mënyrës lidhore. Çështja tjetër ka të bëjë me përdorimin në rasën jo të duhur të mbiemrit në funksionin e përcaktorit kallëzuesor të kundrinorit. I vendosur pandërmjetshëm pas emrit, ky mbiemër, me nyjën që është përdorur në këtë fjali të nënrenditur duket sikur është përcaktor me përshtatje, por lidhja e dyfishtë: e drejtpërdrejtë me kallëzuesin dhe e tërthortë me kundrinorin e drejtë, pavarësisht pranisë së nyjës, dëshmon që është në funksionin e përcaktorit kallëzuesor të kundrinorit dhe duhet të përdoret me nyjën të: (krhs: **Sikur** të mos i kisha duart të lidhura mbrapa aq fort me tel...) (për mënyrën dialektore të ndërtimit të kohës së pakryer të mënyrës lidhore, por edhe të së tashmes së kushtores).

Disa nga variantet fonetike të lidhëzave apo lokucioneve nënrenditëse kushtore i kemi sjellë nëpërmjet shembujve të mëposhtëm:

Gjalprit ke t`i biesh ndë kryet, **ndë** do t`e vrash. Kalabri, Itali, Fj. të urta, f. 80

Un, **me e dijtë** se ma jep çikën, e pres deri të bahet për martesë, se kjo tek asht afriu. At Zef Pllumi, Rrno për me tregue, f. 363

Vocri iu kish përgjegjë se, **me ia shprazë** treqind pushkë mbi krye të kaut të kularit, nuk e tund veshin, ndërsa uku në mal struket kur e ndien një krismë. A. Z. Pllumi, Rrno vetëm për me tregue, f. 377

Flamuri kombtar nuk ka shka bân nder né./ **Po kje se** dashtuni nuk kem` p`r Atdhé! Gj. Fishta, mrizi i Zanavet f. 108

Gruaja është e bukur **kur** është e bukur fizikisht dhe **kur** është e pasur shpirtërisht. R. Qosja, Vdekja më vjen prej syve të tillë, f. 46

Si do ta ndjejë shqiptari i Pejës se është nga një komb me shqiptarin e Filatit, **kur** të mos jetë një gjuhë e përbashkme në mes tyre? F. Konica, Ç` është liria, f. 42

Shqiptari, **kur** ta shenon, s`i pshton. Kosovë Fjalë të urta, f. 45

Kur të zë dielli pa larë, nuk të vete mbarë. Vlorë, Fjalë të urta, f. 164

Kur të jetë nevoja, të vritet, jo për fare gjë por për atdhenë. F. Konica, Vepra, f. 100

Kur s`e shita dot për dy javë që kam qenë i lirë, si do ta shes tani që lëviz vetëm natën? I. Kadare, Prilli i thyer, f. 173

Kur nuk ka kuleta, shkon e zezë jeta. Jug, Fjalë të urta, f. 892

Kur s`merr nga ditët e mia, rrofsh një mijë vjet. Kuç-Vlorë, Fjalë të urta, f. 963

Nuk mund tham me siguri se sa zgjati ky operacion i tmerrshëm, ndoshta një orë. Por, **në pastë kenë** një ore, atëherë mendoj se kje ora mâ e gjatë e gjithë jetës sime. A. Z. Pllumi, Rrno për me tregue, f. 102

Pater, por **në** daç mos me e vra ndërgjegjen e ktij populli që të don aq shumë e **në** daç me u da me nderë prej këndeje, shiti këta mullarë sane që ke, përndryshej ka me t`u dashtë me ikë se me ikë, pse ata horrat kanë me të gjuejtë me gurë. A. Z. Pllumi, Rrno... f. 435

Vëmë re këtu ndërthurjen e disave prej mjeteve të shprehjes së raporteve kushtore me ngjyrim dialektor. Strukturave paralele të periudhave që fillojnë me fjali të nënrenditura kushtore homogjene me lidhëzën nënrenditëse kushtorë **në**, që i përgjigjen fjalisë kryesore me foljen kallëzues në mënyrën urdhërore u shtohet edhe shprehja e raporteve kushtore me ndajfoljen përndryshej në formën dialektore e cila psohet nga forma dialektore e së ardhmes së mënyrës dëftore (ka me t`u dashtë përkundrejt do të të duhet)

... por tash e mbrapa edhe do të punojnë **për në** daçin me jetue, se nuk i len mâ kush me shfrytëzue tjerët. A. Z. Pllumi Rrno... f. 458

Në ndonjë rast lokucioni lidhëzor ndërpritet nga ndonjë ndajfolje mënyre p.sh.:

Për n`kje imend se i ká rá n`krye

Kufijt t`anë me i shkapërcye

N` Traboinë Gjetja le t` dalë

Ded Gjo Lulit me i çue fjalë. A. Gj. Fishta Lahuta e Malcis, kanga 13, f. 146

Të prirë nga parafjala për, si rezultat i ndikimit dialektor, ne pamë që gjendej vetëm lidhëza kushtore **në**, por në këtë shëmbull vëmë re që edhe ky lokucion lidhëzor (**në kje se**) është prekur nga ky ndikim dialektor, përveçse nga ndërprerja e tij nga ndajfolja e mënyrës vërtet (me të vërtetë), e cila në një rend të zakonshëm do të shërbente si pjesëz përforcuese dhe rendi i saj do të ishte pas togfjalëshit të qëndrueshëm-ndërtim frazeologjik i ká rá n`krye (i është tekur). Dëshmi e prekjës nga ky ndikim, përveç strukturës së lokucionit lidhëzor, është edhe përdorimi i theksave apo përdorimi i apostrofave në të shkruar që pasqyron intonacionin me të cilin shqiptohen në të folmen dialektore përkatëse.

Në kjoftëse asht jeta, të gjitha do të skjarohen e do të shërohen. A. Z. Pllumi, Rrno vetëm për me tregue, f. 80

Siç u përcaktua më sipër, një nga çështjet në të cilat dallon shprehja e raporteve kushtore në gjuhën standarde nga ajo në dialekt është përdorimi i lidhëzës kohore **si** për të shprehur raporte kushtore.

Kjo lidhëz në periudhat me fjali të nënrenditur kohore shërben për të shprehur marrëdhënie kohore të paskohësisë, kurse në periudhat me fjali të nënrenditur

kushtore është e barazvlefshme me lidhëzën nënrenditëse kushtore **po** dhe shkon me foljen kallëzues në mënyrën lidhore:

Asgjamangut Dranja do të kishte mbetë ndër to, **si** të mos kishte drashtë se po humb në një dhé aq të zi tiparet e veta të mira. M. Camaj, vep. letrare III, f. 77

Si të mos ishim ndalë pezull mbi humnerë në rranjët e një lisi, na të dy nuk ishim këtu sot. M. Camaj, vep. letrare IV, f. 253

Si të kisha pasë duert e tija të fuqishme, do t'ia kisha marrë frymën si lepurit të zanë në kurthë. M. Camaj, vep. letrare I, f. 106

Janë pikërisht kohët e mënyrës lidhore të foljes kallëzues të fjalisë së nënrenditur që bashkëveprojnë me këtë lidhëz kohore **si** që i dallojnë këto periudha me fjali të nënrenditura kushtore nga ato me fjali të nënrenditura kohore të paskohësisë me këtë lidhëz, ku folja kallëzues është në mënyrën dëftore, në kohën e pakryer, të kryer të thjeshtë dhe të kryer.¹⁸⁴

Si të punosh ditë e natë e të bësh ç' duhenë gjithë, ahere kërkohet nga zoti të t'apë bukëz e drithë. N. Frashëri, vepra I, f. 29

Në fjalinë kryesore ka një fjalë korrelative, e cila, nëse do të merrej si element i veçuar, do ta bënte ndërtimin të anonte nga kohori, por megjithatë kjo fjalë korrelative nuk e zbeh kuptimin kushtor, të shprehur nga bashkëveprimi i lidhëzës **si** me bashkëlidhjen kohore të foljeve kallëzues në fjalitë (të nënrenditur dhe drejtuese) të periudhës.

Me lidhëzën kushtore **po**, ka ndërtime ku e pakryera e mënyrës lidhore shfaqet në formën dialektore si:

Po t'u ankojshe, merrshe përgjigjen: “këto kemi; **në** daç merri, **në** daç leni, ven firmën këtu.”, A. Z. Pllumi, *Rrno për me tregue*, f. 322

Duket pra se mjetet më të prekura nga ndikimet dialektore janë lidhëzat, konkretisht lidhëza **në**, e cila del në variante të ndryshme fonetike në varësi të dialektit nga i cili është ndikuar, si edhe ato lokucione lidhëzore që ndërtohen me të [të cilat nuk janë të pakta në periudhat me fjali të nënrenditur kushtore].

N`paça fatin qi kam pasë

Kryet e shkjaun ne dorë ta bie. Kangë popullore gegnishte, mbledhë e rreshtue prej V. Prenushit, Sarajevë 1911, f. 321 (te Mbledhës...)

Ndë dinja se kur do vdes, bënja varrin vetë. Po aty, f. 19

¹⁸⁴ Gramatika e gjuhës shqipe II, ASHRSH, IGJL, Tiranë 1997, f. 546

Një mjet tjetër i prekur nga këto ndikime janë edhe format foljore në përbërje të lokucioneve lidhëzore që bashkojnë këto lloj periudhash me nënrenditje, siç është **në qoftë se** [me variantin **në kloftë/kjoftë se**].

Përdorimi i lidhëzës **që** në variantin **qi** në vend të lidhëzës ffilluese se në lokucionet lidhëzore: **në qoftë se, në është se/që, po qe se/që, në është se/që**, etj.

E kryera e thjeshtë e foljes **jam** në përbërje të lokucionit lidhëzor kushtor **po qe se/që** preket gjithashtu nga ndikimet dialektore duke dhënë variantin **po kje se/që**.

Sigurisht që të kujtuarit e faktit që dialektet, nga i vijnë gjuhës letrare ndikimet njihet prej nesh kryesisht në formën e folur dhe, në disa tekste të autorëve gegë, që janë kanë shkruar e shkruajnë në vepra letrare në gjuhën jostandarde, njihet edhe në formën e shkruar të prekur nga këto ndikime.

Fjalitë eliptike janë një tjetër karakteristikë e ndikimit dialektor, që vjen si rezultat i faktit që këtë rrafsh, komunikimi është më i shpejtë, më i rrjedhshëm e i shpenguar:

Në pastë dhe ndonjë fshatar tjetër mirë, **në mos** po, boll e ke xha Gorin! N. Prifti, Erë mali, erë fushe, f. 140

Me fjalët e psalmit po i ndjell

foshnjes gjumin: flej, flej, kërthi.

Në mos, vjen qeni e të ha bukën.

Vjen macja e të pi qumshtin.

Bie zogu fluturim

E të merr lulen në kaptell.

Flej o flej, flej, **në mos**,

vjen libri në dy kambë

e të lyp zanin e sat`amë.

M. Camaj, Vepra III, f. 188

Gjithashtu bashkimi pa lidhëza, për shkak të numrit të kufizuar të lidhëzave e lokucioneve të veçanta lidhëzore në format dialektore, janë të shpeshta periudhat në të cilat fjalitë bashkohen pa lidhëza.

U martove, vdiqe, shkove. Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar II, 1635-1912, f. 225

Mbyll perëndia një derë, hap dy penxhere. Po aty, f. 206

Edhe më të shpeshta janë ndërtimet me të ashtuquajturën paskajore gege [shembuj të shumtë janë sjellë më poshtë gjatë punimit], e cila është tipike për format dialektore të shprehjes së raporteve kushtore në gegërisht [në kohë të thjeshta apo në formën e ashtuquajtur të mbipërbërë]

Moj nuse faqegastare

Me t`pa ballin, po t`vjen marre

Pse po t`vjen moj marre ty?

Paske ballë për bukuri.

Moj nuse faqegastare,

Me t`pa ballin po t`vjen marre. Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar II, 1635-1912, f. 390

për analogji me ato të gjuhës së folur: “**Me pas kon** si ti e mir`/ as du rruzë e as du lir. **Me pas kon** si ti e hollë/ m`u kish ngri bardaku n`dorë. M`u kish ngri bardaku n`dorë/ *gjysma akull, gjysma borë.*” tekst kënge në gegërisht

Prania e mjeteve leksikore ndihmëse a fjalëve shërbyese si pjesëzave, pasthirmave apo edhe e fjalëve a fjalive të ndërmjetme e të ndërkallura janë disa nga tiparet e tjera dialektore që kanë ndikuar në ndërtimet që shprehin raportet kushtore në gjuhën letrare.

Sigurisht, **nëse** do të ishte prej atyne anëve, do të kishte mendue se bahej fjalë për një plak. E. Koliqi, Kritikë dhe estetikë, f. 101

Ndërtime të tilla: **Po** mëson, do të dalësh me dhjeta. **Po** nisesh ti, pas teje më ke. **Po** shkruan një artikull për këtë çështje, mos më përmend mua. që i ndeshim më tepër në gjuhën e folur i shtohen rasteve të numëruara më sipër për ndikimin e dialekteve në gjuhën letrare. Këto ndërtime, megjithëse nga mjeti lidhës me të cilin bashkohen fjalitë në periudhë afrohen me ato të gjuhës standarde, dallojnë prej tyre nga bashkëlidhja e trajtave kohore e mënyrore të foljeve kallëzues, sepse, në vend të mënyrës lidhore me të cilën shkon lidhëza kushtore **po**, në shembujt e mësipërm kjo lidhëz i paravendoset foljes në të tashmen e dëftores.

KREU IV

SHPREHJA E RAPORTEVE KUSHTORE

4.1 Shprehja e raporteve kushtore në periudhë

Raportet kushtore shprehen si në nivelin e periudhës ku marrëdhëniet mes fjalive kryesore a drejtuese dhe asaj të nënrenditur vendosin lidhje nëpërmjet lidhëzave nënrenditëse ose pa praninë e tyre pra vetëm me anën e foljes në mënyrën lidhore me të cilën fillon fjalia e nënrenditur, por edhe në nivelin e fjalisë ku një veprim a një gjendje e caktuar mund të jetë e kushtëzuar nga një rrethanë e çdo lloji.

Për shprehjen e raporteve sintaksore, siç u theksua më lart, përdoren mjete të ndryshme:

- a) morfologjike: trajtat e fjalëve ose eptimi
- b) sintaksore: fjalët ndihmëse a shërbyese (lidhëza e parafjalë) e bashkimi ndërmjet tyre; pranëvënia (ose bashkimi i thjeshtë, joparafjalor e jolidhëzor) dhe topika, rendi;
- c) fonetike: intonacioni dhe pauzat

4.1.1 Shprehja e raporteve kushtore në periudhë me lidhëza dhe lokucione nënrenditëse kushtore

4.1.1.1 Periudhat me fjali të nënrenditur me lidhëzën **në** dhe variantet e saj dialektore **n`**, **për në**, **ndë**

Me prejardhjen e lidhëzës **në** është marrë M. Lambertz¹⁸⁵, i cili, pasi e cilëson si “lidhësi hipotetik që përdoret më shumë se të gjithë në gjuhën shqipe”, sjell edhe përpjekjet e G. Meyer-it që e identifikon këtë lidhëz me parafjalën “ndë (në)” dhe ato të H. Pedersen-it që e mendon **në** të formuar nga të pa lidhje me parafjalën. Me sa duket, vetë Lambertz-i, përkrah mendimin që **në** ka origjinë parafjalore gjë që duket kur ai vë në dukje ndryshimet ndërmjet parafjalës **në** dhe pjesëzës **të**, si në pozicionet në të cilat ato gjenden, ashtu edhe në përdorimin e tyre. Duke bërë paralelizmin me disa lidhëza të tjera, për të cilat shpjegon prejardhjen nga greqishtja, ai e përforcon mendimin për lidhëzën **ndë**: “...*prandaj konjucionet e greqishtes este dhe ente që*

¹⁸⁵ M. Lambertz, Periudha hipotetike në gjuhën shqipe, përkth. nga V. Dashi, IGJL A-8 Sintaksa, f. 1

përdoren me kuptimin temporal pa relativin... të cilat bazën e kanë ke prepozicionet dhe janë zhvillue ma gjatë prej tynë...janë paralele krejt identike për **ndë** tonë dhe kanë ardhë nga një epokë më e re e gjuhës, sikundër duhet që ta pranojmë edhe për **ndë**.¹⁸⁶

Lidhëza **në** është lidhëz e parme. Në fjalinë kushtore ajo vendos lidhje me folje kallëzues të mënyrës dëftore në të gjitha kohët e mënyrat, por sidomos në kohën e tashme, si edhe me folje kallëzues në mënyrën dëshirore, sidomos në kohën e tashme, por rrallë edhe në kohën e kryer të kësaj mënyre. Kjo është e vetmja lidhëz kushtore që vendos lidhje me këtë mënyrë të foljes. Meqenëse nëpërmjet kategorisë gramatikore të mënyrës shprehet lidhja midis veprimit të emërtuar nga folja dhe realitetit objektiv si edhe qëndrimi i folësit ndaj veprimit të emërtuar nga folja¹⁸⁷, atëherë me mënyrën dëshirore të përdorur me këtë lidhëz folësi synon të shprehë veprime, kryerja e të cilave është e mundshme, por jo e sigurt.

Le të shohim më poshtë të gjitha rastet e identifikuara gjatë mbledhjes së materialit, se me cilën kohë të foljes kallëzues dhe të cilës mënyrë, bashkëlidhet forma foljore e foljes kallëzues në kohën e tashme të mënyrës dëshirore në fjalinë e nënrenditur kushtore me lidhëzën kushtore **në**:

Në shembullin e mëposhtëm foljes kallëzues në kohën e tashme të mënyrës dëshirore në fjalinë e nënrenditur kushtore me lidhëzën kushtore **në** i përgjigjet një folje kallëzues në kohën e tashme të mënyrës lidhore, e cila përdoret me kuptimin e kohës së ardhme të mënyrës dëftore:

Në ma dhaç saçin, ta jap furteren. Kosovë Fjalë të urta, f. 274

(Në ma dhëç saçin, do të ta jap furteren.)

Nëpërmjet intonacionit me të cilin mund të thuhet, lexohet një ndërtim i tillë, duket se kushti i vendosur në fjalinë e nënrenditur kushtore është mjaft i rëndësishëm për kryerjen e veprimit të fjalisë kryesore.

Kur në fjalinë e nënrenditur folja është në kohën e tashme të mënyrës dëshirore, në fjalinë kryesore folja është në kohën e tashme të mënyrës lidhore që ka kuptimin e dëshirores:

Në daltë djalë, të na rrojë/ në daltë çupë, të të rronjë. Fjalë të urta, f. 273

(Në daltë djalë, na rroftë/ në daltë çupë të rroftë.)

Në dëgjofsh fjalët e mija, do të jesh gjithënjë në gas. N. Frashëri, Vepra I, f. 33

¹⁸⁶ Po aty, f. 4

¹⁸⁷ Fonetika dhe gramatika e gjuhës shqipe I, ASHRSH, Tiranë, 1995, f. 272

Folja kallëzues në kohën e tashme të mënyrës dëshirore, në fjalinë e nënrenditur kushtore mund të ketë gjegjëse të saj në fjalinë kryesore të ardhmen e dëftores në të dyja format me të cilat ndërtohet kjo kohë e kësaj mënyre:

Në të shtifsha dot në dorë, do të të tret si top dëborë. Korçë Fjalë të urta, f. 237

Por, ...në vonofsh, kanë me më shtrëngue dhe kanë me më fejue pa më pyet. E. Koliqi, “Hija e maleve”, f. 125

Kur në fjalinë e nënrenditur folja është në të tashmen e dëshirores, në fjalinë kryesore kemi një kallëzues të përbërë që shpreh domosdoshmërinë e kryerjes së një veprimi:

Gruaja e nershme, në dash me të metë, ma së pari i nershëm, duhet me kanë vetë. Kosovë Fjalë të urta, f.333

Meqenëse kemi të bëjmë me një fjalë të urtë të zonës së Kosovës, është i justifikuar edhe përdorimi i formave dialektore të foljeve si në kohën e tashme të mënyrës dëshirore dash për daç, ashtu edhe ndërtimi i kallëzuesit të përbërë ku folja gjysmëndihmëse duhet vendos lidhje me paskajoren gege me kanë (me qenë), e cila përdoret në vend të lidhores të jesh.

Do të kishim pra: Gruaja e ndershme, në do të të mbetet, para së gjithash, i ndershëm, duhet të jesh vetë.

Fjalitë kushtore me lidhëzën në shprehin një kusht të mundshëm, të dëshirueshëm ose thjesht një supozim. Ato janë të mbarë gjuhës, të të gjitha stileve, por mbizotërojnë në stilin e letërsisë artistike. Janë të rralla në stilin publicistiko-shkencor.

Në poezi ndeshen shpesh, sepse vetë folja në mënyrën dëshirore me të cilën e gjejmë më shpesh të shoqëruar në fjali, është më e përshtatshme për të shprehur ngjyime emocionale, por këtë përdorim e lehtëson edhe struktura njërrrokëshe e lidhëzës.

Lidhëza në dhe varianti i saj dialektor ndë ose në formën e apostrofuar n` (per n`) në materialin praktik të vjelë, na del me një bashkëlidhje të larmishme formash kohore dhe mënyrore të foljeve kallëzues të fjalive në përbërje të frazës kushtore:

Ndë tunden këmbët, tunden dhëmbët.

Fjalë të urta, Kalabri, Itali, f. 135

Gjarprit ke t`i biesh ndë kryet, **ndë do t`** e vrash. Fjalë të urta, Kalabri, Itali, f. 80,

Por **n`je** i armve e **n`je** shqyptar,

E **per n`je** ndopak bujar,

Xir tagân e n`kjoftë gjykue,

N`bejleg kryet shkurtoma mue.

Po ai, po aty, Kângë e tretë, Preja, f. 29

Siç e vëmë re nga këta shembuj bashkëlidhja është e rrafsheve të ndryshme dhe bashkë me variantet dialektore të lidhëzave shkojnë edhe format dialektore foljore: p. sh. në shembullin e dytë që është një fjalë e urtë arbëreshe na bie në sy folja e fjalisë kryesore që është sjellë nga populli me ndërtimin: e tashme e dëftores e foljes ndihmëse kam dhe mënyra lidhore e foljes bie (qëlloj, gjuaj, godas). I gjithë ky ndërtim ka kuptimin e një kallëzuesi të përbërë që shpreh domosdoshmërinë e kryerjes së veprimit, që vendos lidhje në fjalinë e nënrenditur me foljen dua në vetën e dytë (me kuptim të përgjithshëm), e cila pasohet nga një fjali e nënrenditur ftilluese kundrinore.

Në shembujt e tjerë kemi ose bashkëlidhje të rrafshit të së tashmes si në shembullin e parë dhe në një pjesë të shembullit të tretë, ose e kryer e dëshirores në të nënrenditurën me urdhërore në drejtuesen.

Në fjalinë e nënrenditur mund të kemi kohën e tashme të mënyrës dëftore, kurse në fjalinë kryesore folja mund të jetë në mënyrën urdhërore:

Në do ujë, prit radhën aty ku je.

M. Kuteli “Qetësi përpara fërtyme”, f. 287

Në s`i besoni fjalët e mia, ngjiti lart në Shëmërti e do t`i shihni me sytë tuaj.

M. Kuteli, “Gjonomadhë e Gjatollinj”, f. 189

Në fjalinë e nënrenditur kemi kohën e tashme të mënyrës dëftore, në fjalinë kryesore kemi një folje në mënyrën lidhore me vlerën e urdhërores:

Dhe **në kam** tani ndonjë brengë të madhe në shpirt, ta dini se s`kam tjetër veç brengës se s`mund të shkruaj fjalët ashtu siç i dilnin nga goja. M. Kuteli, Natë kollozheku, f. 208

Të dërsish, **në** do të kesh,

Se nuk gjendet gjë në shesh.

Fjalë të urta Rrëzë-Përmet f. 146

Kurse në fjalinë kryesore kemi një lidhore e cila në fakt shpreh domosdoshmërinë e kryerjes së veprimit, në rastin konkret të djersitjes dhe gramatikisht është e barazvlerëshme me një kallëzues të përbërë; “*duhet të dërsish*”, që shërben si kusht i nevojshëm për t’u plotësuar, në mënyrë që dëshira për të pasur - e shtrirë në dy fjali njëra e nënrenditur kushtore; **në do** dhe tjetra e nënrenditur filluese kundrinore: të kesh, të jetë e realizueshme.

Në shumicën e rasteve të periudhat me fjali të nënrenditur kushtore të bashkuara me kryesoren me lidhëzën **në**, kur në fjalinë e nënrenditur kemi një kohë të tashme të dëftores. Edhe në fjalinë kryesore kemi një nga kohët e dëftores, sidomos të tashmen, por ka raste kur në kryesoren mund të kemi edhe urdhëroren:

Po **në** ke fuqi në dorë,

Ndihni djalit tënt që e polle.

N. Frashëri, Vepra III f. 73

E shprehur me mënyrën urdhërore një ndërtim i tillë shpreh një këshillë në formë urdhri, duke e konsideruar si një veprim të natyrshëm që ndodh brenda familjes.

Është për t’u theksuar që bashkëlidhja kohore dhe mënyrore e foljeve kallëzues të fjalive në periudhë vlerësohet si më e rëndësishmja në përcaktimin e kuptimit modal të kushtit.

Por ka raste të tjera kur këtë peshë e mban lidhëza nënrenditëse, siç shprehet M. Totoni në rastin e lidhëzës **në qoftë se**, e cila “*shpreh marrëdhënie kushtore joreale të mundshme, edhe nëse fjalitë i kanë foljet kallëzues në të ardhmen e së shkuarës ose bashkëlidhje të kësaj me të pakryerën e dëftores po me këtë vlerë kohore.*”¹⁸⁸

Kur në fjalinë e nënrenditur folja është në të tashmen e dëshirores, në fjalinë kryesore folja është në mënyrën lidhore me kuptimin e së ardhmes së dëftores:

Në vafshi në Shqipëri dhe **në patçi** sadopak të bëni me nëpunës të shtetit, kini shpejt për të zbuluar se fantazia letrare e Çapek-ut ka marrë trup në zyrat e Shqipërisë.

F. Konica, Vepra, f. 240

Në këtë shembull na bien në sy dy specifika: së pari mënyra e ndërtimit të kohës së tashme të mënyrës dëshirore të njëjës prej foljeve kallëzues kam në fjalinë e nënrenditur kushtore të bashkërenditur me një tjetër kushtore dhe së dyti fakti që, në mes të formës tjetër me të cilën mund të shprehet koha e ardhme e mënyrës dëftore, është ndërvendosur një ndajfolje mënyre.

188 M. Totoni, Fraza me nënrenditje, SHBLU, Tiranë 2000, f. 99

Folja kallëzues në kohën e tashme të mënyrës dëshirore në fjalinë e nënrenditur kushtore ka përballë në fjalinë kryesore një folje në kohën e ardhme të mënyrës dëftore që është e barazvlefshme me një kallëzues të përbërë që shpreh domosdoshmërinë e kryerjes së veprimit:

Në të mbaroftë mishi, do t`i japësh pjesë nga trupi yt. I. Kadare, “Shkaba”, f. 75
Gruaja e nershme, në dash me të metë, ma së pari i nershëm, duhet me kanë vetë.

Kosovë Fjalë të urta, f.333

Meqenëse kemi të bëjmë me një fjalë të urtë të zonës së Kosovës, është i justifikuar edhe përdorimi i formave dialektore të foljeve si në kohën e tashme të mënyrës dëshirore dash për daç, ashtu edhe ndërtimi i kallëzuesit të përbërë ku folja gjysmëndihmëse duhet vendos lidhje me paskajoren gege me kanë (me qenë), e cila përdoret në vend të lidhores të jesh.

Do të kishim pra: Gruaja e ndershme, në do të të mbetet, së pari i ndershëm duhet të jesh vetë.

Kur në fjalinë e nënrenditur folja është në të tashmen e dëshirores, në kryesoren kemi foljen në të tashmen historike me vlerën e së ardhmes:

Në më daltë me e krye këtë shërbim si duhet, kam të drejtë me e çelë gojën.
E. Koliqi, “Hija e maleve”, f. 89

Veprimi i shprehur në fjalinë kryesore është i mundshëm të realizohet vetëm në çastin që realizohet veprimi i fjalisë së nënrenditur që shtrihet gjithashtu edhe në fjalinë filluese kryefjalore që vjen pas fjalisë së nënrenditur kushtore.

Në fakt, ne mendojmë se i gjithë ndërtimi para fjalisë kryesore ka synimin të shprehë një veprim që folësi synon të arrijë ta realizojë dhe jo vetëm, por ta realizojë ashtu si duhet; vetëm me plotësimin e këtij kushti të domosdoshëm, ai ka të drejtë të “çelë gojën” të flasë. (nënkuptojmë: përndryshe ai s`e përfiton këtë të drejtë.)

Struktura me të cilën paraqitet periudha, mënyra dëshirore e foljes në fjalinë e nënrenditur dhe gjithashtu edhe lidhëza në japin pak mundësi për ta transformuar atë në një ndërtim që shpreh më qartë, atë që kuptohet në të vërtetë:

Nëse ruajmë lidhëzën dhe kohën e mënyrën e foljes së fjalisë së nënrenditur, do të përftonim: [Në arritsha me e krye këtë shërbim si duhet, do të kem të drejtë me e çelë gojën.]

Në këtë rast, ashtu si edhe në ndërtimin fillestar, jemi të detyruar që, për të kuptuar rezultatin, të përfshijmë në lexim dhe në analizë, jo vetëm fjalinë e nënrenditur, por edhe filluesen kryefjalore, sepse elementi kushtëzues për të arritur realizimin e

dëshirës për të folur, por edhe për të thënë atë që mendon folësi, qëndron pikërisht te fjalia fthilluese.

Ndryshe qëndron puna nëse mund ta alternojmë lidhëzën **në** me një nga lidhëzat e tjera kushtore p. sh. me **nëse**. Me këtë ndryshim, mënjanohet “pengesa” e përdorimit të detyrueshëm të dëshirores në fjalinë e nënrenditur, por gjithashtu edhe bëhet lehtësisht kalimi i periudhës nga një skemë strukturore treshe në skemë strukturore dyshe me një fjali të nënrenditur të paravendosur ku folja përfaqësohet nga një kallëzues i përbërë që tregon përfundimin, rezultatit e një veprimi me foljen gjysmëndihmëse arrij+foljen në mënyrën lidhore dhe një fjali kryesore:

Nëse arrij ta kryej këtë shërbim si duhet, kam të drejtë me e çelë gojën.

Foljes kallëzues të fjalisë së nënrenditur kushtore me lidhëzën kushtore **në** mund t'i përgjigjet, rrallë, në fjalinë kryesore një folje kallëzues në kohën e tashme të mënyrës dëshirore:

Sa për mue, dreqi më hangërt, **në u kujdesofsha** mâ. E. Koliqi, “Hija e maleve” f. 31

Në t`u dafsha, nizam vafsha. Mbedhës të hershëm të Folklorit, 6, f. 479

Në fjalinë kryesore folja është në dëshirore, kurse në fjalinë e nënrenditur folja është në kohën e tashme të mënyrës dëftore:

(I kam numëruar vetë. Ja me këta dy sy.) Më plaçin, **në ju gënjej**. M. Kuteli, Vendosa të shkoj në mërgim. Vepra II, f. 260

Roli i kontekstit në këtë rast bëhet i domosdoshëm, sepse, siç e shohim, periudha e shkëputur nuk arrin ta realizojë kuptimin e vet pa iu referuar fjalive paraprijëse.

Folja kallëzues në kohën e tashme të dëshirores në fjalinë e nënrenditur mund të bashkëlidhet edhe me një kallëzues të përbërë që tregon mundësinë e kryerjes së veprimit të ndërtuar me foljen gjysmëndihmëse mund dhe foljen në mënyrën lidhore:

Po, **në daçi**, mund ta lëmë për një herë tjetër. F. Konica, Vepra, f. 303

Në rëntë Salemboza, mund të ndryshohen krerët e Kamorrës, po themelet e saj janë të patundshme. F. Konica, Vepra f. 292

Në këtë shembull kemi një periudhë me fjali të nënrenditur kushtore që shpreh një kusht të mundshëm për t`u realizuar, por këtë ndjesi e përjetojmë deri në çastin që s`kemi lexuar vazhdimin e periudhës që mbyllet me një fjali të bashkërenditur

kundërshtore, e cila hedh poshtë ose zvogëlon mundësinë e të realizimit të veprimit të fjalisë së nënrenditur që do të sillte si pasojë realizimin e veprimit të shprehur në fjalinë kryesore. Duke qenë të patundshme themelet e kësaj organizate të quajtur Kamorra, mundësia e rënies së kryetarit të madh të saj Salembosës, është shumë e vogël, për të mos thënë e pallogaritshme, kështu që ndryshimi i krerëve të organizatës së fuqishme, është i pamundur.

Në ndonjë rast, si ky që do të japim më poshtë, në fjalinë e nënrenditur folja është në mënyrën dëshirore, kurse në fjalinë kryesore kemi një kallëzues të përbërë që duket i pazakontë nga mënyra e ndërtimit.

Ky tip kallëzuesi është i ndërtuar nga një folje gjysmëndihmëse që shpreh vazhdimësinë e kryerjes së veprimit dhe pjesa e dytë e kallëzuesit është një emër foljor asnjës. Nga tipat e kallëzuesve të përbërë që njihen nga gramatika, ky tip duket të jetë një ndërthurje e kallëzuesit që shpreh vazhdim veprimi dhe atij që shpreh mbarimin e veprimit, nëpërmjet foljes gjysmëndihmëse. Përmbajtja leksikore që shpreh emri foljor asnjës në shembullin e mëposhtëm për të cilin po diskutojmë, e kërkon foljen gjysmëndihmëse të grupit që shpreh mbarimin e veprimit, por këtu duket se i gjithë ndërtimi ka kuptimin e vazhdimit të kryerjes së veprimit dhe emri foljor asnjës mund të zëvendësohet me një folje në lidhore, për të nxjerrë kuptimin:

Në daçi, vazhdoni së dhëni hape.

F. Konica, Vepra, f. 302

Në daçi, vazhdoni t`u jepni hape. Dhe, nëse i referohemi kontekstit, autori ka synimin të inkurajojë heqjen dorë nga ilaçet, në rastin më të mirë, kur ai arrin të kuptohet nga ata të cilëve u drejtohet:

“Koha e magjisë dhe e hapeve u mbarua; nisi koha e kuptimit dhe e natyrës. Në ju pëlqen, mund të bashkoheni me mua. Në daçi, vazhdoni së dhëni hape.” F. Konica Vepra, f. 302

Në raste të tjera veprimi i dëshiruar, i mundshëm për t`u realizuar shprehet edhe nëpërmjet ndonjë pjesëze dyshuese, siç është mbase, e cila duke qenë pjesë e fjalisë kryesore në të cilën folja është në kohën e tashme me kuptim të së ardhmes, nuk bën gjë tjetër veçse shton gjasat që veprimi i fjalisë kryesore të mund të ndodhë, nëse realizohet veprimi i fjalisë së nënrenditur ku bashkëveprojnë folja në dëshirore dhe gjymtyrët e tjera: kryefjala dhe rrethanori i vendit:

N`arçim të dyja bashkë më një vënt, mbase i bëjmë të vinë në mënt.

N. Frashëri, Vepra II, f. 55

Në fjalinë e nënrenditur folja është në mënyrën dëshirore, kurse në fjalinë kryesore folja që është pjesë e një ndërtimi frazeologjik është në mënyrën lidhore, por ka vlerën e një urdhëroreje mos ki shpresë= mos shpreso:

Në m`i vrafsh me të pabesë/

paskëtaj të mos kesh shpresë/

se dhe të tutë gjall` s`vinë. N. Frashëri, Vepra IV, f. 288

Në fjalinë e nënrenditur folja kallëzues mund të jetë edhe në të kryerën e dëshirores. Në këto raste folja në fjalinë kryesore është në të ardhmen e dëftores:

Në e pastë nisur prapsht, qe, prapsht do ta mbarojë. R. Qose, “Vdekja më vjen prej syve të tillë”, f. 199

Folja është në kohën e tashme të dëftores, kurse në fjalinë kryesore kemi një kallëzues të përbërë që tregon mundësinë e kryerjes së veprimit:

Në ju pëlqen, mund të bashkoheni me mua. F. Konica, Vepra, f. 302

Një rast që kemi ndeshur gjatë vjeljes së materialit praktik është ai i dy fjalive të nënrenditura kushtore, të bashkërenditura ndërmjet tyre, foljet kallëzues të të cilave janë njëra në të kryerën e thjeshtë dhe tjetra në kohën e kryer të mënyrës dëftore, prej të cilave varet një fjali kryesore me foljen në mënyrën urdhërore:

Në të ngreha nonjëherë/ falëtore bukuroshe,

A në të kam djegur kofshë/ të majme demash e dhish,

mbaromë këtë dëshirë. N. Frashëri “Iliadha e Omirit”, Vepra III, f. 153

Ndërtimet me lidhëzën **në** janë të shoqëruara shpesh me pjesëzën e mohimit mos dhe bashkëlidhja kohore e fjalive në periudhë është e rrafshëve të ndryshme:

Në fjalinë kryesore kemi një folje në të kryerën e thjeshtë, kurse në fjalinë kryesore folja është në urdhëroren:

Në mos u shove fare, ndizu zemra shqipëtare! F. Konica, Vepra, f. 60

Mohimi i kallëzuesit të fjalisë së nënrenditur, i shoqëruar nga pjesëza fare dhe i përdorur në kuptimin “u ndale, pushove” dhe me synimin për t’u dhënë zemër atyre që u drejtohet, ka sjellë, nëpërmjet përdorimit të antonimit të foljes së fjalisë së nënrenditur, lindjen e shpresës për zgjimin e ndjenjës kombëtare për realizimin e ëndrrës së shkrimtarit dhe të një mundësie tjetër, nga ana sintaksore, për realizimin e veprimit të fjalisë kryesore.

Në fjalinë e nënrenditur kemi kohën e tashme të mënyrës habitore, kurse fjalia kryesore është eliptike ku folja kallëzues mungon, por mund të shtohet:

Më vjen keq për Zefin, se ish njeri i mirë me kulturë, po, **në qenka** punë gjaku, shumë mirë që u vra. M. Kuteli, Pamflete në Vepra V, f. 409

Koha dhe mënyra e foljes që është e mundur të shtohet në fjalinë eliptike të përbërë vetëm nga dy ndajfolje që, nga ana sintaksore, nëse shtohet foja jam në çdo kohë a mënyrë që dëshiron lexuesi, shërben si gjymtyrë emërore e kallëzuesit emëror.

Në shembullin:

...Po duhet të mos mbeteni zullunj, **në daçi** të fitoni independencën. F. Konica, Vepra, f. 217

fjalia kryesore është e paravendosur dhe duket se përmban një kusht, plotësimi i të cilit është i detyrueshëm për të sjellë si pasojë realizimin e veprimit të fjalisë së nënrenditur.

Bashkëlidhja e foljeve e tregon më qartë këtë. Në fjalinë kryesore kemi një kallëzues të përbërë që shpreh domosdoshmërinë e kryerjes së një veprimi, pavarësisht pjesëzës mohuese që këtu është në favor të veprimit që këshillohet të mos bëhet dhe në fjalinë e nënrenditur kemi foljen në mënyrën dëshirore.

Në fjalinë e nënrenditur folja është në të kryerën e dëshirores në formën joveprore, kurse në fjalinë kryesore kemi një folje në kohën e tashme:

Në kofte hangër pitja, tepsia është në mejdan. Mitrovicë, Fjalë të urta, f. 388

Selim beut shumë selam

Në më dhashtë zoti noni çikë,

Selim beun ta baj mik.”, Mbledhës të Folklorit 9, “Nga kënga e popullit”, Dh. Shuteriqi, f. 21

Në më dha zoti nej djalë,

Asllan pashn ta baj kumar;

Në më dha zoti nj çikë,

Asllan pashën ta baj mik. Mbledhës të Folklorit 9, “Nga kënga e popullit”, Dh. Shuteriqi, f. 26

Qyr ç`a dredh Halili e i ka thanë:

I bes`ën zotit. Gjalin me ma dhanë,

për në paça rrezik me dekë;

buz` xhamiet varrin me ma çilë

e me mbliedh` dymdhet` hoxhallarë

Baca Mujit me m`i çua fjalë.

Po **n`** paça rrezik me dekë

buz` xhamiet vorrin me ma çilë.» Mbledhës të Folklorit 9, “Nga kënga e popullit”, Dh. Shuteriqi, f. 81

Po **n`mos** paçi (n)ge me nejë

Po u përcjell e udha e marë.

Se Halilin nuk jau nap

Për pa e shnosh gjith si asht kenë. Mbledhës të Folklorit 9, «Nga kënga e popullit», Dh. Shuteriqi, f. 84

Me lidhëzën **në** mund të shprehen marrëdhënie kushtore në nivelin e periudhës me fjali të nënrenditur kushtore edhe në disa ndërtime tautologjike ku njëra nga gjymtyrët e tautologjisë ndodhet në fjalinë e nënrenditur dhe tjetra në atë kryesore:

(Aqë larg do ti që të ma shpiesh Doruntinën time?) Se **në** e daça për gëzim, për gëzim nuk do ta kem; **në** e daça për helm, për helm nuk do ta kem. M. Kuteli, Besa e Kostandinit te Tregime të moçme shqiptare, f. 42

Bashkëlidhja karakteristike për këto tipe periudhash është: në fjalinë e nënrenditur kemi foljen në kohën e tashme të mënyrës dëshirore, kurse në fjalinë kryesore kemi folje në kohën e ardhme të mënyrës dëftore. Gjymtyrët e tautologjisë, në të dyja fjalitë e periudhës kanë të njëjtin funksion, në shembullin konkret ato kryejnë funksionin e kundrinorit me parafjalë.

Në fjalinë e nënrenditur kushtore me lidhëzën **në** mund të gjejmë të përdorur edhe kohën e kryer të mënyrës dëftore, dhe në fjalinë kryesore kemi gjithashtu foljen në kohën e kryer:

Nuk ka mbërritur asnjë Helenë këtu, veç **në** ka ardhur hija e saj. I.Kadare, “Përbindëshi”, f. 79

Shishe e bardha me verë,

Në të lasha moj e mjerë,

u bëfsha frëng me kapellë. “Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar 1635-1912” II, f. 298

Mos bën mirë, **në** do të mos kollasesh. Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar 1635-1912 II, f. 209

Lidhëzën **në** e gjejmë të përdorur edhe në variantin dialektor **nd` (ë)**. Në një nga këto raste bashkëlidhja është: në fjalinë e nënrenditur kemi një folje në të kryerën e thjeshtë, në kryesoren kemi të tashmen e dëshirores. Të dyja periudhat bashkohen asindetikisht ndërmjet tyre:

Nd` e zu gjarpri, u shëroftë/ nd` e zu trimi, u trashëgoftë. M. Kuteli, “Natë muaji Shëmbitër”, f. 116

“Anemiku plak, s` të bahet kurrë mik, e **ndë** t` u baftë, s` bahetë i dëreitë” Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar 1635-1912 I, f. 13

Merr penë **ndë** do me gietunë lamshinë”. Po aty.

Nde të pasha nja tietërherë, ka me kienë e dyta herë. Po aty.

Qyr ç` a dredh Halili e i ka thanë:

“I bes`ën zotin. Gjalin me ma dhanë,

për në paça rrezik me dekë,

buz xhamiet vorrin me ma çilë

e me mbliedh` dymdhet` hoxhallarë

baca Mujit me m`i çue fjalë

Po **n`** paça rrezik me dekë,

buz xhamiet vorrin me ma çilë. Nga kënga e popullit. Mbledhës të folklorit 9, Dh. Shuteriqi, f. 81

Bini djem zoti ju dashtë,

Per ne daçi me fitue

Ndë je turkë, **ndë** ke din,

hiq dorë nga burri im,

Se tani po të vjen jyti. Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar 1635-1912” II, f. 295

Mund të ndodhë që përveç kohëve të përmendura në shembujt më sipër, lidhëza **në** të shoqërohet nga koha e kryer e mënyrës dëftore dhe të bashkëlidhet në fjalinë kryesore me një kallëzues emëror, gjymtyra emërore e të cilit është një fjali e nënrenditur kryefjalore që fillon me folje në mënyrën lidhore:

Në ke ardhur ndryshe, e mira e së mirës është të mos bësh një çap përpara. M. Kuteli, “Natë kollozheku”, Vepra I, f. 216

Koha e kryer e mënyrës dëftore në fjalinë e nënrenditur mund të vendosë lidhje në fjalinë kryesore me një folje në mënyrën urdhërore:

Në ke pasur lidhje me të, shko dhe thuaje ku duhet, me gojë dhe me shkrim. D. Agolli, “Dështaku”, f. 107

Një rast i rrallë duket se është edhe ai kur të dyja fjalitë, si e nënrenditura, ashtu edhe kryesorja, kanë folje kallëzues në kohën e tashme të mënyrës dëftore:

(O det, ati im dhe ti, o lumë, vëllai im) **Në** ju kam, sot ju kam! D.Agolli, “Dështaku”, f. 96

Një shembull fjalie eliptike me mungesë të kallëzuesit në fjalinë kryesore është edhe i mëposhtmi:

Në pyestë në ç`kalë hipi, në atë që hipën meiti. I. Kadare, “Ëndërr mashtruese”, f.21

Në fjalinë kryesore mungon folja që mund të shtohet në mënyrën urdhërore- i thoni, folje që mund të ndiqet nga një fjali e nënrenditur kundrinore dhe menjëherë pas saj, e

imponuar nga mjete lidhës, vjen një fjali përemërore përcaktore (që hipi në atë që hipën meiti.)

Mohimi i rremë duket më së miri në fjalinë kushtore ku lidhëza nënrenditëse kushtore në ndiqet nga pjesëza mohuese mos.¹⁸⁹ Në këto ndërtime fjalitë vetëm formën e kanë mohuese:

...dhe i ati, si shqiptar, kish një nderim të trashëguar, **në mos** për diturinë, për shkallën sociale të mjekut. F. Konica, Doktor Gjilpëra..., Vepra f. 268

Në mos i marrsha unë, -thashë, shkojnë dam. M. Camaj, Vepra 5, f. 141

Në mos ke e **në mos** ep dot

Për të mjerën lësho një lot. N. Frashëri, Vepra II, f. 45

Se, **në mos** e dija unë Maçokun, kush tjetër mund ta dinte? M. Kuteli, V II, Fije nga jeta e Theofil Kastorit, f. 95

-Pse jo? -tha Danieli. -**Në mos** tjetër, do të argëtohet. T. Laço, Ishulli i mëkatarëve, f. 129

Mbasi nuk je i zoti me e vra, shko e padite, **në mos** tjetër. E. Koliqi, Hija e maleve, f. 47

Në të dy shembujt në mes të ndërtimit **në mos** dhe përemrit të pacaktuar tjetër mund të vendoset, pa prishur kuptimin, folja bëj në mënyrën dëshirore: Në mos bëftë gjë tjetër, do të argëtohet dhe ...shko e padite, **në mos** bëfsh gjë tjetër.

Një periudhë tjetër që ka në përbërje një fjali eliptike është edhe kjo që do të japim më poshtë, por, në të, folja, e cila është e njëjtë me atë të kryesores mungon në fjalinë e nënrenditur kushtore, por dallon prej saj nga mënyra: në kryesoren folja e dhënë është në urdhërore, kurse në kryesoren, bashkëlidhja, por edhe kuptimi i fjalisë kërkojnë që folja të jetë në dëshiroren:

Në mos për vete, bëje për hirin tonë, për ata që të duan. I.Kadare, “Nata me hënë”, f. 295

khs. **Në mos** e bëfsh për vete, bëje për hirin tonë.

¹⁸⁹ Xh. Gosturani, Mohimi i nënkuptuar dhe mohimi i rremë, SF 1977/4, f. 135-144

(Por tipi në fjalë qëllon ndryshe nga të tjerët) Në mos i çmendur, së paku ishte jo aq në rregull nga trutë. F. Kongoli, Karuseli, f. 223

Në pastë dhe ndonjë fshatar tjetër mirë, në mos po, boll e ke xha Gorin! N. Prifti, Erë mali, erë fushe, f. 140

Kallëzuesit e të dyja fjalive mund të jenë në mënyrën dëshirore:

Heu more burra, e paça në qafë tanë botën e pamatun, në mos kjoftë puna njeshtu si po thom û! M. Camaj, Vepra letrare I, f. 66

Pjesëza mohuese e përdorur pas lidhëzës në dhe ndërmjet saj dhe foljes, jo gjithmonë ka synimin e shprehjes së supozimit të së kundërtës së asaj që është thënë më parë. Ndonjëherë ajo përdoret për të shprehur pasigurinë për atë që thuhet dhe në këto raste ndërtimi në mos + folje, e cila, në të shumtën e rasteve është gaboj ose në formën joveprore gabohem, ose në ndonjë rast edhe folja lajthitem, është i zëvendësueshëm me ndërtimin në qoftë se nuk + foljen, pa ndërhyrë në kohën a mënyrën e foljes që është pjesë e ndërtimit:

Në mos gaboj, ju po shkruani doktoratën për këtë, apo jo? I. Kadare, “Përbindëshi”, f. 152

Këndoja ca kohë më parë, ..., në mos lajthitem, programin e një koncerti të bandës “Vatra”. F. Konica, “Vepra”, f. 157

Në mos do të të pyesin, bënu sikur s`dëgjon. “Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar 1635-1912” II, f. 211 (nëse nuk të pyesin, po s`të pyetën, bëj sikur nuk dëgjon)

Një rast tjetër i elipsës së kallëzuesit është edhe ai që do të shohim te ky shembull:

Shit arën. Në mos arën, shit shtëpinë me gjithë kopsht. M. Kuteli, Qetësi përpara fërtyme, f. 310

Vëmë re që mungesa e foljes kallëzues në fjalinë e nënrenditur mund të jetë edhe si rezultat i dëshirës për të mos përsëritur foljen që sapo është thënë në fjalinë para, pra këtu hyn në veprim roli i kontekstit dhe bashkëlidhja e foljeve, pavarësisht mungesës së saj te fjalja e nënrenditur. Periudha do të pësonte një ndryshim të tillë:

Në mos shitsh arën, shit shtëpinë... Nga mënyra se si shtrohet çështja të lë të kuptosh që një nga dy veprimet duhet të kryhet.

Trimëri **në** mos na mbeti

e më s`jemi shqipëtarë;

të shuhet gjithë rrëmeti,

se kjo `shtë pun` e pangjarë.

N. Frashëri, Vepra IV, f. 26

Në këtë periudhë, në fjalinë e nënrenditur të së cilës dyshimi për çështjen për të cilën bëhet fjalë shprehet me fjalinë e nënrenditur me **në** mos dhe me një fjali të bashkërenditur me të që nuk ka lidhëz kushtore, por që me strukturën dhe kuptimin e saj ka të njëjtin synim të shtrojë për diskutim vërtetimin e kushtit që, nëse vërtetohej, duhej të sillte pasoja jo të zakonshme jo vetëm për folësin që i dëshiron ato, por edhe për “*të gjithë rrëmetin*”.

Ndërtime të tilla si:

...Prill mort. **Në** mos do të vdiste, do të ndryhej në kullën e ngujimit.

I. Kadare, Prilli i thyer, f. 130

Në kushtet e amullisë që kishte përfshirë kopshtin, ndonjë nga kafshët, **në** mos do të ngordhte, do të arratisej.

I. Kadare, Shkaba, f. 27

apo:

Në s`më tradhtojnë gulçimat e mbytura, do më tradhtojnë kërcitjet e këpucëve.

T. Laço, Ishulli i mëkatarëve, f. 18

ngjajnë më tepër me fjalitë e bashkërenditura me lidhëzat **ose... ose** si të duan të tregojnë se një nga të dy veprimet është i pashmangshëm.

Ndërtimet me **në** mos, në disa tipa fjalish, mund të shoqërohen nga pjesëza veçuese veç, e cila, veprimin e paraqitur nga fjalia që e paraprin si të pamundshëm për t`u realizuar, e zbut duke dhënë nëpërmjet fjalisë së nënrenditur kushtore një mundësi tjetër, qoftë edhe të pamenduar a të papritur:

Udhë tjetër për t`u kthyer në Rrafsh nuk ka. Veç **në** fluturoftë.

I. Kadare,

Dosja H, f. 96

-Kështu që ai do të vijë se s`bën...

-Veç **në** mos pastë vdekur, - shtoi me zë të shuar.

I. Kadare, Dosja H, f. 125

...Por vjollca nuk ka. E Luli i vocërr çka mund t`i fali mësuesit tjetër? Veç **në** i faltë tollumbat e veta që kanë hapur gojën si me dashtë me e hangër mësuesin. Migjeni, Vepra, f. 152

...megjithatë puna s`kishte shkuar asnjëherë gjer në vrasje, veç **në** kishte ndodhur ndonjë e tillë dikur përpara gurit të dhjetëmijtë. I. Kadare, Ndërtimi i piramidës së Keopsit, tek Ëndërr mashtruese, f. 213

Siç shihet në të katërt shembujt duket qartë që veprimi në fjalinë drejtuese që, në shumicën e rasteve, është e ndarë me pikë nga e nënrenditura kushtore, paraqitet si i perealizueshëm deri në çastin kur ndërhyr pjesëza veç që prin fjalinë kushtore dhe lë një “shteg” sado të ngushtë nga “mund të kalojë” qoftë edhe me vështirësi fjalia kushtore për t`i hapur rrugën e realizimit pasojës në fjalinë kryesore.

Një tip periudhe me fjali të nënrenditur me lidhëzën kushtore **në** është edhe ajo ku përsëri mungon kallëzuesi por lidhëza, përveçse nga pjesëza mohuese mos shoqërohet edhe nga pjesëza po dhe i gjithë ky ndërtim merr kuptimin e njëjtë me ndajfoljet ndryshe, përndryshe që do t`i shohim më poshtë. Në shembuj të tillë gjithë fjalia ku bën pjesë ky ndërtim duket e mangët, nëse vështrohet jashtë kontekstit të fjalive paraprirëse. Edhe këtu ndërtimi në fjalë rimerr fjalinë e nënrenditur me strukturë sintaksore paralele (përveç kallëzuesit që mungon) së cilës i referohet dhe foljen kallëzues të së cilës e “huazon” për të rindërtuar fjalinë e cunguar nga mungesa e kallëzuesit:

Në pastë edhe ndonjë fshatar tjetër, mirë, **në mos po** boll e ke xha Gorin!

N. Prifti, Erë mali, erë fushe, f. 140

Kush të munt një shqipëtarët

E Skënderbenë të zërë,

Nga të gjithë ju të parët,

Punë të madhe ka bërë!

Në mos po djalli t`u marrë,

Kur s`qënki të zottë fare

Kur s`muntni dot shqipëtarë,

Qënki gjithë për lavare!

N. Frashëri, Vepra IV, f. 260

Në shembullin e parë vëmë re që edhe në periudhën e parë, kemi një fjali eliptike ku mungon çdo pjesë e domosdoshme e ligjëratës dhe është i pranishëm vetëm rrethanori

i mënyrës i shprehur me ndajfoljen e mënyrës mirë e cila do të pranonte pa vështirësi foljen do të jetë pra kemi të bëjmë me një veprim supozimi për ndodhjen e të cilit pritet të verifikohet si është në të vërtetë dhe periudha tjetër për të cilën jemi duke diskutuar, që ndjek të parën, e bashkuar asindetikisht me të, i kundërvihet pak a shumë supozimit të parë, duke u përpjekur të pajtohet me gjendjen aktuale. Në shembullin e shprehur në vargje, fjalia që e përmban ndërtimin për të cilin po flasim u referohet katër vargjeve të para, të cilat do t'i analizojmë më poshtë si rast i veçantë i shprehjes së raporteve kushtore dhe të cilave u kundërvihet fjalia me në mos po që përmbledh, nëpërmjet formës mohore, përmbajtjen e atyre vargjeve dhe pasohet nga një mallkim, arsyeja e lëshimit të të cilit sillet nga autori i këtyre vargjeve me anë të dy fjalive të nënrenditura me lidhëza kohore, por me nuanca kushtore-shkakore.

Të njëjtat arsye mund të sjellim edhe për të përligjur analizën e njëjtë që i bëhet shembullit të mëposhtëm:

Me fjalët e psalmit po i ndjell

foshnjës gjumin: flej, flej, kërthi.

Në mos, vjen qeni e të ha bukën.

Vjen macja e të pi qumshtin.

Bie zogu fluturim

E të merr lulen në kaptell.

Flej o flej, flej, **në mos**,

vjen libri në dy kambë

e të lyp zanin e sat`amë.

M. Camaj, Vepra III, f. 188

Në mos që këtu përdoret me të njëjtën vlerë si edhe ndryshe, përndryshe, zë vendin e një fjalie të nënrenditur kushtore: **në mos** fjetsh, po s`fjete; dhe ndiqet në të dyja rastet nga një varg pasojash që vijnë nga realizimi i këtij kushti dhe shprehen në periudhë me fjali të bashkërenditura me struktura sintaksore paralele ndërmjet tyre.

Mos punofsh për atdhe, s`përmenesh mi dhe.

Kosovë, Po aty, f. 39

Mos foltë qetash, s`ka për të folë mâ sa të jetë jeta.
f. 70

E. Koliqi, Hija e maleve,

-Struktura sintaksore thajse paralele e të dyja periudhave, -lidhëza e njëjtë që mund t'u shtohet (**në**), -mënyra dëshirore e foljeve të fjalive të nënrenditura dhe forma

mohore e të dyja fjalive të periudhave, na japin mundësinë t'i grupojmë dhe t'i analizojmë së bashku këta dy shembuj. Pavarësisht nga mënyra e ndërtimit, edhe foljet e fjalive kryesore kanë të përbashkët shprehjen e kuptimit të së ardhmes: Në periudhën e parë folja është e përdorur në të tashmen historike me vlerë të përhershme, (s`do të përmendesh asnjëherë në të ardhmen), kurse në periudhën e dytë folja e fjalisë kryesore është në formën dialektore të së ardhmes të ndërtuar me foljen ndihmëse kam dhe paskajoren e foljes bazë dhe i gjithë ndërtimi përdoret për të ardhmen (s`do të flasë më sa të jetë jeta.) Kushti paraqitet i dëshirueshëm dhe mohimi i shtrirë në të dyja fjalitë e periudhës si edhe mënyra e të shtruarit të tij, i bëjnë periudhat të kuptohen si këshilla që duhen ndjekur, me qëllim që ta bëjnë kushtin të mundshëm për t'u realizuar.

4.1.1.2 Periudha me fjali të nënrenditur me lidhëzën kushtore **nëse**

Lidhëza **nëse** është një bashkim i dy lidhëzave **në** dhe **se** që në origjinë janë ffilluese dhe që përdoren edhe si kushtore, edhe si ffilluese. Kjo formë e përmbledhur e lokucionit **në qoftë se** ose **në është se** përdoret me të gjitha kohët e mënyrës dëftore dhe me mënyrën kushtore.

Ndërtimet me lidhëzën kushtore **nëse** janë më pak të përhapura. Struktura dhe kuptimi thuajse i njëjtë me fjalitë e nënrenditura me lidhëzën **në qoftë se**, bëjnë që edhe shtrirja stilistike e tyre të jetë e njëjtë me tipat e fjalive të nënrenditura me lidhëzën kushtore **në qoftë se**. Në pjesën më të madhe të rasteve fjalitë me lidhëzën **nëse** i gjejmë me përdorimin e kësaj të fundit si lidhëz ffilluese në bashkimin e fjalive drejtuese me fjali të nënrenditura kundrinore ose kryefjalore.

Bashkëlidhja e foljeve të fjalive në periudhë është e rrafshit të së tashmes si në shembullin më poshtë:

Nëse më premtom se nuk hyn kurrë mbrendë, po të lëshohem njetash ndër duer.

M. Camaj, Vepra 5, f. 136

Kushti i vendosur në fjalinë e nënrenditur kërkon të mbahet një premtim dhe kohëzgjatja është e përcaktuar nga ndajfolja e kohës kurrë, për rrjedhim mundësia e plotësimit të një kushti të tillë nuk duket e padiskutueshme, pavarësisht se bashkëlidhja e foljeve e favorizon atë dhe gatishmëria e folësit është e shprehur qartë në fjalinë kryesore me anë të ndajfoljes së kohës njetash.

Gjatë mbledhjes së materialit praktik jemi ndeshur me një thënie ku skemat e periudhave me fjali të nënrenditur janë të ndërlikuara; dy fjali të nënrenditura kushtore, të bashkërenditura ndërmjet tyre varen nga e njëjta fjali drejtuese dhe në të njëjtin paragraf, rrjedha e tregimit vazhdon me përmbysjen e rendit të fjalive, por

duke ruajtur të njëjtë bashkëlidhjen ndërmjet foljeve të fjalive në periudhë; në fjalinë e nënrenditur ajo është në kohën e tashme të mënyrës dëftore, kurse në fjalinë drejtuese në kohën e ardhme të mënyrës dëftore:

...dhe më tha se kurrë nuk do të dal prej burgut, **nëse** nuk e pranoj kuptimin psikiatrik të ëndrrës dhe **nëse** nuk pranoj të bashkëpunoj dhe shtoi se, **nëse** nuk them të vërtetën dhe nuk pranoj të bashkëpunoj, nuk do të më ndihmojë kurrfarë deklarate.

R. Qose, Vdekja më vjen prej syve të tillë, f.102

Si nga bashkëlidhja, ashtu edhe nga kuptimi, kushti duket i realizueshëm, i mundshëm dhe pasoja po ashtu. Siç vihet re folja e fjalisë së nënrenditur ka një nuancë kuptimore të së ardhmes, pak a shumë siç ndodh edhe në periudhën e mëposhtme:

(Alarmi): **Nëse shpërthen Fierza, kthehemi** në mesjetë. Gazeta Albania, dt. 5.05.2007, f. 1

Rreziku që veprimi i fjalisë së nënrenditur të ndodhë nuk duket të jetë i largët, prandaj folja është në kohën e tashme me kuptimin e së ardhmes së afërt, kështu që edhe nëpërmjet kësaj mënyre të të shprehurit synohet t'i kushtohet vëmendja e duhur çështjes, në mënyrë që të shmanget ndodhja e veprimit të fjalisë kryesore, e cila do të jetë, sipas shkruarit, rezultat i pashmangshëm i realizimit të veprimit në fjalinë e nënrenditur.

Nëse zini vend të parë

Do ju jap dhjetëmijë dollarë

Vend të dytë zutë vallë

Plot pesëmijë paçi hallall

Një qenush fët bishtin tund

-Sa dollarë, **po** ramë në fund?

F. Lamaj, Lakuriqi lakuriq, f. 24

Në këtë shembull bashkëlidhja është e rrafshit të së ardhmes ndaj premtimet mbahen, nëse plotësohen kushtet e vëna.

Në shembullin e mëposhtëm, bashkëlidhja është e njëjtë me shembujt e trajtuar më sipër, por në këtë shembull duket se kushti është i përcaktuar më qartë:

Nëse e mbyll dosjen për një javë, do të jem i kënaqur nga ti. T. Laço, Ishulli i mëkatarëve, f. 158

Na duket se folësi do të jetë i kënaqur, vetëm nëse bashkëbiseduesi të cilit i drejtohet do të kryejë porosinë a detyrimin që ka, por duke respektuar afatin prej një jave, që e bën plotësimin e kushtit të detyrueshëm, por edhe i jep mundësinë lexuesit të kuptojë që mundësia e realizimit të pasojës është shumë afër, mjafton një sakrificë njëjavore.

Të njëjtat arsyetime do të bënim për shembullin e mëposhtëm ku duket se vërtetimi i ekzistencës së shenjave (në trup për shkaqe të njohura), do t'i garantojë personit në fjalë kurimin:

Nëse do të ketë shenja, ne do të të kurojmë. T. Laço, po aty, f. 73

Bashkëlidhja mund të jetë edhe e rrafshit të së shkuarës, foljet e të dyja fjalive mund të jenë në të pakryerën e mënyrës dëftore dhe edhe në këto raste kushti është i mundshëm:

...dhe pinte rrallë ndonjë pikë ujë në përrue, **nëse bante** fort vapë. M. Camaj, Vepra III, f. 72

Kemi gjetur gjithashtu një bashkëlidhje të tillë: e kryer e dëftores në të nënrenditurën dhe e tashme e dëftores në formën joveprore në fjalinë drejtuese. Në këtë shembull kushti i vendosur në fjalinë e nënrenditur është i shoqëruar edhe me pjesëzën vetëm që e bën kushtin më të kufizuar dhe, për rrjedhim edhe pasojën më të varur prej realizimit të tij:

Prapë ndigjova mbramë prej tim et se bleta, qoftë ajo e egër apo e butë, përkitet, vetëm **nëse ka ngulë** në zgurë lisi. M. Camaj, Vepra IV, f. 187

Në shembullin që do të sjellim më poshtë do të vëmë re që, edhe pse nga bashkëlidhja fjalia është kushtore, nuanca mbizotëruese është ajo shkakore:

(-Mos e pi duhanin

Se ta shkurton jetën)

(-Sapo mbusha pesë)

Zebra vija-vija

Flakë për flakë pëllet:

-**Nëse s`do ta pije**

Sot do mbushje ... dhjetë.

F. Lamaj, Lakuriqi lakuriq, f. 34

Në të dyja fjalitë e bashkuara me lidhëzën nënrenditëse kushtore **nëse** foljet janë në kohën e tashme të mënyrës kushtore, por përmbajtja e fjalisë së nënrenditur shfaqet më tepër si shkak a pengesë e asaj që pritej të ndodhte në kryesoren. Pra zebra mendon se shkak që kafsha tjetër (meqë është një fabul dhe biseda zhvillohet mes kafshëve) nuk ka dyfishin e moshës, është pirja e duhanit që ia ka shkurtuar jetën. Megjithatë nuk zhduket kuptimi kushtor edhe për arsye se e gjithë periudha është një supozim pa bazë vërtetësie, meqenëse jetëgjatësia e kafshëve, sidomos e atyre që “pinë duhan” nuk është çështje e njohur mbi të cilën mund të bëhen diskutime.

4.1.1.3 Periudha me fjali të nënrenditur kushtore me lokucionin lidhëzor **në qoftë se/në qe(kje) se**

Lokucioni lidhëzor **në qoftë se** është i ndërtuar nga forma foljore e kohës së tashme të mënyrës dëshirore të foljes jam e pozicionuar mes dy lidhëzave nënrenditëse njëra kushtore – **në** dhe tjetra ftilluese – **se**.

Me lidhëzën **në qoftë se** përdoret mënyra dëftore dhe ajo kushtore, por, siç do ta shohim nëpërmjet shembujve, gjejmë të përdorur edhe mënyrën habitore, lidhore dhe urdhërore. Periudhat me fjali të nënrenditur me lokucionin kushtor **në qoftë se** përdoren në të gjitha stilet letraro-artistik, administrativo-juridik (nëpër formulime ligjesh apo nenesh), publicistiko-shkencor (siç janë fjalitë kushtore të mirëfillta)

Në të dyja fjalitë kemi kohën e tashme të mënyrës dëftore:

Përdorimi i mënyrës dëftore tregon që folësi e paraqit si të vërtetë veprimin e emërtuar nga folja kallëzues e fjalisë së nënrenditur kushtore, çka e bën të vërtetë e të sigurt edhe veprimin e foljes e të fjalisë kryesore në periudhën me fjali të nënrenditur kushtore.

Atëherë pse më sjell rrotull, **në qoftë se** e di?

I. Kadare, SPIRITUS, f. 219

Në një ndërtim të tillë kushti është i mundshëm, sepse bashkëlidhja është e rrafshit të së tashmes dhe në periudhë jepet një fakt real.

Në fjalinë e nënrenditur folja është në kohën e tashme, kurse në fjalinë kryesore folja është në mënyrën urdhërore:

Në qoftë se doni paqe me grekët, bëjeni.

I. Kadare, Përbindëshi, f. 133

Kryerja e veprimit që këshillohet nga folësi të kryhet në fjalinë kryesore me anë të foljes në mënyrën urdhërore përbën kushtin që duhet të plotësohet për të bërë të mundur arritjen e një rezultati të shumëpritur: vendosjen e paqes mes palëve.

Në fjalinë e nënrenditur folja është në mënyrën kushtore, kurse në fjalinë kryesore në të ardhmen e dëftores:

Atë ditë më tha se, **në qoftë se do ta tradhtoja, do të më vriste** me njëren nga ato armët e vjetra të tmerrshme që shikoja atje. I. Kadare, Përbindëshi, f. 13

Në këtë shembull është veprimi i fjalisë së nënrenditur ai që kushtëzon kryerjen e veprimit në fjalë kryesore. Kushti është joreal, por i mundshëm. Fjalja e nënrenditur kushtore është e ndërvendosur midis një fjalie të nënrenditur ffilluese kundrinore, që varet nga fjalia kryesore dhe që përbën një fjali drejtuese për të nënrenditurën kushtore.

Në fjalinë e nënrenditur folja është në të kryerën e kushtores, kurse në kryesoren, në të tashmen e kushtores:

Në të kundërtën, **në qoftë se zëvendëssekretari do të kishte folur keq për vajzën**, inxhinieri do ta mbronte vajzën... I. Kadare, Nata me hënë, f. 266

Pra në njëfarë mënyre të dyja palët ishin të përgatitura për të folur mirë apo keq për personazhin për të cilin flitet dhe derisa të flasë njëri, tjetri akoma s`di ç`do të thotë. Kushti është joreal, sepse veprimi i mbrojtjes do të ndodhte, nëse ndodhte më parë veprimi i sharjes, pra nuk paraqet diçka në përputhje me realitetin. Por ky veprim nuk ka ndodhur. Këtë e tregon trajta foljore në kushtore do të kishte ndodhur. Kushti është i mundshëm, qoftë për nga bashkëlidhja e foljeve kallëzues, qoftë edhe për nga fakti që ai e kishte mundësinë ta mbronte, skemë e cila do të hynte në punë, në çastin që tjetri nuk do ta kishte mbrojtur, pra do të kishte folur keq. Nga mënyra dhe koha e foljes kuptojmë se inxhinieri nuk pati nevojë të bëhej “avokat” i vajzës, sepse, me ç`duket, zv/sekretari nuk kishte folur keq për të.

Në fjalinë e nënrenditur kemi një kallëzues të përbërë që shpreh mundësinë e kryerjes së veprimit, kurse në fjalinë kryesore kemi foljen në kohën e tashme të kushtores në formën joveprore:

Kështu mund të dukej, madje kjo ëndërr mund të mos lindte kurrë, **në qoftë se nuk do të nxirrej** nga një shembull. I. Kadare, Lamtumira e së keqes tek Ëndërr mashtruese, f. 110

Kushti rezulton të jetë i mundshëm dhe kjo mundësohet, jo vetëm nga prania e foljes kallëzues të fjalisë së nënrenditur në kohën e tashme të kushtores, e cila, siç dihet, e paraqit veprimin si të mundshëm, por edhe nga prania e një kallëzuesi të përbërë nga folja gjysmëndihmëse mund dhe folja në lidhoren e pakryer (pavarësisht se ai është në formën mohore, sepse mohimi neutralizohet nga ekzistenca e tij edhe në fjalinë e nënrenditur). Duke marrë parasysh që kushti është i mundshëm, të menduarit e tij si i realizuar do të na jepte këtë rezultat: për fat të mirë kjo ëndërr ka lindur, sepse është nxjerrë nga një shembull. Nuk do të kishim të njëjtin rezultat nëse mohimi do të ishte i pranishëm vetëm në një nga fjalitë e periudhës me nënrenditje: ...madje kjo ëndërr mund të mos lindte kurrë, në qoftë se do të nxirrej nga një shembull këtu nxjerrja e ëndrrës nga një shembull (duke mos ia lënë atë rastësisë) përbën pengesë për lindjen e ëndrrës, kurse në rastin e heqjes së mohimit nga fjalia kryesore rezultati i lindjes së ëndrrës mund të ishte pozitiv, nëse realizohej kushti që të mos nxirrej nga një shembull.

Në fjalinë e nënrenditur e kemi foljen në kohën e ardhme të dëftores, në fjalinë kryesore që fillon me ndajfoljen atëherë, folja është në mënyrën urdhërore:

...dhe **në qoftë se** krijesat e luginave nuk do t'i shohësh, atëherë hajde ta fillojmë terapinë sipas metodës së përmendur. R. Qose, Vdekja më vjen prej syve të tillë, f. 262

Themi se folja është në të ardhmen dhe nuk kemi të bëjmë si në ndonjë rast tjetër me foljen do që rasti afër fjalisë së nënrenditur ffilluese kundrinore që fillon me folje në mënyrën lidhore, ku lidhëza që mund të shtohet. Këtu çështja shtrohet nëse arrin t'i shohë apo jo krijesat e luginave bashkëfolësi, nëse nuk mundet, folësi propozon ta ndihmojë t'i shohë nëpërmjet një metode të caktuar. Që çështja e shtruar paraqitet sipas mënyrës që jemi duke e analizuar e tregon edhe periudha që pason:

Por, **në qoftë se** do t'i shikosh mirë krijesat e luginave, atëherë gjunjzohu dhe puthe tokën...
Po aty, f. 263

Periudha ka të njëjtën bashkëlidhje kohore si edhe e mëparshmja, vetëm se në të çështja e diskutueshme jepet e zgjidhur dhe folësi i propozon bashkëbiseduesit një mënyrë shprehjeje lehtësimi nga dhuntia që ka për t'i parë krijesat e luginës.

Në të dyja fjalitë e periudhës, si në të nënrenditurën kushtore, ashtu edhe në kryesoren, foljet janë në kohën e ardhme të mënyrës dëftore, çka na jep mundësinë të gjykojmë për këtë bashkëlidhje sipas rastit konkret: nëse realizohet kushti i vendosur

në fjalinë e nënrenditur, sjell realizimin e pasojës që është mosrealizimi i synimit që ka folësi:

Por, **në qoftë se** varret do të jenë kaq të thella, ne nuk do të mbarojmë kurrë.

I. Kadare, Gjenerali i ushtrisë së vdekur, f. 17

Në të dyja fjalitë foljet janë në mënyrën kushtore dhe realizimi i kushtit të vendosur në fjalinë e nënrenditur, pavarësisht nga pasojat jo fort të favorshme për të tjerët, do të sjellë pasoja pozitive të shumëpritura për bashkëbiseduesin:

...Se kërkesa e saj për strehim do të shqyrtohej me ngut, **në qoftë se** do të fliste “siç duhej” në mbledhjen që...

I. Kadare, Nata me hënë, f. 267

Kushti i shprehur për t'u realizuar në fjalinë e nënrenditur është joreal, por i mundshëm, sepse plotësimi i tij nga ana e personit të interesuar për pasojën e përshkruar në fjalinë drejtuese sjell përfitime jetësore për këtë të fundit, në krahasim me dëmet që shkakton te personi kundër të cilit do t'i duhet të flasë “siç duhet”.

Në ndonjë shembull kemi hasur fjalinë drejtuese jo në formën mohuese, por në formën e një pyetjeje retorike, e cila e shpreh dyshimin e autorit në formë qortimi a këshille, që përfundon në fjalinë e nënrenditur kushtore:

Si mund të lulëzojë sheshi i atdheut të përbashkët që është bota, **në qoftë se** njerëzit nuk grupohen në një mënyrë a në një tjetër për të lëruar çdo grup një copë të dheut?

F. Konica, Vepra, f. 281

Kështu siç e kemi të ndërtuar periudhën në fjalinë kryesore kemi një kallëzues të përbërë që shpreh mundësinë e kryerjes së një veprimi të shprehur nga folja gjysmëndihmëse mund dhe folja në lidhore dhe e gjithë fjalia kryesore mund të zëvendësohet nga forma mohore: sheshi i atdheut të përbashkët që është bota nuk mund të lulëzojë. Në fjalinë e nënrenditur kushtore, ku është vendosur kushti që duhet plotësuar që të arrihet pasoja në fjalinë kryesore, folja është në të pakryerën e dëftores dhe në të njëjtën kohë po aty jepet rruga që duhet ndjekur për të arritur në qëllimin përfundimtar. Synimi i autorit është të tregojë që njerëzit duhet të grupohen me qëllim që të lulëzojë bota, pavarësisht se ajo që ka dashur të thotë është zgjedhur të shprehet prej tij me një periudhë që përfundon me një pikëpyetje. Kushti duket i mundshëm për t'u realizuar, qoftë nga struktura e periudhës, por gjithashtu edhe nga semantika e saj,

që analizuam më sipër në lidhje me atë që ka dashur të thotë dhe të shpresojë të jetë i kuptueshëm autori.

Mariana s`do të kishte përfunduar këtu, **në qoftë se s`do të pëlqente** ca libra ku lavdërohej... I. Kadare, Nata me hënë, f. 290

Në të dyja fjalitë e periudhës foljet janë në mënyrën kushtore; në të nënrenditurën folja është në kohën e tashme të kushtores, kurse në të nënrenditurën, në të kryerën e po kësaj mënyre. Mënyra e ndërtimit të periudhës ku të dyja foljet janë në formën mohore, na tregon se rezultati i arritur në fjalinë kryesore është pasojë e veprimit të fjalisë së nënrenditur që në fakt ka ndodhur. Pra shkaku që Mariana ka përfunduar këtu është se ajo ka pëlqyer disa libra.

Në fjalinë e nënrenditur folja është në kohën e tashme me kuptimin e së ardhmes, kurse në fjalinë kryesore, nëpërmjet një fjalisë pyetëse retorike, folja është në të ardhmen e dëftores. Veprimi paraqitet si i mundshëm dhe “kërcënues” për pasojat që do të sjellë pas realizimit:

Në qoftë se para çdo shërbimi miqësor menjëherë mendon falenderimin, atëherë nuk ke dhuruar, por ke shitur. Dostojevski (fjalë të urta online)

Dhe, **në qoftë se vërtetohet**, ku do të futeni atëherë ju që aq shumë keni shpifur...

I. Kadare, Nata me hënë, f. 296

I ngjashëm me këtë shembull është edhe ky që do të sjellim tani ku, autori e zgjidh dyshimin për realizimin e veprimit të fjalisë së nënrenditur e për rrjedhim, edhe të pasojës në fjalinë kryesore duke e përfunduar mendimin me dhënien e faktit real:

Në qoftë se do të kishte lindur katër muaj më përpara, tani Beni do të ishte ushtar... Mirëpo ai kishte lindur katër muaj më vonë. I. Kadare, Dimri i vetmisë së madhe, f. 37

Koha e kryer e mënyrës kushtore të foljes së fjalisë së nënrenditur duket se është “pengesa” për realizimin e veprimit në fjalinë kryesore duke bërë që të kemi kështu një veprim joreal, jo të mundshëm.

Pamundësia e realizimit të veprimit mund të shprehet edhe me kohën e tashme të kushtores, e cila përsëri është pjesë e fjalisë së nënrenditur dhe ka përgjegjëse të saj në

fjalinë kryesore një folje në kohën e kryer të kushtores. Edhe në këtë shembull supozimi mbetet i pavërtetuar, sepse autori jep zgjidhjen e çështjes menjëherë pas përfundimit të periudhës me fjali të nënrenditur kushtore:

Në qoftë se Besniku nuk do të nisej nesër jashtë shtetit, ai do të kishte shkuar tani në kafe për t'u treguar shokëve me hollësi procedurën e rrezatimit. Por Besniku do të nisej nesër.

I. Kadare, Dimri i vetmisë së madhe, f. 82

Duket se përdorimi për së dyti i ndajfoljes së kohës nesër së bashku me të tashmen e kushtores në fjalinë që përmbyll mendimin e autorit për çështjen që po diskutohet, sjell një ndihmesë për të kuptuar se ngjarjet zhvillohen një ditë para nisjes, por nuk është shumë e qartë se në cilin çast të ditës, por meqenëse procedura e rrezatimit, për t'u treguar me hollësi, siç do të donte të vepronte Besniku kërkonte njëfarë kohe, mund të gjykojmë që ngjarja për të cilën flitet zhvillohet diku rreth mbrëmjes, kohë që nuk është e mjaftueshme për të përfunduar tregimin e hollësoshëm dhe për t'u përgatitur për nisje.

Në shembullin e mëposhtëm foljet e të dyja fjalive janë në kohën e tashme të mënyrës kushtore. Periudha duket silur na përgatit për një eksperiment që do të kryhet për të vërtetuar ose jo supozimet e ngritura:

Në qoftë se thëngjilli do të qëndronte mbi ujë, kjo do të thoshte se dyshimi që i kotë. Në qoftë se shkonte në fund, atëherë supozimi konsiderohej i vërtetuar.

Q. Buxheli, Karrjera e zotit Maksut, f. 124

Periudha e dytë ka strukturë sintaksore paralele me të parën, pavarësisht se foljet e saj nuk janë në të njëjtën kohë formalisht, sepse ato janë në të pakryerën e dëftores, kuptimisht ato shprehin të tashmen e kushtores dhe tregojnë një veprim i cili ka gjasa të realizohet dhe përfundimi nga praktika të përputhet me supozimet teorike të shtruara në të dyja periudhat me fjali të nënrenditura kushtore.

Lokucionin në qoftë se e kemi gjetur edhe në variantin dialektor n`kjoftë se:

Zoti mirë ka m`e punue,

N`kjoftë se besen s`kemi lshue.

A. Gj. Fishta, Lahuta e Malcis, kangë e dymdhetët, Marash Uci, f. 137

Në këtë periudhë në fjalinë e nënrenditur folja është në kohën e kryer të mënyrës dëftore, kurse në fjalinë kryesore folja është në variantin dialektor të së ardhmes së mënyrës dëftore. Siç e shohim bashkëlidhja kohore lejon të shpresohet në mundësinë e realizimit të veprimit të fjalisë së nënrenditur (në se ata e kanë mbajtur besën), e cila do të sjellë si pasojë realizimin e veprimit në fjalinë kryesore (Zoti do ta bëjë mirë nxjerrë në bazë të urimit në gjuhën e folur: Zoti e bëftë mirë!)

Në qoftë se ai ishte burrë, duhej të shkonte te Pinxhot dhe të bënte atë që i ka hije një burri.

D. Agolli, Njeriu me top, f. 39

Në fjalinë e nënrenditur folja është këpuja jam në të pakryerën e dëftores, kurse në fjalinë kryesore kemi një kallëzues të përbërë që shpreh domosdoshmërinë e kryerjes së veprimit. Meqenëse vihet në diskutim një çështje e karakterit të fortë të njeriut që është burrëria, trimëria, veprimi i shprehur në fjalinë kryesore bëhet shumë i rëndësishëm për t'u kryer, me qëllim që të përliqjet ekzistenca e asaj ane të fortë të karakterit të personazhi që mban "barrën" e përfaqësimit të trimërisë e burrërisë së shqiptarëve.

Kjo lloj bashkëlidhjeje nuk është tipike për një ndërtim me fjali të nënrenditur kushtore, edhe për arsye se folja jam nuk tregon të gjendur, të ndodhur, por edhe sepse, me gjithë domosdoshmërinë e kryerjes së veprimit të fjalisë kryesore, ajo nuk përbën një kusht të mirëfilltë që do të sillte si pasojë realizimin e veprimit në fjalinë e nënrenditur.

Nuk mund të arsyetonim në të njëjtën mënyrë në ndërtimin e mëposhtëm ku duket se folja jam në të dyja fjalitë e periudhës ka kuptime të ndryshme nga ai që shpreh në fjalinë e mësipërme:

...njeriu është i shëndoshë fiziologjikisht dhe psikikisht, **në qoftë se është** në gjendje të punojë, të dashurojë dhe të vuajë. R. Qose, Vdekja më vjen prej syve të tillë, f. 163

Në fjalinë kryesore që në këtë rast prin të nënrenditurën folja jam ka kuptimin konsiderohet, quhet, kurse në të nënrenditurën ka kuptimin mundet. Duke gjykuar mbi këto tri veprimtari thelbësore të jetës së njeriut, të cilat karakterizojnë thujse çdo genie njerëzore, por jo të gjitha janë në gjendje t'i përballojnë të gjitha, konsiderohen të shëndoshë nga trupi dhe mendja ata që i plotësojnë kushtet e numëruara në fjalinë e nënrenditur që shërben si kusht për realizimin e pasojës në fjalinë kryesore.

Në disa raste, kushti i shprehur në fjalinë e nënrenditur, përveçse nga lidhëza kushtore përforcohet edhe nga pjesëza veç (vetëm), e cila paraprin lidhëzën dhe e thekson domosdoshmërinë e plotësimit të kushtit të mundshëm si në shembullin:

Do t'u vinte keq ndoshta për të, veç në qoftë se e kryente një ditë rolin e paracaktuar.

I. Kadare, SPIRITUS, f. 211

Në qoftë se je rob, nuk mund të jesh mik. Në qoftë se je tiran, nuk mund të kesh miq.
Niçe (fjalë të urta online)

Në qoftë se ia thua ndonjë fshehtësi mikut tënd, mendo se edhe ai e ka mikun e vet.
Nesini (fjalë të urta online)

Në qoftë se dëshiron ta ruash fshehtësinë prej armiqve, ruaje prej miqve. Lilienkroni
(fjalë të urta online)

Me gjithë ato që thamë më sipër, edhe me plotësimin e kushtit të shprehur në fjalinë e nënrenditur, realizimi i veprimit në fjalinë kryesore nuk duket të jetë “i garantuar” dhe kjo si rezultat i pranisë së pjesëzës dyshuese ndoshta në këtë fjali.

Bashkëlidhja kohore është e rrafshit të së shkuarës; në fjalinë e nënrenditur kemi një folje në kohën e pakryer, po që ka kuptimin e së tashmes së kushtores gjë që e përforcon edhe rrethanori i kohës i shprehur me një emër në trajtë të pashquar që do të thotë dikur në të ardhmen, ndonjë ditë. Në fjalinë kryesore si kallëzues shërben një shprehje e ndërtuar me të tashmen e kushtores, që edhe po të zëvendësohet me një ndërtim të barazvlefshëm me të për ta shprehur me një mënyrë tjetër do të kishim: Do të ndienin keqardhje ndoshta..., pra përsëri edhe pas zëvendësimit, folja do të mbetej në të tashmen e kushtores.

Edhe në shembullin e mëposhtëm foljet e fjalive të periudhës janë në të tashmen e mënyrës kushtore. Fjalja e nënrenditur varet nga dy fjali të bashkërenditura dhe vetë ajo gjendet në mes të fjalisë që shërben si drejtuese për të, për shkak se kuptimi i saj, por edhe rrethanori i kohës i shprehur me ndafoljen e kohës pastaj, që për mendimin tonë përfaqëson një fjali të nënrenditur kohore të rrafshit të paskohësisë (pasi të kishin livadhitur), bën që dy fjalitë, edhe pse të bashkërenditura, të mos kenë mundësi të ndërrojnë renditjen dhe e nënrenditura kushtore t`i referohet kësaj të fundit.

Bashkëlidhja kohore në disa raste mund të jetë edhe e rrafshit të së ardhmes së dëftores në të dyja fjalitë dhe kushti është joreal i mundshëm:

Në qoftë se vete mbarë, fytyra e Zogut do të shtjerë në histori një hie më të madhe se hieja e Skënderbeut. F. Konica, Vepra, f.233

Në fjalinë e nënrenditur folja është në të tashmen me kuptimin e së ardhmes (do të vejë) dhe realizimi i veprimit në fjalinë kryesore varet nga plotësimi i kushtit të shtruar në fjalinë e nënrenditur.

Kushti i pamundshëm shprehet me bashkëlidhjen: e tashme ose e kryer e mënyrës kushtore në të dyja fjalitë e periudhës:

Në të vërtetë Basri Hankoni do të ishte rrënuar krejt, në qoftë se nuk do të merrte Arën e Mullenjave. I. Kadare, Breznitë e Hankonatëve, f. 30

Një fije shprese, sado e vakët, ekziston ende që personi për të cilin bëhet fjalë të mos rrënohet krejt, sepse, me sa duket, drejt asaj rruge ishte nisur, por, meqë ekzistonte mundësia për të marrë diçka, mund të rezistonte edhe pak, megjithëse këto arsytetime do të ishin më frytdhënëse, nëse koha e foljes së fjalisë së nënrenditur do të ishte e kryer e kushtores, ose ajo e foljes së kryesores do të ishte e tashme e kushtores. Nëse do të ishin të dyja foljet në të kryerën e kushtores, kushti do të ishte joreal i mundshëm: ...do të ishte rrënuar krejt, në qoftë se nuk do të kishte marrë arën..., fati i tij i mirë ishte marrja e Arës së Mullenjave që e shpëtoi nga rrënimi total.

Një tjetër lokucion lidhëzor kushtor i ndërtuar me të njëjtat lidhëza ffilluese, por me kohën e kryer të thjeshtë të foljes jam është edhe në qe (kje) se

Per n`kje imend se i ká rá n`krye

Kufijt t`onë me i shkapercye

N`Traboinë Gjetja le t`dalë

Ded Gjo Lulit me i çue fjalë.
tremdhetët, f. 146

A. Gj. Fishta, Lahuta e Malcis, Kângë e

Në këtë shembull lidhëza është ndërprerë nga pjesëza imend (vërtet), e cila është përdorur për të shprehur dyshimin për kushtin real të shprehur në fjalinë e nënrenditur, ku folja është në kohën e kryer të mënyrës dëftore (pjesë e shprehjes frazeologjike të barazvlefshme nga kuptimi me i është tekur, ka menduar), që e bën veprimin e kësaj fjalie të mundshëm për t`u realizuar. Kjo kohë e mënyrë foljeje, në fjalinë kryesore ka përbri foljen në kohën e tashme të mënyrës lidhore.

Në qe se kam me pasë kohë, do t`i thom dhe unë frymës seme, para se me dalë prej gojës: (Tash që po ndahesh prej meje, edhe ti prej qielli lëshoje hijen tande mbi dhé!).

M. Camaj, Vepra letrare II, f.130

Bashkëlidhja e rrafshit të së ardhmes i jep kushtit të shprehur në fjalinë e nënrenditur nga folja në kohën e ardhme në formën dialektore me foljen ndihmëse dhe paskajoren geqe të përdorur në funksion të mënyrës lidhore, një karakter të mundshëm për t`u plotësuar, për të sjellë më pas realizimin e pasojës së shprehur në fjalinë kryesore gjithashtu me kohën e ardhme të mënyrës dëftore.

Periudhat me fjali të nënrenditur, fjalitë përbërëse të të cilave bashkohen me lokucionin lidhëzor **në është se**, i cili është ndërtuar nga forma foljore e kohës së tashme të foljes jam e vendosur mes dy lidhëzave nënrenditëse përkatësisht e para kushtore dhe e dyta ffilluese, kanë të njëtin kuptim dhe strukturë si ndërtimet me lokucionin lidhëzor në qoftë se. Dallimi ndërmjet tyre qëndron në ndërtimin e mjetit lidhës dhe në bashkëlidhjen kohore e mënyrore të foljeve kallëzues të fjalive në periudhë.

Ato kanë një shtrirje më të kufizuar në përdorim dhe janë karakteristikë më tepër e gjuhës së folur. Që nga ndërtimi i lokucionit që ka në përbërje kohën e tashme, në ndryshim nga lokucioni në qoftë se me të cilin bëjnë paralelizmin, mund të konstatojmë se ndërtimet me të nënkuptojnë vënien në dyshim të veprimit që mund të realizohet ose jo në çastin që flet folësi:

Në është se na jep argumente bindëse në lidhje me këtë çështje, po e dëgjojmë me kënaqësi edhe vazhdimin e arsytimit të çështjeve të tjera. Bised.

Duket se rrjedha e ngjarjeve do të ndryshojë në një të ardhme të afërt, në varësi të realizimit nga bashkëfolësi të kushtit të vendosur nga folësi në fjalinë e nënrenditur, ku koha e tashme e foljes jap (me kuptimin e një të ardhmeje të veprimit që pritet të ndodhë nga çasti në çast) që vendos lidhje me lokucionin që ka në përbërje një folje në kohën e tashme, ka përbri në fjalinë drejtuese një folje në kohën e tashme të ndërtuar nga pjesëza po që, zakonisht, shoqëron veprimin e papërfunduar që ka lidhje me kohën në të cilën flitet. Me gjithë praninë e pjesëzës po, kjo folje në kohën e tashme të mënyrës dëftore në fjalinë drejtuese duket se merr një kuptim të së ardhmes së afërt dhe i jep shpresën për të folur edhe për çështje të tjera bashkëbiseduesit që po pret të tërheqë vëmendjen e dëgjuesve nëpërmjet arsytimeve të tij. Pra nëse diskutanti i bind dëgjuesit, pra realizohet kushti, pasoja e pritshme është e mundshme të realizohet pa kaluar në ndonjë pengesë tjetër.

4.1.1.4 Periudha me fjali të nënrenditur me lokucionin lidhëzor **në rast se**

Ky lokucion lidhëzor është i ndërtuar nga emri **rast** në trajtën e pashquar në rasën kallëzore, i prirë nga parafjala e rasës kallëzore **në** dhe i ndjekur nga lidhëza ffilluese **se**. Edhe fjalitë me **në rast se** përdoren me mënyrën dëftore dhe me atë kushtore. Shtrirja stilistike e periudhave fjalitë e të cilave bashkohen me këtë lokucion, përfshin stilin publicistiko-shkencor, atë letraro-artistik në gjuhën e shkruar, por ato kanë filluar të përdoren edhe në gjuhën e folur si rezultat i ndikimit të gjuhës letrare. Në pjesën më të madhe të rasteve fjalitë me **në rast se** përdoren në vend të fjalive me **në qoftë se**, me të cilat afrohen edhe nga struktura dhe bashkëlidhja. Por fjalitë e nënrenditura kushtore të ndërtuara me lokucionin **në rast se**, nga vetë ndërtimi i

lidhëzës, e kanë të shprehur më qartë supozimin, dyshimin për realizimin e kushtit, rastësinë e vërtetimit të tyre. Ne kemi përzgjedhur disa raste bashkëlidhjeje të cilat do t'i sjellim nëpërmjet shembujve të vjelë nga materiali praktik, sidomos në vepra letrare të stilit artistik:

Në rast se bie shi, asnjëri s'ka për të parë gjë dhe ushtarët duhet të kthehen në palestër. Q. Buxheli, Karrjera e zotit Maksut, f.59

Folja në fjalinë e nënrenditur është në kohën e tashme të mënyrës dëftore dhe ka kuptimin e së ardhmes, kurse në fjalinë kryesore folja është në kohën e ardhme të po kësaj mënyre, por në formën dialektore të ndërtuar me foljen ndihmëse kam dhe paskajoren e fojes shoh. Mundësia e rënies së një shiu të papritur është e pranishme, gjë që do të sillte rrjedhimisht realizimin e veprimit të padëshiruar të shprehur në fjalinë kryesore, qëllim për të cilin, me sa duket është bërë dalja në terren e ushtarëve që duhet të kthehen të pakënaqur në palestër. Bashkë me supozimin që ngjarja mund të ndodhë, pa dëshirën e folësit (për shkaqe natyrore), shprehet edhe keqardhja e tij për pasojat që do të sjellë të ndodhurit e saj.

Në mënyrën dëftore, në kohën e pakryer mund të jenë foljet e të dyja fjalive të periudhës me nënrenditje kushtore:

Po në rast se ti, për arsye të ndryshme, nuk hapje gojën, atëherë kishte borxh të përgjigjej ai vetë. N. Prifti, Erë mali, erë fushe, f. 114

Kjo bashkëlidhje kohësh realizohet nëpërmjet shprehjes së foljes në fjalinë e nënrenditur me anë të shprehjes frazeologjike hapje gojën që mund të zëvendësohet me flisje dhe në fjalinë e nënrenditur një shprehje e huazuar nga gjuha e folur që ka kuptimin ishte gati që pasohet nga fjalia e nënrenditur ffilluese kundrinore që fillon me foljen në mënyrën lidhore të përgjigjej.

E në rasë se të pyet kush pse çon këso jete, ti thueji si të dësh, mundesh me i thanë edhe të vërtetën, por thueja tue buzëqeshë. Migjeni, Vepra, f. 273

Variante dialektor i lidhëzës në rast se në këtë shembull shoqërohet me bashkëlidhjen; folje në kohën e tashme të dëftores në fjalinë e nënrenditur dhe folje në mënyrën urdhërore në fjalinë drejtuese. Kushti joreal i mundshëm duket si një formë porosie që folësi i jep bashkëbiseduesit, para se veprimi i shprehur në fjalinë e nënrenditur të ndodhë, në mënyrë që ai të jetë i përgatitur për përgjigjen e pyetjes, në rast se do të ketë një të tillë.

Unë do të kisha të drejtën t'i ndëshkoja ata, **në rast se nuk do t'u përgjigjeshin** pyetjeve të mia. I. Kadare, Nata e Sfinksit tek Ëndërr mashtruese, f. 45

Në të dyja fjalitë kemi kohën e tashme të mënyrës kushtore, një bashkëlidhje karakteristike kjo për periudhat e ndërtuara me këtë lidhëz. Kushti është joreal, kurse mundësia e realizimit të tij përcaktohet nga bashkëlidhja, që për fatin e mirë të atyre që mund të ndëshkoheshin, lë edhe pak mundësi “manovrimi”; mjaftonte t’u përgjigjeshin pyetjeve dhe “ndëshkuesi” s’do të kishte asnjë të drejtë. Është i dukshëm karakteri mjaft i kufizuar i fitimit “të së drejtës për ndëshkim”, njësoj sikur para fjalisë së nënrenditur të kishte një vetëm dhe është pikërisht koha e foljes së fjalisë kryesore që bën diferencën nga dy raste të mundshme; njëri kur folja e kësaj fjalie mund të ishte në kohën e pakryer-kisha (të drejtën) ku kuptohet qartë se mundësia e realizimit të pasojës ishte më e madhe, me realizimin e kushtit të vënë në fjalinë e nënrenditur; rasti tjetër, kur folja e fjalisë kryesore mund të ishte në kohën e kryer të mënyrës kushtore- kisha pasur (të drejtën)- e cila kërkon gjithashtu edhe modifikimin e kohës së fjalisë së nënrenditur, kthimin e saj në kohën e kryer të kushtores, ku nuk ka asnjë mundësi realizimi të pasojës, meqë nuk realizohet kushti (në rast se nuk do t’u ishin përgjigjur pyetjeve – ja që ata u janë përgjigjur).

Mund të ndodhë që folja në fjalinë kryesore të jetë në mënyrën urdhërore dhe të ketë përgjegjëse në fjalinë e nënrenditur një folje në kohën e tashme të mënyrës dëftore që ka kuptimin e së ardhmes:

Në rast se ata sjellin gratë dhe fëmijët e tyre në kështjellë, lërin të hyjnë, por burrat mbajini jashtë mureve të kështjellës. F. Konica, Vepra, f. 405

Kohët e përdorura në ndërtimin e fjalive të kësaj periudhe e bëjnë kushtin të mundshëm për t’u realizuar, duke e përforcuar kushtin e theksuar nëpërmjet përdorimit të lidhëzës, me anë të fjalisë përmbyllëse të frazës që, për nga karakteri kundërshtor që shpreh nëpërmjet lidhëzës dhe përmbajtjes, nuk lë asnjë shteg për të diskutuar hyrjen e burrave në kështjellë.

Fjalja kryesore mund të paraqitet edhe eliptike ku folja mund të nënkuptohet, sipas kuptimit që del nga fjalja e nënrenditur, dhe koha e saj mund të përcaktohet nga bashkëlidhja që mund të krijohet me foljen e asaj fjalie:

Zgjedhje të parakohshme, **në rast se** s`ka kandidaturë në tri raunde.
Gazeta Tema, dt. 29. 06. 2007, f. 1

dhe : Zgjedhje të reja, **në rast se** s`ka votim më 4 korrik. Po aty.

Të dyja periudhat janë pjesë e të njëjtit artikull dhe e dyta na jep më tepër informacion se për kur bëhet fjalë. Kështu mund të kuptojmë që bëhet fjalë për një të ardhme të afërt, punë ditësh, por gjithashtu mund të kuptojmë që foja në fjalinë e nënrenditur ka kuptimin e së ardhmes, kështu që folja e munguar e fjalisë kryesore mund të jetë ose

një kallëzues i përbërë që shpreh mundësinë e kryerjes së veprimit dhe një folje në mënyrën lidhore, ose në kohën e ardhme të mënyrës dëftore dhe në këtë rast veprimi duket më i sigurt se në rastin më sipër.

Ndërtimet me kusht që dhe në rast se interpretohen nga M. Domi si të formuara nga trajta parafjalore emrash si kusht, rast dhe lidhëza **se**. Pikënisje janë fjalitë përcaktore lidhëzore plotësuese të këtyre emrave.

4.1.1.5 Periudha me fjali të nënrenditur me lidhëzën kushtore **po**

Lidhëza nënrenditëse kushtore është lidhëz e parme. Në Sintaksën e Akademisë së Shkencave¹⁹⁰ theksohet se fjalitë me lidhëzën **po** ndërtohen me mënyrën dëftore dhe me lidhoren, rrallëherë, për qëllime afektive, edhe me lidhore-habitorën. Në materialin e vjelë mundëm të konstatojmë që kjo lidhëz nënrenditëse përdoret më shpesh me mënyrën lidhore. “*Me anë të mënyrës lidhore shprehet kryesisht modaliteti i mundësisë, por në disa përdorime ajo shpreh edhe modalitetin e dëshirës ose të detyrimit.*”¹⁹¹. Bashkëlidhja mes fjalive mund të jetë e rrafshit të së tashmes:

Po të hiqet ligësija

Vjen_drita nga Perëndija

...**Po** të flakimë nakarë,

Jemi tok e të pandarë:

...**Po** të jemi një të tërë.

Çdo pun` është për të bërë.

N. Frashëri, Vepra II, f.182

Rregullisht në fjalinë e nënrenditur në këto vargje që sollëm nga N. Frashëri folja është në kohën e tashme të mënyrës lidhore, kurse në fjalinë kryesore, në dy të parat, folja është në kohën e tashme me kuptimin e së ardhmes, kurse në dy vargjet e fundit, në fjalinë kryesore, kemi një ndërtim foljor, domethënia e të cilit është: mund, është e mundur të bëhet. Kushti ka qenë i mundshëm për kohën kur është përdorur për t`u shprehur dhe mbetet po aq me vlera e i mundshëm për t`u realizuar edhe sot. E shpjeguar në këtë mënyrë kuptohet edhe përputhja e kutpimit që shpreh koha e tashme kësaj mënyre, me të cilën folësi e paraqit veprimin e shprehur nga folja si të mundshëm.

E tashmja e mënyrës lidhore jo rrallë përdoret me vlerën e së tashmes historike:

¹⁹⁰ Gramatika e gjuhës shqipe II, ASHRSH, IGJL, Tiranë 1997, f. 587

¹⁹¹ Gramatika e gjuhës shqipe I, ASHRSH, IGJL, Tiranë 1995, 320

Gjinkalleshja: - Dreq o punë

Qepe gojën, kur flas unë!

Gjinkallushi thumba shtie:

Po ta qep, unë ngordh urie.

Ferit Lamaj "Lakuriqi lakuriq, f. 93

Në një rast tjetër kur bashkëlidhja përsëri është e rrafshit të së tashmes, e gjithë periudha është një pyetje retorike që nuk mund të ketë përgjigje, por lexuesi e kupton dhe ata që duan ta vënë në zbatim këtë pyetje në formën e këshillës për t`u ndjekur, e shohin ndërtimin si një kusht të mundshëm, qoftë nga bashkëlidhja e foljeve të fjalive, por gjithashtu edhe nga kureshtja për të parë rezultatin që do të jepte ndjekja e një këshille kaq të vlefshme. Në fjalinë kryesore folja paraqitet në trajtën e kallëzuesit të përbërë që tregon mundësinë e kryerjes së veprimit, kurse në fjalinë e nënrenditur folja është në kohën e tashme të mënyrës lidhore. E shohim pra se kushti është i mundshëm të realizohet, mjafton të ndahet puna dhe njerëzimi do të ecë përpara, do të zhvillohet. [Madje ka ende kohë edhe në ditët e sotme!]

Fjalja e nënrenditur me lidhëzën kushtore **po** që e ka foljen kallëzues në kohën e tashme të mënyrës lidhore mund të ketë përbri në fjalinë kryesore edhe një folje në mënyrën urdhërore. Në këtë rast, gjithë periudha e ndërtuar në formën e një këshille që duhet marrë parasysh nga kushdo (sepse thënia ka vlerë të përgjithshme) tregon një kusht të mundshëm për t`u realizuar në fjalinë e nënrenditur, nëse ndiqet këshilla e dhënë në fjalinë kryesore:

Po t`u turr qeni, mos ik, se i dukesh i vogël.

Fjalë të urta, Kosovë, f. 94

Miqte tuaj nuk dinë shumë gjëra, mirëpo dinë ç` të bëjnë **po** të jenë në vendin tuaj. De Sika (fjalë të urta online)

Fjalja e nënrenditur kushtore me lidhëzën nënrenditëse kushtore **po** që e ka foljen kallëzues në kohën e tashme të mënyrës lidhore varet nga një fjali kryesore që e ka foljen kallëzues në kohën e tashme të mënyrës dëftore, me vlerën e një kallëzuesi të përbërë që tregon mundësinë e kryerjes së veprimit:

Por, **po** të vërehet me vëmendje nënshtresa e veprave të tyne, shifet se ndjekin me trajta e frymë të re gjurmat e Pushkinit, të Tolstoit e të Dostojevskit. E. Koliqi, Kritikë dhe Estetikë, f. 18